

---

Parapagimi për revistën.....	2
Stephen Schwartzi, ky përçarës fetar.....	3
Kujt i thonë këta Vehabi?.....	8
Drejt një mektebi të ri.....	11
A duhet vepruar kështu?.....	14
Si të bëhemi durimtarë?.....	16
Thënia e së vërtetës është rruga drejt Xhenetit .....	17
Balsami i lumturisë .....	20
Argumentimi me hadithe të dobëta.....	34
Hadithi ishte argument edhe për ata .....	36
Supozimi i keq .....	37
Udha nuk mbaron me pranimin e islamit, aty fillon.....	42
Palltoja e virtytit.....	44
Si i zgjedhim nuset dhe dhëndurët? .....	44
Lëshimet që duhen korrigjuar .....	47
Vani Mehmed Efendi.....	50
Muhammed Hamid El Fekij.....	51
Maria El Kibtijje.....	53
Muaji Xhumadel Ula .....	54
Besimi në melekët .....	56
Ndalimi i mendjemadhësisë.....	61

## Parapagimi për revistën

Parapagimi kushton gjithsej **10** euro (dhjetë) për Europë, (përfshirë edhe Shqipërinë, Kosovën, Turqinë dhe ish republikat Jugosllave), **20** euro për Kanada dhe Amerikë dhe vetëm **310** denarë për parapaguesit nga Maqedonia. Me këtë parapagim brenda një viti juve ju dërgojmë 12 numra të revistës, prej numrit aktual kur ju parapaguheni. Në këtë çmim janë të përfshiera edhe harxhimet postare për dërgim të thjeshtë. Për parapagim mjafton që të dërgoni pajtimin tuaj me emrin dhe adresën e plotë në:

email: [albislam@albislam.com](mailto:albislam@albislam.com)

sms: +389 70 445 725

fax: +389 2 3230 827

tel: +389 2 3230 827 (çdo ditë, përveç të xhumasë dhe të dielës, prej 9 deri 16)

ose me postë në: rr: 110 nr: 5 1000 Shkup, Maqedoni

---

viti IV nr: 35

[albislam@albislam.com](mailto:albislam@albislam.com)

redaksia: Ramadan Ramadani (kryeredaktor),  
Bekir Halimi, Talha Kurtishi, Alajdin Idriz,  
Fatmir Zaimi, Ali Shabani, Agim Bekiri,  
Metush Memedi, Omer Berisha

rr: 110 nr: 5  
Çarshija e vjetër  
1000 Shkup  
fax: +389 2 3230827

Del në fillim të muajit, kalendari i hixhretit, takvimi i Türkiye Diyanet Vakfi. Numri i ardhshëm: 27 06 2006

Boton: NUN-R DOOEL

Xhirollogaria: 300000001759616 Komercijalna Banka A.D. - Skopje (denar)

Xhirollogaria: 0270100209184 Komercijalna Banka A.D. - Skopje (euro)

rr. "Kej Dimitar Vlahov" 4

S.W.I.F.T. : KOB5MK2X

IBAN MK07300701002091869

Numri tatimor: 4030003487017

Revista është e regjistruar pranë Agjencisë për Informata të Maqedonisë nr. 02-124/2.

Shtypur në: Cetus Print -Shkup Tirazhi: 1000 kopje ISSN: 1409-6250

## Stephen Schwartzi, ky përcarës fetar

Stephen Schwartz është bërë një nga kritikët më të zëshëm dhe agresivë ndaj Arabisë Saudite dhe Vehabizmit. Ai e ka shpallur veten si një ekspert mbi lëvizjen e Shejh Muhammed Ibën Abdul Vehabit dhe është bërë përcjellësi i komenteve neokon-servatore mbi mbretërinë saudite.

Si shtesë, Schwartz-i ofron fakte ndaj një auditori për lëvizjen shumë të përfolur. Kur i zbërthen shkrimet e Schwartz-it gjen një injorancë të hidhur dhe një mbështetje mbi tekstet dhe idetë e një kulti universalisht i deklaruar si pseudo-islam.

Në një intervistë tek Booknotes.org pasi u vërsul me një sulm gënjeshtër dhe shpifjesh, Stephen Schwarz-i hodhi një farrë sfide:

Lamb: Ata po thonë pse mbështetesh tek Stephen Schwartz për të na i treguar të gjitha këto gjëra?

Schwartz: Nëse ata mendojnë se këto janë gënjeshtër, thuajini atyre t'i sfidojnë çfarë jam duke thënë.

Lamb: A ka tentuar ndokush?

Schwartz: Jo. Jo.

Lamb: Askush nuk e ka sfiduar këtë libër?

Schwartz: Ata nuk e sfidojnë këtë libër, jo. Ata sfidojnë, ata thonë gjëra të të tepruara për mua por ata nuk e sfidojnë librin, jo".

Ka ardhur koha të sfidojmë librin e Stephen Schwartz-it, shkrimet e tija mbi islam dhe kualifikimin e tij për të folur mbi fenë dhe më të rëndësishmen, motivimin e tij për të shkruar dhe për të folur aq pa pushim rreth subjektit të vehabizmit dhe Arabisë Saudite.

Në fjalët e Clifford Geertz tek një shkrim në NY Review of Books, Stephen Schwartz-i është një "figurë e huaj dhe e çuditshme". Me fillimet si anarkist-Troçkist (duke e quajtur veten "Shoku Sandalio"), Schwartz-i më vonë u bë shkrimtarë biografish për San Francisco Chronicle. Prej aty, sipas artikullit të Geertz-it, ai u bë një tifoz i luftës së Reganit në Grenada, përpara se të lëvizte së fundmi në Sarajevë ku ai ka punuar si një gazetarë i lirë. Disa herë është përshkruar si një "I djathti i Kohës së Re" dhe si një "një poet surrealit i njohur ndërkombëtarë" i cili ka gjetur gurët e filozofëve të luftës së klasave.

E vetmja gjë e vazhdueshme e karrierës së Schwartz-it ka qenë ndryshimi i shpesh ideologjik që e ka karakterizuar atë. Që nga 11 shtatori, "kjo figurë e huaj dhe e çuditshme" është ngritur nga errësira e afërt e shkrimit të biografive nga San Francisco Chronicle dhe si një kalemxhi i pavarur në Sarajevë tek revista si Frontpage Magazine, Weekly Standard dhe National Review. Me të vërtetë, mjafton vetëm një shikim mbi kontributet e Stephen Schwartz-it tek Frontpage Magazine për të kuptuar se ku mbështetet fiksimi i obsesionit të tij. Me tituj si "Tafti saudit", "Tjerrje Saudite", "Keqbërje Saudite në Falluxha", "Fishekzjarre Vahabiste", "Arabia Saudite në krizë" dhe "Ekstremizmi Saudit në nivele të larta", është e dukshme se Schwartz-i e ka shpallur veten si një ekspert mbi Arabinë Saudite dhe ideologjinë e shtetit të saj. Kështu, ai duket se ka gjetur çfarë

vite të tëra duke shkruar biografi për kalifornezët e vdekur në vite kurrë nuk i dhanë, një lloj nderi dhe pozitën si shko-tekfilani për koment mbi Arabinë Saudite dhe Vehabizmin.

Ndërsa Schwartz-i ka shkruar shumë mbi subjektin, rasti i tij kundër Arabisë Saudite është kompletuar dhe i detajuar në librin e botuar të tij: "Dy fytirat e Islamit: Shtëpia e Saudit nga Tradita tek Terrori". Si rezultat, i profesionit të sapo gjetur si një ekspert mbi vehabizmin, ai dëshmoi para kongresit amerikan në 2005 mbi "influençën" e vehabizmit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Për kundër faktit që Schwartz-i e paraqet veten si një ekspert mbi Arabinë Saudite, situatën e saj politike dhe udhëzimet ideologjike, ai kurrë nuk e ka vizituar vendin dhe këtë fakt e pranon mënjëherë në hyrje të librit të tij. Si mund ndonjëri të shkruajë me dhjetëra mijëra fjalë mbi një subjekt dijen e të cilit nuk e ka marrë nga dora e parë? E njëjta pyetje duhet të bëhet edhe për bazat mbi të cilat Stephen Schwartz-i komenton mbi vehabizmin, lëvizje për reformën islame të themeluar nga Shejh Muhammed Ibën Abdul Vehab. Megjithëse Schwartz-i shkruan tepër mbi subjektin ai asnjëherë nuk citon asnjë nga tekstet e Shejhut, studentëve apo ndjekësit e tij. A është punë serioze për një gazetarë të kritikojë një nga lëvizjet më të mëdha të botës pa referuar asgjë që dijetari i vetë thotë dhe shkruan? Sigurisht që jo. Qartësisht, Schwartz-i nuk është një student serioz i islamit e as edhe një gazetarë apo intelektual i tillë. Dështimi i tij për të bazuar kritikën e tij mbi Arabinë Saudite apo vehabizmin pra, pa dhënë asnjë burim primar e bën atë të bëjë gabime të shpeshta në shkrimet e tij që mbështeten

hërë herë në një injorancë qesharake mbi subjektin që ai i qaset. Schwartz-i meriton një farë lavdërimi sepse është një burrë i zoti i cili bën përpjekje të shpeshta për t'ju drejtuar një subjekti rreth të cilit është tepër i painformuar! Për shembull, në një artikull të shkruar për National Review pak pas 11 shtatorit "Çlirim, jo përmbajtje", Schwartz-i thotë se Hezbollah-ët janë vehabi. Fakti me këtë qëndron se edhe një person i cili ka pak njohuri për islamit e di se Hezbollah janë shia dhe madje as nuk janë sunnitë. Ata janë të lidhur me Iranin (një shtet shi'it) dhe jo Arabinë Saudite (një shtet sunnit). Pastaj ai vazhdon të ndërtojë çështjen kundër vetes së tij, Schwartz-i vazhdon të bëjë krahasime të çuditshme midis vehabizmit dhe "fashizmit italian", "Komunizmit Sovjet", "Militarizmit Japonez". Me të vërtetë, dikush mund të lihet me një përshtypje që ose Schwartz-i nuk e di se çfarë do të thotë vehabizëm apo ai nuk di çfarë do të thotë komunizëm, fashizëm ose militarizëm.

Edhe para Kongresit, Schwartz-i thotë gjëra krejtësisht pakuptim rreth natyrës së Shtetit Saudit. Për shembull pasi përmend martesën midis familjeve të Shejh Muhammed Ibën Abdul Vehabit dhe familjes së Ibën Saudit, themeluesit të Arabisë Saudite, ai vazhdon të thotë: "Deri më sot, këto familje ndajnë qeverisjen e mbretërisë, me trashëgimtarët e Ibën Vehabit, të njohur si alu Shejh, përgjegjës për jetën fetare dhe familja mbretërore Saudite ose alu Saud, që qeveris me vendin". Ndërsa është e vërtetë që muftiu i sotëm i Arabisë Saudite është një trashëgimtarë i Shejh Muhammed Ibën Abdul Vehabit, fakti është që maxhoranca e dijetarëve në mbretëri të cilët mbajnë pozita të ndryshme nuk janë trashëgimtarë të tij. Shejh Abdul Aziz

Ibën Bazi, muftiu i mëparshëm i Arabisë Saudite, me kontributin dhe rolin e të cilit në shoqëri nuk ka pasur të njëjtë, nuk ka qenë vetë anëtarë i familjes së Ibën Abdul Vehabit.

Në një intervistë me National Review Online, Schwartz-i thotë se Hamasi “përfaqëson vehabizëm të pastër”. Kjo është për kundër faktit që Hamasi është një degë e Vëllezërve Musliman (Ihuanul muslimun) dijetarët e të cilëve e kanë kritikuar shpesh vehabizmin dhe injoron faktin që shumë dijetarë vehabi ndryshojnë me Vëllezërit Musliman përsa i përket Metodologjisë (menhexhit).

Në të njëjtin artikull Schwartz-i pastaj e lidh ateistin Sadam Husein me vehabizmin duke thënë se që Sadami “ka përdorur vehabizmin për t’i dhënë regjimit të tij një mbulesë islame”. Të thuash se Sadami ideologjia e të cilit ka qenë hapur dhe vazhdimisht i përshkruar, i një refuzues i islamit nga dijetarët vehabi, është duke përdorur vehabizmin është qesharake pasi është e rregjistruar shumë herë që Sadami i ka torturuar dhe vrarë Irakenët thjeshtë se kanë qenë të lidhur me vehabizmin. Ai nuk ndalet vetëm me thënie se Sadami ka përdorur vehabizmin por Schwartz-i thotë që snajperi i Uashingtonit John Muhammed ishte gjithashtu një vehabi ose i shoqëruar me vehabizmin dhe kapja e tij “e ka kompromentuar thellë” lëvizjen në Amerikë. Të thuash se rregjimi i Sadamit i ka burimet legjitime nga një ideologji e cila e konsideron heretik është e çuditshme por pastaj të thuash se John Muhammed ishte gjithashtu një vehabi ose i shoqëruar me vehabizmin nuk është vetëm mashtrim i çdo baze faktike por tregon që ai pretendon se kushdo që është i keq ose bën diçka të keqe dhe është musliman është i pandershëm, lidhet menjëherë me veha-

bizmin pa marrë parasysh se ku qëndron e vërteta. Në fakt, ashtu si në rastin e Sadamit, Schwartz-i bile nuk e ka problem nëse personi është musliman apo jo.

Stephen Schwartz-i ose Sulejman Ahmed Schwartz ashtu si ai gjithashtu e quan veten është një ndjekës i Hisham Kabanit. Kabani është një imigrant libanez i cili themeloi kultin e vetë të bazuar në Kaliforni, ndjekin një lloj sufizmi dhe i fajëson të gjithë muslimanët e tjerë të cilët nuk pranojnë lidhësin e tij, si të humbur dhe ekstremistë.

Gjatë 1980, Organizata Amerikane Muslimane janë terrorizuar nga Kabani dhe ndjekësit e tij të cilët tentuan të grabisin konferencat e tyre për ta deklaruar Kabanin e panjohur si liderin suprem të të gjithë muslimanëve amerikanë. Në qershor 1999, ndjekësit e Kabanit thyen dyert e një mbledhjeje midis një zyrtari të Departamentit të Shtetit dhe Qendrës islame të Kalifornisë së Jugut. Ata kërcënuan liderët musliman dhe tentuan të prishin mbledhjen në mënyrë që ajo të anulohet.

Në 1995, kur Muslim Students Association (MSA) of North America u përpoqën të ndalonin propogandën e Kabanit që t’ju sillej me postë duke ndjekur një listë, Kabani dhe ndjekësit e tij arritën ta mbyllnin MSA-NET, duke e akuzuar, pa të drejtë se mbështet terrorizmin. Lista u mbyll për tre muaj përpara se të vazhdonte aktivitetin.

Në 1998 kur Shtetet e Bashkuara të Amerikës ndërmorën një fushatë bombardimesh mbi Irakun, pjesa më e madhe e organizatave muslimane i kundërshtuan bombardimet për shumë arsye. Kabani në anën tjetër mbajti një konferencë shtypi që e justifikonte sulmin mbi Irakun për “arsye sigurimi” dhe që Shtetet e

Bashkuara të Amerikës dhe aleatet e saja vepruan në interes të “sigurimit global”.

Në Janar 1999, Kabbani drejtoi një mbledhje të afërt me departamentin e Shtetit Amerikan duke thënë një seri gjërash të çuditshme që qëndrojnë të pambështetura që sot e kësaj dite. Midis tyre që ideologjia e ekstremizmit është përhapur 80% në popullatën muslimane amerikane, që shumë organizata muslimane në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në realitet janë ekstremiste (përveç tij), që Muslim Student Association of North America është në fakt duke u drejtuar nga ideologji ekstremiste dhe që vetë këta studentë musliman po punonin për Bin Ladenin për të sjellë një holokaust nuklear në qytetet amerikane dhe gjithashtu që gratë muslimane në Europë flinin rregullisht me zyrtarë qeveritarë për të marrë informacione për ekstremistët. Si shtesë ndaj kësaj, Kabbani ka thënë edhe se 80% e xhamive në Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë vehabi, pastaj ai bëri një deklaratë të turpshme rreth muslimanëve malezianë duke bërë thirrje disa politikanëve malezianë për të kërkuar deportimin e tij në një vizitë të tij. Natyrisht, këto deklaratë u kundërshtuan nga grupet kryesore muslimane. Në shkurt, të gjitha organizatat kombëtare islame në Amerikë nxorën një deklaratë të përbashkët duke e dënuar Kabbani dhe grupin e tij. Për arsye të dukshme, Schwartz-i duket se heziton për të diskutuar anëtarësimin e tij tek ky grup megjithëse “historia e konvertimit të tij është në një listë në websajtin e Kabbanit. Schwartz-i është shumë i hapur rreth rolit që Kabbani ka luajtur në konvertimin e tij: “Unë u takova me Sheh Hishamin e tariqatit të Nashkibendive dhe brenda disa javësh bëra shehadetin”. Të thuash “she-

hadetin” do të thotë të dëshmosh por në këtë kontekst nënkupton vetëm thënjen e dy dëshmime të besimit të cilat duhen për një person të bëhet musliman, megjithëse, një anëtarë musliman i një pseudo-kulti islam.

Të gjitha shkimet e Schwarz-it mbi islam dhe Arabinë Saudite duhet të kuptohen në këtë kontekst. Ai shkruan nga prespektiva e një njeriu i cili është anëtarësuar në një sekt agresiv që maxhoranca e muslimanëve amerikanë e shikojnë si heretik dhe që kundërshton islamit e pranuar nga të gjithë. Përkundër portretizimit të vetes si një gazetarë objektiv duke fërshëllyer bilbilin mbi Arabinë Saudite, Schwartz-i është një anëtar i një kulti fetarë me një histori të gjatë që deklaroi të gjithë kundërshtarët e tij si “vehabi” dhe duke bërë deklaratë të jashtëzakonshme rreth ideologjisë së tij dhe rivalëve politikanë.

Influenca që Kabbani ka në mendimin e Schwarz-it është e dukshme. Vetëm të shikojmë kapitullin e parë të librit të tij. Tek “Urryesit e këngës”, Schwartz-i shkruan rreth origjinave të vehabizmit dhe teksteve kryesore të tij.

“Diversiteti i burimeve” që Schwartz-i aludon tek një fjali përmblylëse në librin e tij nuk duket aspak diverse. Për shembull, Schwartz-i citon shpesh një farë Kerim Fenari. Në këtë kapitull ai citon Fenarin si një burim për një fis të veçant të Arabëve që gjendet në Arabinë Saudite: “Një atribut i përshkruar Tamimitëve në literaturën e hadithit është një zell i keqpërdorur”. Fenari e thotë këtë në një artikull të titulluar “duke shpuar Ëndrën e Djallit rreth hadithit të Nexhdit”. Shtëpia e këtij debatesi anti-vehabi është në websajtin e Ahlus Sunnah Foundation of America (ASFA), një organizatë e udhëhequr nga Hisham Kabbani.

Ose pa dëshiruar dhe pa qenë i aftë për të shikuar vërtetësinë e thënjeve të Fenarit, Schwartz-i vetëm e imiton atë si fakt. Megjithatë “literatura e hadithit” aktualisht thotë të kundërtën rreth fisit Tamim: “Këto njerëz (Tamim) do të qëndrojnë të vendosur ndaj Anti Krishtit (Dexhall-it)”. Zelli me sa kuptohet i këtij fisi nuk është i keqpërdorur por i është drejtuar Anti-Krishtit dhe ndjekësve të Tij. I njëjti hadith pastaj vazhdon të përmend që ky fis janë gjithashtu trashëgimtarët e Profetit Ismail.

Në faqen 85, Schwartz-i referon ez-Zahauin për të përshkruar disa masakra të supozuara se janë bërë nga vehabitë. Citatin që Schwartz-i i atribuon ez-Zahauit është marrë direkt nga e njëjta faqe interneti ASFA ashtu si edhe citati nga Fenari.

Pak faq më pas, Schwartz-i bën një listë librash anti-vehabi si fakt supozimin për kundërshtimin shumë të përhapur të lëvizjes. Një titull që e ai e aprovon është edhe “Shpata indiane mbi qafën e Nexhdit”. (Nexhd këtu i referohet Arabisë Saudite). Megjithatë, përpunimi i kësaj liste nuk është puna e Schwartz-it por ai e ka marrë atë nga një listë e publikuar në faqen e internetit të Kabbanit. Në faqen 92, ai citon Matin Sidikin dhe e përshkruan atë si thjeshtë një “Komentatorë musliman amerikan”. Kjo është një lloj komplikacioni që e karakterizon aq shumë polemikën e Schwartz-it. Sidiki nuk është një “komentatorë” por ai është i dyti pas Hisham Kabbanit dhe është i përshkruar nga faqja e tyre e internetit si Sekretari i përgjithshëm i organizatës.

Më vonë në të njëjtin kapitull, Schwartz-i vazhdon të përshkruaj jetët e tre liderëve sufistë, Shiruanin, Has Muhammed dhe Jaragin. E gjithë biografia e Shiruanit është e marrë nga faqja e internetit të Kab-

banit, e gjithë biografia e Has Muhammed duke përfshirë edhe citatin (“Zoti nuk ka dërguar asgjë në këtë tokë përveçse si një mësim për robërit e Tij që të mësojnë”) është e marrë nga faqja e internetit të Kabbanit dhe së fundi gjithçka mbi jetën e Jaragit duke përfshirë thënien që ai “i stërviste muridët e tij, të cilët numërohehin me mijëra” është marrë nga faqja e internetit. Schwartz-i madje i përmend këta individ me të njëjtin rend mu si ata paraqiten tek faqja e internetit të Kabbanit.

Kjo është e kuptueshme që Schwartz-i do të ndjek të njëjtën doktrinë anti-islame që Kabani ka ndjekur që në 90-tën dhe libri i tij është vetëm një përmbledhje e artikujve që Kabani vetë i ka publikuar ose përkthyer ndërsa Schwartz-i vetëm i ka përsëritur, kapituj dhe vargje, të njëjtat deklarata të bëra nga Hisham Kabani rreth organizatave kryesore muslimane.

Tek “Vehabitë në Amerikë”, Schwartz-i e përshkruan Kabbanin si “një kundërshtues publik ndaj përpjekjeve vehabiste për të disiplinuar amerikanët muslimanë” dhe një njeri i cili “i mbështet plotësisht vlerat amerikane demokratike, ashtu si edhe zgjedhjen paqësore të konfliktit Izraelo-arab”.

Thënia se 80% e xhamijave/muslimanëve janë vehabi (dhe si rezultat supozohet se janë ekstremista dhe të rrezikshëm) është një thënie që bëhet shpesh nga Schwartz-i që nga 11 shtatori. Në dëshminë e tij para Kongresit, Schwartz-i ka thënë se 80% e xhamijave janë të drejtuara nga vehabi, CAIR thotë se 70% e muslimanëve janë të kënaqur me vehabizmin. Kjo deklarata e dytë është shumë e dyshimtë dhe nuk ofron asnjë fakt. Një kërkim përmes studimeve të CAIR nuk gjejmë asnjë statistikë të tillë përveç asaj

që 70% e muslimanëve kanë votuar për George W. Bush. A ishte vota e tyre për Bushin një votë për vehabizmin? Në një tjetër kërkim të gjetur tek CAIR gjendet një statistikë që 70% e muslimanëve besojnë se mund ta praktikojnë fenë e tyre lirisht në Amerikë. 70% e xhamiave gjithashtu ndihmojnë familjet e varfëra në zonat e tyre. Schwartz-i dëshmoi para Kongresit që "CAIR vetë ka thënë që rreth 70% e muslimanëve duan "selefizmin" në xhamijat e tyre".

Siç shihet, Schwartz-i ose është gënjeshtarë ose është një injorant naiv. Për shembull në një intervistë televizive ai thotë: "Unë me të vërtetë them vehabitë ashtu siç e kam thënë në librin tim e nxjerrin Profetin Muhammed jashtë feje". Askush, jo madje edhe nga kritikët më të ashpër të vehabizmit, nuk kanë bërë deklarata të tilla që vehabitë e nxjerrin "Muhammedin jashta islamit". Pastaj ai thotë është një zakon e quajtur Umra e cila është një Haxh i vogël, të cilët individët e bëjnë por sauditët thonë se nuk i kanë ambientet për këtë lloj..". Kjo është tepër qesharake sepse çdo muslimanë do të dëshmojë. Çdo vit ndoshta miliona njerëz e vizitojnë Mekën për të kryer Umran. Ambasada Saudite lëshon viza për Umra. Janë miliona muslimanë përrreth botës që kryejnë

Umran. Ka libra të tërë të shkruar nga vehabi dhe jovehabi duke detajuar mënyrën sesi Umrah kryhet. Së fundi, Schwartz-i thotë: "Unë nuk e kryej haxhin, unë nuk mund ta bëj haxhin sepse nuk jam vehabi". Kjo është tërësisht fallse pasi miliona jo-vehabi e kryejnë haxhin. Schwartz-i vazhdon: "vehabitë thonë që jovehabitë muslimanë nuk janë muslimanë duke nënkuptuar muslimanët sunnit nga pjesa tjetër e komunitetit ndërkombëtarë muslimanë të cilët nuk janë vehabi nuk janë muslimanë". Përsëri një gënjeshtarë ashtu siç mund të dëshmohet nga fakti që pjesa më e madhe e muslimanëve që marrin pjesë në Haxh janë jovehabi. Ka më shumë sesa 2 milion haxhinj këtë vit dhe dihet se qeveria saudite nuk lejon jomuslimanët në Mekë, si mund Schwartz-i të bëjë deklarata të tilla publike pa patur frikën se mund të qeshet? A beson ai që pjesa tjetër e botës ndan obsesionin e tij të verbër me Arabinë Saudite?

Schwartz-i është tallur me kongresin Amerikan me këtë dëshmi fallse që është në realitet jo një dënim kundër vehabive por është një dënim kundër vetë Schwartz-it ashtu si edhe elementëve anti-islami-kë në Administratën e Bushit dhe kongresit që do të sjell një të tillë gënjeshtarë në dhomat e tyre, në gusht.

Amir Butler

Përktheu: Ammar Ardit Kraja

## Kujt i thonë këta Vehabi?

Nëse ke menduar se Vehabizmi për të cilin flasin ca politikanë e shkrimtarë perëndimorë përkufizohet në atë që thirri Muhammed ibën Abdulvehabi në librat, fjali-met dhe mësimet e tij, apo se vehabistë

janë vetëm ata që pajtohen me këtë hoxhë në thirrjen e tij, atëherë ke gabuar.

Tek ata, Vehabizmi është përskrim për çdonjërin që e merr seriozisht Islamin, qoftë edhe prej atyre që s'kanë lexuar



asnjë shkronjë prej ibën Abdulvehabit, veten s'e quajnë me emrin e tij dhe nuk pajtohen me të në disa çështje; porse ky emërtim thjeshtë është përshkrim i atij i cili i pranon me seriozitet disa gjëra konsenzuale të Islamit edhe nëse vetë ai bën disa bidate (1) apo beson në disa gjëra të kota. Vehabizmi tek ata është sinonim i fundamentalizmit i cili do të thotë: të besuarit se i tërë Kur'ani është fjalë e Allahut të Madhëruar dhe se të kapurit për të është obligim i çdo myslimani. Vehabist është myslimani i cili falë pesë kohët e namazit, agjëron Ramazanin, jep zekatin dhe kryen Haxhin nëse ka mundësi. Ai është myslimani i cili nuk pi alkool, s'merret me kamatë, e sheh të ndaluar përzjerjen e meshkujve dhe femrave, nuk beson në ato vlerat të civilizimit perëndimor që janë në kundërshtim me Islamin. Myslmani vehabist është ai i cili mendon se feja e tij është e vërtetë dhe e nxitë atë që njerëzit t'i thërret në Islam. Me fjalë të shkurta, vehabist është çdo mysliman i cili mundohet të kapet për mësimet e fesë së tij edhe nëse jeton në vendet perëndimore.

Si duket ata që u propozuan politikanëve (perëndimorë) që çdo mysliman që praktikon fenë e tij ta emërtojnë kështu, janë disa ekspertë për studim të Islamit. Ndoshta ky propozim i tyre ka qenë për shkaqe politike. Ndoshta u kanë thënë atyre: ju do t'i ngjallni emocionet e myslimanëve nëse u thoni qartë dhe direkt se nuk doni që ata të kapen për Librin e Zotit dhe Sunnetin e Pejgamberit, të marrin fenë me seriozitet, andaj ju bënë një intrigë duke folur për Vehabizmin në vend që të flasin për Islamin apo për Kur'anin dhe Sunnetin nga që në botën islame ka shumë njerëz që kanë probleme me vehabistët, dhe për atë se kanë trilluar shumë

akuza kundër tyre (vehabistëve). Atyre u veshën shumë gjëra që ne i dimë se s'kanë lidhje me ta. Edhe pse ne nuk pajtohemi me ata në të gjitha shkaqet që sollën deri te armiqësimi i Vehabizmit, themi se qëndrimi i tyre armiqësor mund të na ndihmojë në drejtim të realizimit të synimeve tona dhe t'i shërbej interesave tona.

Atëherë, kush është për ta myslimani jovehabist? Është myslimani i cili Kur'anin e kupton ashtu siç i kuptojnë ata librat e tyre, fenë e praktikon ashtu siç praktikojnë ata fenë e tyre. Ai që nuk kundërshton asgjë nga kultura e tyre, nuk thërret në antagonizëm ndaj politikës së tyre edhe nëse mendon se është e padrejtë dhe e dëmshme për vendin e tij. Është ai prej gojës së të cilit s'del asnjë fjalë që ka të bëjë me emrin xhihad. Çdonjëri që bën këtë është armik i tyre dhe pengon të ashtuquajturën interes atdhetar të tyre.

Çdo të thotë të kuptojë fenë ashtu siç e kuptojnë ata fenë e tyre? Ndoshta përgjigje më e mirë për këtë pyetje është fjala e një pasuesi të një kisha episkopale (bëhet fjalë për një kishë amerikane pasuese e kishës angleze). Ky është një prift, quhet Robinson dhe botërisht shpreh çrregullimin e tij seksual. Madje ai shkon nëpër disa shoqëri fetare, së bashku me "bashkëshortin e tij" me të cilin bën imoralitet, Allahu na ruajt! Me gjithë këtë kisha nuk pa pengesë që ky prift të merr një post të lartë, postin e prelatit. Atë e zgjodhi këshilli më i lartë i kishës, me shumicë të votave, përafërsisht me dyzet prej gjash-tëdhjetë votave. Pas fitores, në një konferencë për gazetarë, ky prelat pranoi se kundërshtarët e zgjedhjes së tij kishin pasur të drejtë kur kishin deklaruar se çrregullimi seksual është në kundërshtim me mësimet e kishës, pastaj vazhdoi të thotë:

"të thuash thjeshtë është në kundërshtim me traditat dhe mësimet e kishës, me Librin e Shenjtë nuk do të thotë patjetër te jetë gabim. Ne adhurojmë një zot i cili është i gjallë dhe ky zot na shpjen kah e vërteta."

Pas këtij lajmi, i përkujtova vëllezërit tanë në një hutbe të Xhumasë me hadithin e Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem, i cili ka thënë: "do t'i pasoni traditat e popujve para jush, pëllëmbë pas pëllëmbë derisa edhe nëse hyjnë në vrimën e hardhucit do të hyni edhe ju."

Me këtë kisha për qëllim që të mos habitemi kur të na vjen ndonjëri i cili pretendon se është mysliman dhe të thotë ndonjë fjalë sikur ky prifti apo afërsisht sikur ai, si për shembull të thotë: fakti që një fjalë apo vepër është në kundërshtim me atë që e dinë myslimanët, në kundërshtim me hadithet e Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem, në kundërshtim me ajetet kur'anore nuk do të thotë patjetër që e njëjta të jetë gabim. Them se mu si ky është myslimani që e dëshirojnë disa nga këta të cilët flasin për ekstremizmin, për fundamentalizmin, për Vehabizmin. A nuk i tha Allahu, subhanehu ve teala, Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem: "Në të vërtetë ata (idhujtarët) gati arritën të sprovojnë ty nga ajo që Ne ta shpallëm, e të trillosh tjetër nga çka të shpallëm, e atëherë do të zinin ty mik." (Isra - 73)

Pastaj, a nuk ka thënë Allahu, subhanehu ve teala, për disa jehudij dhe krishterë që kishin ngulur këmbë në mosbesimin e tyre: "As jehuditë, e as krishterët kurrë nuk do të jenë të kënaqur me ty deri sa ta pasosh fenë e tyre." (Bekare - 120)

Tani del në pah se pasimi i fesë së tyre nuk është i kufizuar vetëm në besimin e asaj që ata besojnë, porse përfshinë edhe metodologjinë e kuptimit të fesë dhe

shtrembërimin të saj. Çdonjëri i cili ndjek këtë metodologji për shtrembërimin e fesë Islame dhe për të mos kapë fenë fuqishëm siç ka urdhëruar Allahu, subhanehu ve teala, ata do të jenë të kënaqur prej këtyre.

Në shumë fjalë të tyre duket pakënaqësia e tyre me ata të cilët nuk ndjekin metodologjinë e tyre në kuptimin e fesë Islame. Ndoshta prej rasteve më të qarta është ajo që përmendi ish kryetari Klinton në një ligjëratë që mbajti në universitetin e Washingtonit "Xhorxhton", që e kam përmendur në disa ligjërata dhe e kam debatuar së bashku me disa të rinj në selinë e "Darul Erkam" në Washington.

Prej asaj që e tha Klintoni në ligjëratën e tij ishte: "esenca e mospajtimit mes neve dhe atyre - ka për qëllim myslimanët apo një grup prej tyre - është pasqyrimi ynë i natyrës së realitetit. Ne besojmë se asnjëri prej krijesave nuk e di tërë realitetin, për këtë, mendojmë se çdo njeri ka aspektin e tij. Ata mendojnë se e dinë tërë realitetin, për këtë mendojnë se nëse nuk je mysliman atëherë je kafir (jobsimtar), nëse je mysliman mirëpo nuk pajtohesh me ta në mendime atëherë je bidatxhi (risitar) dhe se në dy rastet ti je në shënjestër edhe nëse je fëmijë gjashtëvjeçar"

Prej asaj që e pata thënë në atë ligjëratën time ishte: nëse me fjalën "i tërë realiteti" është për qëllim njohja e çdo gjëje, ne jemi të parët që e pranojmë se asnjëri nga njerëzit nuk ka këtë cilësi, porse kjo është cilësi e Zotit. Madje edhe nëse është për qëllim njohja e tërësishme e disa gjërave, ne besojmë se vetëm Allahu, subhanehu ve teala, i njeh gjërat në tërësi. Ne nuk dimë gjithçka as për Zotin tonë që e adhurojmë; Ai ka emra që s'na ka treguar për to, mirëpo atë që e dimë për Të, edhe pse është pak, na mjafton që të bindemi se Ai është i

vetmi që meriton të adhurohet dhe se Ai ia zbriti Kur'anin Muhammedit, salallahu alejhi ve selem. Po ashtu edhe dija jonë për gjërat e kësaj bote - e Allahut i takon shembulli më i lartë - është e mjaftueshme për të përfituar nga ato. Ne para se ta dimë se uji përbëhet nga hidrogjeni dhe oksigjeni, e kemi ditur se ai e shuan etjen, se është i domosdoshëm për bimët, se pastron ndyrësirat e kështu me radhë. Përkufizimi i dijes tonë nuk do të thotë relativizimi i realitetit, madje në atë që e njohim - përdërisa është e vërtetë - ka argument të prerë se e kundërta e saj është e kotë.

Gjithashtu pata thënë se kufri (mosbesimi) do të thotë: mohimi i realitetit apo mohimi i asaj që pretendohet se është realitet. Ai që mohon se Muhammedi, salallahu alejhi ve selem, është i dërguar i Allahut duke e ditur një gjë të tillë, ai mohon realitetin dhe është kafir. Ai që mohon ekzistimin e dikujt që meriton të adhurohet pos Allahut, ai sipas shprehjes kur'anore është kafir (mohues) i tagutit (të kotës). Po

ashtu kam thënë se baza e raporteve tona me ata që nuk besojnë në fenë Islame është: thirrja e tyre me urtësi, këshillë të mirë si dhe duke polemizuar në mënyrë më të mirë ngase ne nuk vrasim njeri thjeshtë vetëm pse është kafir përndryshe nuk do të mbetej asnjë prej tyre në këtë botë. Pastaj, si mund që feja jonë të na urdhërojë të vrasim çdo mosbesimtarë kur na lejon të martohemi me gratë e ndershme të ehlulkitabit (jehudijët dhe krishterët)? A mund që të lidhim kurorë me të pastaj t'ia vendojmë shpatën në qafë? E sa i takon fëmijëve të tyre, ata me vendimin e fesë tonë janë muslimanë, e përse t'i vrasim?

Prof. Dr. Xha'fer Shejh Idris  
Shqipëroi: Agim Bekiri

1) Bidat quhet çdo gjë e shpikur në fe e për të cilat na ka tërhequr vërejtjen Muhammedi, paqa dhe mëshira e Zotit qoftë mbi te. Menjanimi i këtyre gjërave ishte një prej synimeve të thirrjes së Muhammed ibën Abdulvehabit. (sh.p.)

## Drejt një mektebi të ri

Mektebet tanë ishin shkollat e para që një kohë të gjatë ishin pjesë e sistemit shkollor deri në kohën kur arsimit në mënyrë artificiale u ndau në atë fetar dhe laik (që i përket kësaj bote). Periudha e shekularizimit mektebet tanë i hodhi në margjinat e arsimit duke e eliminuar dhe reduktuar ndikimin e tyre në sistemin edukativ arsimor. Mësimet në mektebet u banalizuan duke u përqëndruar në mësimin e riteve adhuruese esenciale (namazi, abdesti) gjë kjo e cila shkaktoi humbje të madhe në instalimin e vlerave shpirtërore dhe morale në fazën e formimit të riut.

Megjithatë rëndësia e mektebit asnjëherë nuk është eliminuar tërësisht. Ai vazhdoi të merr përsipër shumë nga obligimet edukativo-arsimore ndaj të rinjve që ishin në fazën e zhvillimit. Vetëdija për rëndësinë e mektebit në ndërtimin dhe ruajtjen e identitetit islam ishte forcë lëvizëse që nxiste bashkësinë islame të ruan mektebet.

Për rëndësinë e mektebit të vetëdijshëm ishin edhe komunistët që u munduan të zhdukun mektebet duke i shtypur dhe përsekutuar punonjësit fetarë.

Mektebi si institucion arriti të përballon sfidat dhe tani në kushtet e reja duhet të

mendohet për kontekstin e veprimtarisë së tij brenda kushteve të posakrijuara.

Të menduarit rreth kësaj rreth kësaj çështje duhet të përqendrohet në këto pika:

Një: Mësimi nëpër mektebet e xhamisë është vetëm një formë e mësimbesimit. Dija për fe përpos në mektebe mundët të përfitohet edhe në shkolla, në mediueme, në tribuna publike dhe ngjajshme. Megjithatë roli i mektebit dita ditës bëhet më i rëndësishëm dhe më kompleks. Ai është një fazë e pashmangshme institucionale në edukimin dhe arsimin e të riut. Menjanimi i kësaj faze do të krijon një zbrastirë në dije dhe praktikë sepse mësimet e mektebit janë themel i dijeve fetare. Planprogrami i mektebit duhet të përpilohet në bashkëpunim me faktorët e rëndësishëm në shoqëri dhe arsim. Zbatimi i këtij planprogrami duhet të jetë frytë i përbashkët e gjithë paleve të interesuara për atë, fillimisht nëpunësit fetarë dhe prindërit.

Dy: Mektebi i "ri" duhet të mbetet lidhja esenciale mes familjes dhe bashkësisë muslimane duke e pranuar dhe integruar anëtarin e ri në xhematin e muslimanëve. Ai nuk duhet të jetë vetëm një stacion i izoluar në udhëtimin e quajtur arsim, por mektebi duhet të bëhet një qendër e vërtetë arsimore (e integruar tërësisht në sistemin edukativo-arsimor) e cila përpos mësimave fetare jep mundësinë e edukimit të mirëfilltë në gjitha aspektet e kësaj fjale.

Mësuesit, nxënësit dhe prindërit duhet të angazhohen që edukimi dhe arsimiti në mekteb të jetë shembullorë, cilësor dhe me përmbajtje të dobishme. Kjo kërkon krijimin e lidhjes së fortë mes mektebit dhe prindërve. Pa inkuadrimin e familjes dimensionit edukativ nuk do të arrihet plotësisht.

Tre: Mektebi është institucioni i vetëm i cili ka ruajtur mënyrën individuale e punës me nxënësit. Edhe didaktika moderne dita

ditës më tepër rëndësi i jep punës individuale me nxënësit pasi që një kohë të gjatë promovonte metodën frontale e mësimdhënies (mësuesi fol nxënësi dëgjon). Ky qëndrim flet për vlerën e kësaj metodologjie (puna me çdo nxënësi vetmas) dhe për nevojën e implementimit të saj në shkollimin duke e kombinuar me mënyrën frontale. Përkrah kësaj mektebi i "ri" duhet të përvetëson edhe metodologjitë e reja të mësimdhënies duke u zhvilluar në institucion që do t'i përfshin gjitha etapat e jetës njerëzore. Me një fjalë do të bëhen shkolla për mësim të fesë gjatë tërë jetës duke e përcjellur jetën e tyre, problemet dhe sukseset e tyre. Mektebi i "ri" do t'i servison nevojat e xhematit duke i përdorur potencialet e xhematit.

Katër: Mektebi modern dhe funksional duhet të përfshin gjitha shtresat e shoqërisë si dhe etapat e zhvillimit të njeriut, të tubon pjesëmarrësit në aktivitetet e tij duke i zgjedhur metodat e përshtatshme për procesin edukativo-arsimor. Tubimi i anëtarëve të xhematit në një vend nxitë dhe stimulon komunikimin cilësor mes tyre duke zbuluar ambientin jetësor. Mualimi si hallkë kryesore në këtë sistem krijon, nxitë dhe udhëheq projektet e mektebit duke i shfrytëzuar, për të mirën e përgjithshme, resurset e xhematit i cili tanimë është integruar në institucionin e mektebit.

Mualimi koordinon punën e pjesëmarrësve në mekteb duke i angazhuar, për shembull, studentët dhe ekspertet e lëmive të ndryshme (mjekë, jurist, ekonomist, inxhinier) në pasurimin e procesit edukativo-arsimor.

Me këtë hap ai ndihmon në vetëdijësimin e individëve në xhemat për rolin e tyre në jetën fetare në rrethin e tyre.

Mektebi i "ri" duhet të jetë i hapur drejt metodave dhe teknologjive e reja që ndih-

mojnë realizimin e synimeve të tij në fushën e vetëdijësimin fetar.

Autoriteti fetar duhet të ndihmon në krijimin e lidhjeve të forta mes shoqërisë dhe mektebit.

Transparenca në punë dhe hapja e tij ndaj shoqërisë ndihmon në promovimin e mektebit. . .

Me një fjalë mektebi duhet të jetë pasqyre e jetës cilësore shoqërore. Mektebi i dobët është pasqyre e shoqërisë së dobët, të paorganizuar, që nuk bashkëpunon dhe neglizhon detyrat e tij shoqërore. Me përmirësimin dhe zhvillimin e mektebit zhvillohet dhe përparon edhe shoqëria. . .

Pesë: Mësimi në mektebin e "ri" bashkon metodat klasike si dhe metodat e kohës moderne. Mësimi organizohet në mënyrë e cila ndihmon në rritjen e interesimit tek nxënësit të cilët me kohë marrin përsipër role të rëndësishme na hallkën edukativo-arsimore.

Në mekteb duhet krijuar kushte në të cilët çdonjëri do të gjenë përgjigje për pyetjet e tij dhe do të zhvillon më tej aftësitë e tij.

Merren parasysh dallimet individuale, nevojat e fëmijëve, e të rinjëve dhe shtresave të ndryshme të shoqërisë duke i zhvilluar prirjet individuale. Duhet krijuar kushte që ndihmojnë shfaqjen maksimale të aftësive dhe prirjeve tek pjesëmarrësit në mekteb. Mektebi i ri nuk lejon pasivizimin e atyre që ndjekin mësimet në mekteb duke krijuar klimën e motivimit, interesimit dhe angazhimit. Me një fjalë ndjekësit të mësimave në mekteb i mundësohet t'i përvjetëson dijet për të cilët ai vetëmse është regjistruar në të.

Mundësitë e nxënëve në mekteb nuk duhet të mbivlerësohen e as të përçmo-

hen. Mual-imi duhet të vepron në drejtim të vlerësimit të saktë të mundësive që i ka ndjekësi i procesit mësimor në mekteb.

Gjashtë: Përpos punës në klasat e mektebit mual-imi duhet të plotëson aktivitetin e tij edhe me veprimtari fakultative jashta mektebit në formë të takimeve spontane, vizitave të planifikuara, kurseve, tribunave, manifestimeve sportive dhe kulturore. Me këtë angazhim shoqëror të mektebit mundësohet veprimtari më e llojlojshme dhe më efektive duke përfshirë bashkësinë e muslimanëve në tërësi. Nga përvoja e deritanishme mundemi të themi: përkufizimi i mual-limit vetëm në aktivitetet e mektebit shkakton uljen e interesimit për mekteb.

Mektebi i ri duhet të zhvillohet si qendër e mësimi aktiv të fesë si dhe qendër e aktiviteteve që zhvillohen brenda xhematit.

Në kushtet e reja mektebi nuk mundet të mbetet vetëm një klasë klasike por duhet të shndërrohet në qendër për aktivitete multidisiplinare gjë kjo e cila kërkon angazhim më të gjërë si dhe investime financiare që do të plotëson kushtet e një qendre mësimore bashkëkohore. Me organizim të mirë dhe me qasje inventive dukshëm mundet të përmirësohet gjendja e mektebit si institucion pranë bashkësisë Islame. Edhe pse qasja jonë problemit disave do t'ju duket jomodeste, ne mendojmë se me vullnet të mirë dhe angazhim të mirëfilltë do të arrijmë që për kohë të shkurtë të përgatisim mektebet tanë për punë si qendra të kompletuara të kyçyra në proceset edukativo-arsimore. Nëse nuk ndërmerren këto hapa mektebi nuk do të mund të zbaton funksionin që e ka prej fillimit të tij.

Ibrahim Begoviq  
Përktheu: Talha Kurtishi

## A duhet vepruar kështu?

El-hamdulillah që All-llahu na ka udhëzu. Fjala Hamd po përkthehet si falenderim e në realitet fjala Hamd në arabisht përdoret kur duhet falenderuar All-llahun dhe njëkohësisht është edhe falenderim edhe lavdërim. Falenderojmë All-llahun për të gjithë të mirat dhe e Lavdërojmë sepse Ai është All-llahu (Zot i gjithëçkaje, i Mëshirshëm, i Drejtë, i Urtë në caktimin e Tij)

Për çdo të mirë që Ai na ka dhënë, All-llahut duhet të i falenderojmë. Ne që jemi musliman All-llahu na ka bërë shumë mirë që na ka udhëzu. Me qenë i udhëzuar kur të tjerët janë të humbur është mirësi e madhe, se shumica janë të pa udhëzuar e pakica e udhëzuar.

Të ndihesh keq kur e sheh një të keqe është mirësi dhe ke shpërblim nëse e shpreh këtë si duhet, psh; me e pa dikend duke pi alkol e me e mbytë nuk bën, ngase po e bën një të keqe më të madhe. Feja islame urdhëron që e keqja të ndryshohet në të mirë e jo me një të keqe më të madhe, e të mirat të ndryshohen në më të mira. Kur e sheh një të keqe duhesh të ndjehesh keq dhe mendo sikur mos të ishe i udhëzuar ku do të ishe ndoshta edhe më keq, ti tashë këtë të keqe duhesh ta ndryshosh me mënyrën më të mirë, mos me leju shejtanim të na mashtroi se ai është shumë i poshtër. Nisesh me e bërë një të mirë me qëllim të mirë, shejtani në moment ta ndryshon qëllimin dhe ti vazhdon duke mendu se je duke bërë mirë me vepër të mirë por me qëllim të keq. Kjo ndodhë më shumë te ata që janë entuziastë, nisesh me e bërë një vepër mirë dhe aty ndodhet një njeri dhe ai me qëllim apo pa qëllim apo prej paditurisë së tij fillon

me kundërshtuar (nuk duhet harruar se janë kundërshtuar burra më të mëdhenj se ne, bile dikush prej tyre është vra) dhe këtij menjëherë fillon të i ndryshoi gjendja, të i vlon gjaku, e ai nëse qëllon edhe si provokator ky i pari nuk është në gjendje të kontrollojë veten e tij! Ashtu prej një nismë të mirë çka mundet me ndodhë. Këtë po e flas se çka po ndodhë te të rinjtë; kur një thirrës ia nisi; po ti qenke i poshtër, po ty po u dashka me ta hjek kokën etj. Tashë çka je duke bërë? Kjo nuk është thirrje, je duke u shfry për një sekondë. Shejtani po ta prishë veprën prej një gjendje më të mirë duke thirrë në rrugën e All-llahut në një gjendje për veten tënde. Shejtani është shumë i poshtër mundohet që të pengon prej një vepre madhështore në saje të një vepër tjetër të mirë e më e pak të vlefshme.

Tregohet një tregim interesant që ndoshta nuk është i vërtetë por përmbajtja e tij nuk është në kundërshtim me ato çka dihen prej metodave të shejtanit.

Një djalë musliman martohet dhe e kalon natën e parë të martesës me nusen e vet, zgjohet në mëngjes dhe ky djali don me u përgatitë për me shkuar me e falë namazin e sabahit në xhami, nusja (edhe nusja muslimane) po i thotë; ndejmë dhe e falim bashkë edhe falemi si xhemat. Ky djali i thotë qe sa vite unë sabahin e fali në xhami dhe edhe se jam martu duhet me shkuar. Niset dhe në errësirën e mëngjesit, rrëzohet dhe përlyhet dhe kthehet me i ndërro rrobat. Nusja po i thotë; a të thashë që të e falim bashkë? Ky i thotë nuk erdha me tu arsyetu e as që kam ndërro mendjen vetëm po i ndërroi rrobat

dhe shkoi prap, herën e dytë i ndodhë e njëjta kthehet ndërron rrobat shkon përsëri dhe herën e tretë e njëjta dhe prap përsëri njësoj vepron; ndërron rrobat dhe shkon në xhami e herën e katër kur niset një njeri e kap për dorë dhe e mban deri te dera e xhamisë. Mbasi shkon deri te dera e xhamisë ky djali e pyet këtë a bënë të di se kush je? E ky i thotë; më mirë mos me e ditë por po të tregoi unë jam shejtani. Ky djali i habitur thotë: a sje ti ai që i pengon njerëzit prej xhamisë, si kështu? Ia kthen a e din se si është puna? Kur dole ti herën e parë me atë sinqeritet dhe me atë devotshmëri dhe kur u rrëzove All-llahu ti fali të gjitha mëkatet, e kur u rrëzove herën e dytë All-llahu ia fali familjes tënde, e kur u rrëzove herën e tretë All-llahu ia fali mëkatet krejt lagjes tënde, e herën e katërt u frigova mos All-llahu po ia falë mëkatet të gjithë muslimanve e unë nuk deshta me u fitu kaq shumë, më mirë me e falë ti sabahin në xhami e mos me u fituar kaq shumë.

Prap po them që mos e merrni këtë tregim bukvalisht si të vërtetë por ideja dhe mësimi prej këtij tregimi është se shejtani mundohet që me çdo kusht, me të lënë pa sevape, nëse e sheh se je këmbëngulës të pengon prej punëve të mëdha në më të vogla, psh; një hoxhë me e bë një vepër që munden me e bë plotë të tjerë.

Sidoqoftë prap po them që ne duhet të jemi të vetëdijësuar se All-llahu na ka bërë shumë mirë pasi jemi të udhëzuar dhe konform këtij udhëzimi duhet të bë edhe falenderimin, kemi obligim ndaj gjithë njerëzve që kemi kontakt duke fillu prej familjes tona ndaj tyre kemi obligimin më të madhë, sa më e madhe të jetë afërsia aq më i madhë është obligimi dhe drejta.

Dikush mendon se nëse ke pasuri dhe don me i ndihmu ndonjërit, duhet prej këtu në përfundim me i ndihmu atyre në lindje apo anasjelltas, më sevap është me i ndihmu këtij afër teje, kushëririt tënd apo vëllaut tënd, sa më e madhe të jetë afërsia aq më e madhe është bamirsia.

Muhammedi, alejhis-selam, kur i ka definuar fqinjët, i ka nda në fqinjë ndaj të cilit kemi tri obligime, fqinjë ndaj të cilit kemi dy obligime dhe ate ndaj të cilit kemi vetëm një obligim.

Tri obligime i kemi ndaj fqijut që është musliman dhe e kemi farefis (të afërm nga gjaku) dy obligime i kemi ndaj fqijut i cili është musliman, obligimet ndaj muslimanit dhe obligimet e fqijut, ndërsa ndaj atij fqiu që nuk është musliman i kemi obligimet e fqinjësisë.

Ne duhet ditur se një nga metodat e thirrjes është edhe thirrja me vepra të mira se njerëzit janë bezdis me fjalët dhe atyre po u duhen vepra reale. Dhe duhet dite se do të kaloj një kohë derisa njerëzit të vetëdijësohen për këtë. Siç e kërkon nevoja te thërrasim në islam dhe të njoftojmë për islamin dhe tani të ndikoi pozitivisht te i thirruri, dhe duhet ditur se mediat që janë të udhëhequra nga përfundimi po shpifin ndaj islamit dhe po i gjejnë të metat e muslimanëve dhe po mundohen që njerëzit të i largojnë nga islami dhe prej neve kërkohet urgjentisht dhe intezivisht që të veprojme si është më së miri dhe ta paraqesim islamin si duhet dhe tani shpresojmë se njerëzit që nuk janë në islam do të kuptojnë propagandën anti-islame dhe masovikisht do të pranajnë islamin dhe historia islame do të përsëritet. Ngase feja islame është fe që i përshtatet natyrës së krijimit të njeriut dhe është në dobi të njeriut dhe shoqërisë. Falenderimi i takon All-llahut.

Kasim Jakupi

## Si të bëhemi durimtarë?

Shprehia ka një ndikim të pamasë në sjelljen tonë. Pejgamberi, paqa e Allahut qoftë mbi të, ka dëshmuar këtë duke thënë: “ Mirësia është shprehi” [Sunen Ibën Mâxhe (221)]

Pa dyshim se, ne hasim në numër të madh të vështirësive kurdo që mundohemi të imponojmë vetës sonë normë të sjelljeve me të cilat nuk jemi mësuar. Megjithëse, nëse ngulim këmbë për një kohë dhe kërkojmë ndihmën e Allahut do të gjejmë kënaqësi në atë që kemi arritur rezultate kuptimplota.

Pejgamberi, paqa e Allahut qoftë mbi të, na ka mësuar se këmbëngulsia në diçka paguhet dhe ka thënë: “Kushdo që ushtron durimin, Allahu do ta bëjë atë të durueshëm”

Megjithatë, nuk bënë të harrojmë faktin se kjo është një rrugë që kërkon përpjekje maksimale. Disa njerëz besojnë se kjo praktikisht është e pamundur për tu arritur. Kjo është pse Pejgamberi, paqa e Allahut qoftë mbi të, ka thënë në një rast: “Vetëpërmbytja arrihet vetëm duke praktikuar atë”. Vetëpërmbytja dhe durimi janë dy anët e një monedhe.

Pejgamberi më pas ka dhënë një shembull nga përvoja e përditëshme duke thënë: “Dituria arrihet vetëm duke mësuar”. Ky është një fakt i dukshëm që askush nuk mund ta mund, Pejgamberi, paqa e Allahut qoftë mbi të, përdori këtë shembull të qartë dhe të thjeshtë që të na tregoj në mënyrë të qartë se si ta bëjmë shprehi durimin. E tëra kthehet në praktikimin e vetëpërmbytjes dhe durimit. Ne duhet ta bëjmë shprehi durimin.

Nëse ne mendojmë në këtë, çdo vit, ne kemi një ushtrim praktik të durimit gjatë muajit të Ramazanit. Ramazani na kushtëzon dhe na ushtron ne që të jemi të durueshëm në aspektet tona ditore. Nëse ndodh të ngritemi vonë gjatë ditëve të Ramazanit dhe vetëm se ka

kaluar koha syfyrin, ne as që mund të mendojmë sikurse tani; se është normale të ushqehemi, pa marrë parasyshë se sa të uritur ne mund të ndjehemi.

Paramendo se çka mund të arrij një duhanxhi gjatë muajit të Ramazanit. Zakonisht, ai mendon se nuk do kishte mundur ta lë duhanin në ditën e ardhme. Megjithëse, në mbrëmje të ditës së parë të Ramazanit, ai veqse është i ngarkaur duke kushtëzuar mendjen e tij në faktin se nesër nuk do të mund të pijë duhan gjatë tërë ditës. Deri në perëndim të diellit.

Kjo nuk është vetëm për një ditë. Është për tërë muajin. Ai do të ndërrojë shprehinë e duhanit për 29 apo 30 ditë, edhe pse gjatë tërë pjesës së mbetur të vitit sa herë që ai ta ndezë një cigare arsyetohet tek njerëzit se si nuk mund ta lë duhanin dhe e ka një shprehi të paharrueshme. Ai do të vajtoj se si sa e sa herë është munduar ta lërë duhanin por ka dështuar.

Pavarësisht nga kjo, ne mund të jemi të sigurtë që nëse muaji i ramazanit do të ishte obligim për dy muaj në vend të një muaji, ai do ta kishte lënë duhanin për dy muaj rresht gjatë tërë ditës. Kjo nënkupton faktin se për të gjithnjë ka qenë në pyetje fuqia e vullnetit në një anë dhe shprehia e tij në anën tjetër.

Në një mënyrë ne mund ta mësojmë vetën që të ushtrojmë durimin është që të lexojmë sa më shumë për jetën e njerëzve të cilët kanë qenë shembuj në durimin e tyre. Për shembull, ne mund të mësojmë nga jeta e dijetarit të madh Ahmed b. Hanbel, përreth torturimit të tij në burg për shkak të insistimit të tij në atë që Kurani nuk ka qenë i krijuar. Ai shfaqti durimin maksimal në persekutimin dhe goditjet e përsëritura me kamxhik në kohën kur trupi i tij ishte i lodhur dhe eshtrat e tij ishin të lakuar nga pleqëria.



Gjithashtu ne mund të forcojmë vendosmëri në tonë nëpërmes meditimeve si dhe ne duhet të mendojmë gjëra pozitive në kohën kur goditemi me atë që sprovon durimin tonë.

Ekziston një tregim për një njeri i cili ka qenë i verbër dhe që ka humbur duart dhe këmbët e tij në luftë. Një njeri tjetër e ka parë dhe ka vërejtur se gjuha e tij është e zënë në përmendjen e Allahut. Njeriu u irritua me të dhe iu drejtua të verbërit duke i thënë: “Për çka duhet të jeshë falenderues në Allahun, kur ti je në këtë gjendje - i verbër dhe pa duar e këmbë?”

I verbëri i përgjigjet duke i thënë: “Unë e falenderoj Allahun që ende e kam gjuhën me të cilën e përkujtoj Atë”

Kur ne përkujtojmë vetveten në atë se çfarë shpërblimesh ka përgatitur Allahu për ata që

janë të durueshëm, është shumë më lehtë për ne të arrijmë qëndrueshmërinë që na duhet. Mund të na sjell deri në atë pozitë që durimi do bëhet shprehi e jonë.

Allahu thotë: “Ne do t’ju sprovojmë me ndonjë frikë, me uri, me ndonjë humbje nga pasuria e nga jeta e edhe nga frytet, por ti përgëzoj durimtarët. Të cilët, kur i godet ndonjë e pakëndëshme thonë: “Ne jemi të All-llahut dhe ne vetëm te Ai kthehem!” Të tillët janë ata që kanë bekime prej Zotit të tyre dhe mëshirë dhe të tillët janë ata të udhëzuarit”. [Sure Bekare: 155-157]

Allahu thotë: “të durueshmive u jepet shpërblimi i tyre pa masë!” [Sure Zumer: 10]

Allahu na bekoftë dhe na bëftë prej durimtarëve.

Shkroi: Shejh `Abd ul-`Aziz el-Mukbil  
Përktheu: BM / Marrë nga: islamtoday.com

## Thënia e së vërtetës është rruga drejt Xhenetit

Nuk është e nevojshme të theksohet se thënia e të vërtetës është virtyt, që vlerësohet nga të gjithë njerëzit e ndershëm, pa dallim feje. Nga përvoja e secilit dimë se njerëzit pëlqejnë individët e ndershëm dhe që thonë gjithmonë të vërtetën. Një njeri i cili thotë gjithmonë të vërtetën i sjell shoqërisë, veçse dobi dhe mirësi. Për rrjedhojë, gënjeshtria nuk i këshillohet një myslimani të mirë. Nëse do të ishte i mundur materializimi i gënjeshtres, ajo sigurisht që do të kishte një pamje të pështirosur dhe secili do të përpiqej t’i shmangej asaj! Thuhet se gënjeshtria i ka këmbët e shkurtra prandaj gënjeshtarët nuk mund t’i shmangen për një kohë të gjatë turpit dhe poshtërimit.

Fatkeqësisht, në ditët e sotme gënjeshtria prezantohet si veti pozitive. Një pjesë

e mirë e njerëzve, mendojnë se nuk ka ndonjë gjë të keqe nëse dikush gënjen për llogari të përfitimit vetjak apo familjar. Me dhimbje mund të kontastojmë se gënjeshtria ka gjetur vend tek shtresat e ndryshme të shoqërisë, duke përfshirë edhe disa myslimanë. Njeriu i thjeshtë bën pyetjen se përse duhet të thotë të vërtetën kur sheh se të tjerët, sidomos ata që duhet të jenë shembull për të gjithë, nuk sillen kështu. Në ditët e sotme gënjejnë jo vetëm politikanët dhe njerëzit e fesë, por edhe biznesmenët, agjensitë e reklamave, mediat dhe shumë të tjerë.

Vetëm se, këto fenomene të sipërpërmendura, nuk na japin të drejtën ne të tjerëve që të ndjekim tendencat e negative dhe të gabuara, të cilat mbizotërojnë në shoqërinë e sotme. Është obligim për ne, që

t'i luftojmë këto sëmundje shoqërore dhe t'u tregojmë të tjerëve se mund të sillësh edhe ndryshe. Me një fjalë, të jetosh në bazë të mësimëve të Kuranit dhe Syneetit është jo vetëm e mundur dhe e dëshirueshme por edhe e dobishme dhe fitimprurëse.

Ata myslimanë, që gënjejnë dhe mashtrajnë gjatë veprimtarisë së tyre, duhet ta dinë se rruga e tyre nuk do të ketë një përfundim të mirë ose të lumtur. Allahu në Kuranin fisnik e ngre lart virtytin e thënies të së vërtetës duke e demonstruar këtë edhe nëpërmjet shembullit të pejgamberëve, besimtarëve dhe martirëve, si veti e natyrshme e tyre. Allahu nëpërmjet Kuranit na bën hirrje që ta bëjmë tonin këtë viryt e t'i qëndrojmë atij besnik në çdo rrethanë: „O ju që besuat! Ta keni në kujdes (frikë) Allahun dhe të jeni me ata të drejtit (që thonë të vërtetën).“ (Kurani fisnik, 9:119)

Qëllimi më i lartë i çdo myslimani duhet të jetë kalimi me sukses i sprovimeve të besimit dhe arritja e Xhenetit (Parajsës). Pejgamberi Muhamed, paqja dhe shpëtimi qofshin me të, në hadithin e mëposhtëm na tregon sesi është e mundur të arrihet kjo: „Përmbajuni së vërtetës (thënies së saj), sepse ju drejton nga e mira, dhe e mira ju çon drejt Xhenetit. Me siguri, çdo njeri, i cili thotë gjithmonë të vërtetën dhe i përmbahet asaj me kembëngulje, është regjistruar tek Allahu si siddik (i vërtetë, thënës i së vërtetës). Shmangiuni pra gënjeshtërës, sepse gënjeshtera ju drejton nga e keqja dhe e keqja ju çon drejt Xhehenimit (Ferrit). Me siguri, çdo njeri, i cili gënjen vazhdimisht është regjistruar tek Allahu si gënjeshtar.“

Thënia e së vërtetës është një nga mjetet me të cilat myslimani mund të fitojë zemrat dhe simpatinë e të tjerëve. Thënia

e së vërtetës e motivon njeriun që të kryejë vepra të mira dhe fisnike.

Nëse do t'i hidhnim një sy, përvojës dhe shembullit të myslimanëve të parë me në krye Pejgamberin e dashur, do të konstatojmë pa vështirësi se të gjithë pa përjashtim thonin të vërtetën. Ata janë për ne shembujt e duhur për t'u ndjekur dhe jo idhujt fallco, të cilët aktualisht na prezantojnë si bartësit e suksesit dhe stilit përparimtar të jetesës.

Halifi i dytë i islamit, Omer ibën Hatab ka thënë për të vërtetën: „Thuaj të vërtetën edhe nëse kjo mund të të kushtojë kokën!“ Gjithashtu, më tej është shprehur: „Ai që thotë të vërtetën, arrin me sinqeritetin e tij atë që një gënjeshtar s'mund ta arrijë kurrë me mashtrimet e tij!“

Një kushëri i afërt i Pejgamberit, komentuesi i famshëm i Kuranit, Ibën Abasi është shprehur me një shprehje të bukur: „Ka sukses ai njeri që ka këto veti: sinqeritetin (thotë të vërtetën), modestinë, karakterin dhe mirënjohjen“.

Sunduesi nga Emevitët, Omer ibën Abdul Aziz, i cili quhej ndryshe edhe si i pesti prej halifëve të drejtë, ka thënë për gënjeshtërën: „Nuk kam gënjyer qysh kur jam ndërgjegjësuar se gënjeshtera e diskrediton njeriun.“

Mendimtari i madh islam, Imami el-Evzai, i cili ka jetuar në Levant është shprehur: „Beto hem në Allah! Nuk do të gënjeja edhe sikur nga qielli të vinte shpallja se gënjeshtera është hallall!“

Jusuf ibën el-Esbat ka thënë: „Një natë në sinqeritet para Zotit ka më tepër vlerë për mua, sesa lufta në rrugën e Tij.“

Imami Shabi ka thënë: „Përmbajuni së vërtetës edhe atëherë kur mendoni se kjo mund t'ju dëmtojë, pasi më vonë do ta shikoni se kjo do t'ju ndihmojë, dhe

shmanguni gënjeshtërs edhe atëherë kur mund t'ju duket se kjo do t'ju ndihmojë pasi më vonë me siguri do ta shikoni se kjo do t'ju dëmtojë.“

Sundesi i famshëm Abdul Malik ibën Mervan mësohet t'i ketë thënë mësuesit të djemve të vet: „U mëso atyre të thonë të vërtetën, (po me aq përkushtim) si ua mëson Kuranin.“

Të gjitha thëniet, këshillat dhe fjalët e mençura të paraqitur mësipër përforcojnë mendimin, se thënia e së vërtetës ka qenë, është dhe do të jetë virtyt tipik i besimtarëve dhe qytetarëve të ndershëm.

Me anë të sinqeritetit dhe së vërtetës, i shmangemi më mirë problemeve dhe së keqes. Me anë të tyre kalojmë me sukses sprovimin në kompaktësinë e besimit tonë, duke i hapur rrugën vetes drejt Parajsës ku do të takohemi me të gjithë pejgamberët dhe besimtarët e devotshëm.

Prandaj vëllezër, të tregojmë kujdes që të themi gjithmonë të vërtetën dhe vetëm të vërtetën e të mos gënjejmë apo shpifim për gjëra që s'përputhen me realitetin dhe të vërtetën. Të vërtetën duhet ta thotë secili prej nesh dhe sidomos, ata që merren me biznes ose që u ofrojnë të tjerëve shërbime.

Muslimani duhet të thotë të vërtetën kudo, si në punë ashtu dhe në çdo aktivitet tjetër. Muslimani duhet të thotë të vërtetën dhe të sillet me edukatë ndaj të gjithëve, qofshin këta muslimanë apo jo.

Muslimani duhet të përpiqet që përkushtimi i tij ndaj fesë të jetë i sinqertë. Secili prej nesh duhet t'i drejtohet Allahut dhe t'i lutet Atij që t'i japi fuqi të mjaftueshme për të kryer me devotshmëri obligimet që rrjedhin nga aspekti fetar e jofetar.

Muslimani duhet të thotë të vërtetën pasi gënjeshtër është një ves i keq. Ai duhet të jetë i sinqertë pasi këtë e kemi obligim nga Allahu dhe i Dërguari i Tij, Pejgamberi Muhamed, paqja dhe shpëtimi qofshin me të. Muslimani duhet të thotë të vërtetën dhe s'duhet të gënjejë pasi kjo është shenjë e besimit të fortë tek Allahu dhe shpalljet e Tij. Muslimani duhet të thotë të vërtetën, sepse njerëzit do ta pëlqejnë atë dhe do ta respektojnë në ndryshim nga mashtruesit të cilët përbuzen dhe izolojnë nga shoqëria nën frikën e tradhtisë dhe karakterit të tyre të paparashikueshëm.

Me thënien e së vërtetës muslimani siguron qetësinë shpirtërore, në kontrast të plotë me mashtruesit dhe gënjeshtarët që janë në tension të përhershëm nga fakti se mund të zbulohen dhe diskreditohen në mënyrë të turpshme.

Duke përfunduar dua të rikonfirmoj edhe njëherë me krenari se vetia e thënies të së vërtetës është dhuratë e paçmuar nga Allahu. Siç e përmendëm edhe mësipër thënia e së vërtetës na çon drejt Xhenetit (Parajsës) dhe na mbron nga zjarri i Xhehenemit (Ferrit). Personaliteti i madh që mishëron shembullin më të përkryer që duhet të ndjekim si besimtarë - pejgamberi i dashur Muhamedi, paqja dhe shpëtimi qofshin me të, na inkurajon që të themi vetëm të vërtetën dhe t'i shmangemi gënjeshtërs edhe kur bëjmë shaka. Në një hadith ai është shprehur: „Atij që i shmanget gënjeshtërs qoftë edhe kur bën shaka, i garantoj një shtëpi në mes të Xhenetit (Parajsës)“.

O Zot! Na ndihmo që të themi vetëm të vërtetën. Na ndihmo t'i përmbahemi shpalljes Tënde dhe të mbrojmë besimin Tënd. Ki mëshirë për ne o Zot i madh, na i fal gjynahet dhe na prano në Xhenet, Amin!

## Balsami i lumturisë

### Ku është lumturia?

Ata që bredhin pas lumturisë së rrejshme dhe që nuk besojnë në All-llahun, subhanehu ve tealë, dhe ia kanë kthyer shpinën rrugës së besimit, ata nuk mund të arrijnë askund përpos se në podrumin e mashtrimit, sepse kanë neglizhuar veçoritë e natyralitetit (fitres) që gjinden në thellësitë e njeriut, i cili është krijesë ku nuk mund të ndahen kërkesat e trupit nga kërkesat e shpirtit. Kurse shpirti është esenca e jetës së njeriut.

All-llahu, subhanehu ve tealë, ka krijuar njeriun dhe i ka sqaruar rrugën e lumturisë së tij dhe ia ka tërhjekur vërejtjen nga rruga e vuajtjes, sepse Ai është i Gjidijsmi, sikurse dhe thotë: "A nuk e di Ai që ka krijuar, kur dihet se Ai depërton në thellësi të sekreteve, i njeh hollësitë". (El-Mulk: 14).

All-llahu, tebareke ve tealë, është Ai që di se çka është në të mirën tënde dhe çka ta çon jetën drejt dhe përhap shpirt qetësues dhe gëzimin tek ti: "(Musai) Tha: "Zoti ynë është Ai që çdo sendi i dha formën e vet, pastaj e udhëzoi atë?". (Taha: 50).

"Ne e udhëzuan atë në rrugë të drejtë, e ai do të jetë: mirënjohës ose përbuzës". (El-Insan: 3).

Pasi që prodhuesi ia përcakton atë çka i përshtatet prodhimit të vet dhe përcakton mënyrën e saktë të aktivizimit dhe veprimit të tij, çka mund të themi për këtë krijesë gjigante njerëzore, të cilin devijantët dëshirojnë ta largojnë nga udhëzimi i Zotit të tij dhe pastaj iluzionojnë se do të mbeten në rrugën e saktë pa defekte dhe kundërthënie?!

Pasi që njeriu e humbi rrugën e tevhidit, monoteizmit, filloi të hulumton rrugë të ndryshme dhe të shumta për t'u përgjigjur kërkesave të shpirtit dhe për të adhuruar Krijuesin. Paramendon nxemjen e diellit, ndriçimin e hënës, flakën e zjarit, ose idhujt, statujat dhe hyjnitë e rrejshëm të cilave u nënshtrohen njerëzit, e mendon se me këtë veprim i përgjigjet natyralitetit të tij dhe kjo është vet lumturia!!

Edhe pse shkenca moderne ka përparuar shumë, problemet psikike dhe shoqërore të individëve dhe shoqërive edhe më tej shtohen, madje këto shkenca të cilat supozohet se duhet t'i ofrojnë njeriut komoditet dhe t'ia pakësoj lodhjen, janë bërë shpatë që i ri mbi kokë njerëzve dhe armë me të cilën i fuqishmi e shkatërron të dobtin, i shfrytëzojnë për nevojat dhe lakmitë e tyre duke ua shkelur nderin, shtypur njerzishmërinë dhe nëpërkëmbur shpirtin e tyre me llojlloj armësh që për një minutë korrë jetën e qindra dhe mijëra njerëzve.

Ah dhe vaj për këtë qytetërim dhe civilizim fatzi!!

Njerëzimi ka korrë suksese në shkenca të ndryshme, mirëpo cila është gjurma e kësaj në jetën e saj? A ka gjetur lumturinë? A ka qetur qetësi? A ka gjetur paqë?

Asesi! Ka gjetur vuajtje, strese, frikë, sëmundje psikike dhe nervore dhe krime të mëdha.

Shkenca, e cila duhet, sipas mësimave të All-llahut, që secilin fitore ta bëjë një hap drejt All-llahut, mu ajo është bërë shkak që e largon njerëzimin shumë hapa nga rruga e lumturisë së vet për shkak të fikjes së shpirtit dhe mprapshtjes së tij.

Jemi duke parë realitetin e hidhur të njerëzimit, kurse në horizonte jemi duke parë flamurin e shpëtimit që valon në mes të shkretëtirës dhe një kullë llambe ndriçimi që u bën dritë atyreve që janë zhytur në kënetë. (shiko: "Fi Dhalilil-Kuran", 1/440).

Gjithsesi! Është fe e natyralitetit që i ofron njeriut lumturi të vërtetë, i siguron qetësi dhe kënaqësi, kurse kontrollin e ndërgjegjës dhe pasionit e bën rregullues i cili e pengon njeriun ti bëhet armik vëllaut të tij njeri, ia mëson secilit të drejtat dhe detyrat, e shtyen në veprë konstruktive duke patur për synim fitimin e kënaqësisë së All-llahut, pastron shpirtin dhe përmirëson sjelljen.

### Një dhuratë me disa margaritarë

#### Lumturia dhe vuajtja

Imam Ibën Kajimi, rahimehull-llah, thotë: "Nëse zgjohet njeriu dhe ngrysë duke mos patur synim tjetër përpos All-llahut, All-llahu do të mer përsipër të gjitha nevojat dhe brenat e tija e do ti zbrazej zemra që vetëm Ate ta do, kurse gjuha vetëm Ate ta përmend, kurse gjymtyrët vetëm Ate ta respektojnë. Nëse gdhin dhe ngrys duke patur synim të vetin dynjanë, All-llahu ia le brenat, vështirësitë, vuajtjet dhe e le vetëm. Zemra e këtij njeriu angazhohet me dashurinë ndaj krijesave tjera dhe nuk ka vend për dashuri ndaj All-llahut, gjuha e tij është e angazhuar me përmendjen e tjerëve dhe nuk ka kohë për ta përmendur All-llahun, gjymtyrët i lodhen duke u shërbyer njerëzve dhe nuk ka mundësi ta respektojnë All-llahun. Ai lodhet dhe raskapitet sikurse kafshët e egra duke u shërbyer tjerëve, sikurse cakulli i farkëtarit, e fryen barkun e vet dhe i mbush brinjët për tu bërë dobi tjerëve. Secili njeri që braktis adhurimin e All-llahut, respektin e Tij dhe dashurinë ndaj Tij sprovohet me adhurimin, respektin dhe

dashurinë e krijesave. All-llahu, tebareke ve teala, thotë: "Kush mbyll sytë para këshillave të Zotit, atij ia shoqërojmë një djall që nuk i ndahet kurrë". (Ez-Zuhruf: 36). ("El-Fevaid", fq. 84).

#### Nozulli më i mirë

- Sot bleje vetveten, sa është tregu i hapur, i posedon paratë, malli është i lirë, sepse do të vijë një ditë kur nuk do të ekzistojë as ky treg e as ai mall, kjo është dita e mashtrimit (dështimit).

- Vepra pa sinqeritet dhe pasim të Sunetit është sikur një udhëtarë i cili e mbush strajcën e tij me rërë, i bëhet rëndë, por ska dobi.

- Ai që shijon ëmbëlsinë e shëndetit i vjen lehtë idhëtina e durimit.

- Lakmia e madhe për të arritur në qëllim ta imponon veprimin serioz dhe kujdesin e madh që mos të ikë ajo që synon.

("El-Fevaid", fq. 49-50).

- Kur të del ylli i ambicjes në erësirën e natës së përtesës dhe ta shoqëron hëna e vullnetit, i shndërritet toka e zemrës me dritën e All-llahut.

("El-Fevaid", fq. 51).

#### Çka është lumturia

Lumturia - është koncept te i cili nuk mund të arrish me thesare nga ari dhe argjenti, sepse është më i shtrenjtë se ari dhe argjendi.

Lumturia - është sikur margaritari që gjindet në thellësitë e detit, ka nevojë për zhytës të shkathët që di të zbulon thellësitë e detit.

Lumturia - është qëndrime, fjalë, synime, këndvështrime mbi jetën me realitet, shpresë, aspiratë dhe vizion.

Hulumto brenda teje, sepse aty në ato thellësira gjindet lumturia, aty është burimi që nuk shuhet.

Nëse pyesim: çka është lumturia?

Sipas një ankete që i është bërë 16 mijë njerëzve me këtë pyetje, përgjigjet e tyre kanë qenë të këtilla:

38% kanë thënë se lumturia është dashuria.  
 28% kanë thënë se lumturia është kënaqësia.  
 17% kanë thënë se lumturia është shëndeti.  
 7% kanë thënë se lumturia është martesë.  
 5% kanë thënë se lumturi është pasuria.  
 3% kanë thënë se lumturi janë fëmijët.  
 2% kanë thënë se lumturia është udhëtimi.

Abas Mahmud Akadi thotë: kisha një mik piktor, i cili kishte imagjinatë të pasur dhe një ditë imagjinoi lumturinë dhe e vizatoi në formë të një vashe në moshën njëzet vjeçare, e cila vrapon djathtas dhe majtas e lumtur, flokët i hedhen në të majtë dhe në të djathtë gjersa ajo gjindet në kulmin e gëzimit, argëtimin dhe galdimit, e ma tregoi. I thash: unë nuk e imagjinoj kështu lumturinë.

Një: Për këtë mund të themi se është argëtim, gëzim apo kënaqësi.

Porse lumturia është diçka tjetër.

Lumturia është më afër përvojës dhe eksperiencës se sa mashtrimin, adoloshencës dhe injorancës.

Lumturia është më afër moshës së pjekur se sa kësaj moshe ku ka shumë galdim rinor, gjallëri dhe fuqi.

Dy: lumturia ka domethënie të mjaftimit dhe qetësisë.

Nuk është zhurmë dhe britmë.

Lumturia është shije, emocion dhe ndjenja brenda njeriut, në zemër dhe ndërgjegje.

Nuk mund ti vëndojmë definicionin sikurse zakonisht vëndohet në libra definicion për secilën shkencë.

Lumturia nuk pikturohet me kufinj dhe definicione.

Ndoshta lumturia troket në dyert tona, kurse ne nuk e njohim dhe e injorojmë e nuk ja hapim derën.

Ndoshta i vjen lumturia njeriut dhe e jeton me tërë potencialin e tij logjik, shpirtëror dhe fizik, mirëpo nuk e heton.

Sikurse është lumturia e fëmijëve, të cilët janë të lumtur në jetën e tyre, në argëtimin, pafajësinë, lojërat dhe thjeshtësinë e tyre, mirëpo ata megjithkëtë nuk e hetojnë lumturinë, e kur të rriten, të lexojnë, të kuptojnë dhe të dëgjojnë për atë që quhet lumturi, fillojnë ta hulumtojnë, sikurse të jetë diçka e humbur.

Po të ishte lumturia në pasuri, ari, argjend, dollar, gjiro llogari, do të ishin kodrat, minierat dhe bankat më të lumturit, sepse ato kanë shumë këso gjërash.

Po të ishte lumturia në bukuri, shkëlqim, pamje magjepse, e stolisje do të ishin palluat të lumtur, trandafili, lulet, bozuloku.

Po të ishte lumturia në pushtet dhe fuqi, e zë të madh, do të ishin kafshët e egra më të lumtur se njeriu.

Po të jetë lumturia në moralin e vlefshëm, fjalët e drejta, veprat e mira, autoriteti i madh, mendjepjekuria, atëherë njeriu këtë do ta meritonte.

Lumturia është:

Buzëqeshja e një fëmijut të dliër;

Fjalët e mira dhe përmendja e All-llahut kur dalin nga një gjuhë e pastër dhe e vërtetë;

Rahja e zemrës tolerante ndaj vëllezërve të tij musliman;

Dhurata pa përmendje dhe mburrje;

Largimi i një brengës tënde ose të ndonjë vëllaut tënd musliman prej All-llahut, subhanu ve teala;

Qëllimi fisnik të cilin e arrinë ti ose dikush tjetër prej muslimanëve;

Një çast i lodhjes, raskapitjes dhe djersës, të cilën e pason një rehati dhe një sukses;

Mendjemëdhënjtë, perandorët, zullumçarët, kriminelët, pasanikët ndodh që të dalin prej kësaj dynjaje dhe mos të provojnë atë më të bukurën në te: shoqërimin e All-llahut dhe lumturinë e lutjes drejtuar Atij.

### Udhëzimi i pejgamberëve drejt rrugës së lumturisë

Imam Ibën Kajimi, rahimehull-llah, thotë: "Nuk ka rrugë që të shpien drejt lumturisë dhe shpëtimit në dynaj dhe ahiret, përpos se në duar të pejgamberëve. Nuk ka rrugë për të mësuar të këndshmen dhe të fliqurën në mënyrë detale përpos se nga ana e tyre. Nuk arrihet kënaqësia e All-llahut asnjëherë përpos se në duar të tyre. Fjalët, veprat dhe morali i mirë është udhëzimi i tyre dhe ajo që na e kanë sjellur ata. Ata janë peshoja e saktë me të cilën i peshojmë fjalët, veprat dhe sjelljen tonë. Pasi mi i tyre bën dallimin e njerëzve të udhëzuar nga ata të devijuar. Nevoja për ta është më e madhe se sa nevoja e trupit për shpirtin, e syrit për dritën dhe e shpirtit për jetën.

Çka mendon për ate që nëse të mundon udhëzimi i tij për një çast të prishet zemra e i ngjan peshkut i cili ndahet nga uji dhe vëndohet në fërtere?!

Gjendja e robit kur zemra e tij largohet nga mësimit e pejgamberëve i ngjan kësaj gjendje, madje është edhe më e vështirë, mirëpo këtë e heton vetëm zemra e gjallë, sepse i vdekuri nuk ndien dhimbjen.

Nëse lumturia e një njeriu në dy botërat qenka e ndërlidhur me pasimin e udhëzimit të Muhammedit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, atëherë secili që ia do vetes të mirën, shpëtimin dhe lumturinë duhet ta mëson udhëzimin dhe jetëpërshkrimin e tij aq sa të del nga mesi i injorantëve dhe të rreshtohet në rradhët e pasuesve, palës dhe grupit të tij. Njerëzit kundrejt kësaj janë mes atij që shumë kujdeset për këtë gjë, ose pak, ose tërësisht privohet nga kjo mirë. Dhuntia është në Dorë të All-llahut, kujt të Do ia jep, sepse All-llahu është pronar i Dhuntive të mëdhaja". ("Zadul-Mead": 1/69-70).

Transmeton Dejneveriu nga Utbe ibën Velidi, i cili thotë: një grua prej tabiinëve thoshte: Subhanall-llah! Sa e ngushtë është rruga për

atë që Ti nuk je udhërrëfytes i tij dhe se e trishtueshme është rruga për ate që Ti nuk je shoqëruesi i tij". ("El-Muxhalese ve Xhevahirul-llmi", 8/69).

Kurse Muhamed Dijaudin, Sabuni, në poezinë e tij thotë:

Lumturia është qëllim i kërkuar

Lumturia e njeriut është devtoshmëria e tij

Frika prej Zotit është lumturi dhe tregti

Kënaqësia e Dominuesit është aspiratë e jona  
Vetëm All-llahun ke frikë

Sepse Ai është i Madhi që meriton ti kemi frikë. ("Rubajjat min Meke", fq. 98).

### Lumturia e zemrës është në kënaqjen e Allahut

Ai që ka frikë nga Zoti i vet dhe përpigjet për All-llahun me sinqeritet, e pastron shpirtin e tij duke respektuar Mikun e vet, subhanehu ve teala, fiton mirësitë e dynjasë dhe të ahiretit dhe i paguhen veprat pa llogari.

Shikoni sa bukur sqaron Imam Ibën Kajimi, rahimehull-llah, duke thënë: "Zemrat nuk fitojnë atë që dëshirojnë derisa të lidhen me Zotin e tyre, kurse nuk ka mundësi të arrijë deri te Zoti i vet nëse nuk është i pastër dhe i shëndoshë, kurse këtë nuk mund ta arrijë përpos se duke kundërshtuar epshin e vet, sepse epshi i tij është sëmundja, kurse kundërshtimi është shërimi, e nëse dominon sëmundja mund ta mbyt. Ashtu sikurse ai që e largon veten nga epshi fiton xhennetin si vendbanim të vetin, ashtu edhe zemra e tij në këtë dynja, është në xhennetin e dynjasë, begati, të cilës nuk i ngjan asnjë begati tjetër... Mos mendo se fjala e All-llahut: "E s'ka dyshim se të mirët janë në kënaqësinë e përjetimeve (në xhennet). Dhe se mëkatarët janë në xhehennem". (El-Infitar: 13- 14).

Kanë të bëjnë vetëm me begatinë e xhennetit dhe vuajtjet e xhehenemit të ahiretit, por në tre dynjatë e njeriut: në dynja, në berzah dhe në ahiret. Ata janë në begati dhe kënaqësi, kurse ata tjerët në vuajtje. Çka mund të

jetë begatia përpos begatisë së zemrës ose çka mund të jetë denimi dhe vuajtja përpose vuajtjes së zemrës? A ka denim më të ashpër se sa frika, brenga, mërzia dhe ngushtica e gjoksit". ("Sëmundja dhe llaçi", fq. 82).

Ai që përpiqet për ta pastruar shpirtin dhe ta avanson ate derisa të arrijë gradën e lhsanit- bamirësisë do të fiton lumturinë e dynjasë dhe të ahiretit. Kjo është lumturia e vërtetë. Dallimi është shumë i madh mes lumturisë së imagjinuar pas së cilës vrapojnë njerëzit dhe vuajnë për të arritur deri te ajo, kurse nuk arrijnë asgjë më shumë se sa shtimin e vuajtjeve dhe fatzsisë.

Lumturia e besimtarëve është lumturi që buron nga zemra dhe ka themele të forta, Pasi që e ndien besimtari këtë nderim Hyjnor, e di mirësinë e kësaj jete dhe mirësinë e përfundimit, kurse kjo ia shton atij ndjenjat e qetësisë, sigurisë, shpresës, kënaqësisë dhe dashurisë.

Kjo lumturi shpirtërore e shoqëron njeriun në të gjitha udhëtimet e tija nga kjo dynja e deri në ahiret, me te ngjitet në shkallët e plotësisë- kemal, edhe pse në fillim ka vështirësi dhe luftë me vetveten, por pastaj arrinë të shijosh ëmbëlsinë e saj dhe të kuptosh vlerën që ka.

Analizo fjalën e Ibën Kajimit, rahimehull-llah:

"Boshti i lumturisë së dynajsë dhe ahiretit është kapja për All-llahun, kapja për litarin e Tij dhe ska shpëtim për askend tjetër përpos për ate që kapet për këto dy shpëtues. Kapja për litarin e Tij e mbron njeriun nga devijimi dhe shkatërimi, sepse ai që ecë drejt Allahut është sikur ai që ecë drejt një qëllimi të tij të caktuar dhe në këtë udhëtim ka nevojë për udhërrëfyes në rrugë dhe siguri, sepse përndryshe nuk mund të arrijë në qëllimin e vet. Domethënë pa sigurimin se a është kjo rruga e saktë dhe pa u siguruar se në këtë rrugë nuk ka asnjë pengesë, por ka siguri, ai nuk mund të jetë i sigurtë se mund të arrijë në qëllimin e vet.

Argumenti, udhërrëfyesi është garanti se nuk do të devijon dhe se do të jetë në rrugën e vërtetë, kurse përgaditja, fuqëia dhe arma e siguron nga hajnat dhe pengesat e rrugës.

Kapja për litarin e All-llahut i jep njeriut udhëzim dhe pasim të argumentit (udhërrëfyesit), kurse kapja për All-llahun i jep atij fuqi, përgaditje dhe armë". ("Medarixhus-Salikin", 1/460).

Dallimi mes këtyre dy gjërave është se: kapja për litarin e All-llahut domethënë zbatimimi i urdhërave dhe respektimi i Tij, kapja për Kur'an dhe Sunnet, kurse kapja për All-llahun domethënë drejtimi dhe strehimi vetëm te All-llahu. All-llahu, xhel-le shanuhu, ka thënë: "...E kush kapet për All-llahun (i përmbahet fesë së All-llahut), ai pa dyshim është i udhëzuar në rrugën e drejtë". (Ali Imran: 101).

#### **Kopshti i zemrës**

Zemra i ngjan një vendi me banorë dhe i sigurtë, ose një kështjelle të siguruar mirë, ose një kopsht i bekuar që kur nuk përfundon begatia e tij, kurë nuk thahet uji i tij, jep fryte në çdo kohë me lejen e Zotit të vet. Kurse kopshti i trupit shpejtë thahet dhe shkatërrohet e bërtet pronari i vet: Vaj për mua! Kurse kopshti i zemrës gjithmonë është i gjelbërt dhe me fryta, kurse pronari i tij bërtet: oh sa gëzim i madh! ("Rixhalul-Fikri ved-Daveti").

#### **Lumturia qëndron në pasimin e Muhammedit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem**

All-llahu, azze ve xhel-le, i ka dërguar peygamberët për udhëzimin e njerëzve, për t'i bërë të lumtur dhe për ti shpëtuar nga erësirat e devijimit, injorancës dhe prishjes, kurse vula e peygamberëve dhe me të cilin përfundoi vargu i peygambervë, ishte Muhammedi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, i cili i udhëzoi njerëzit nga devijimi, i mësoi Pasi që ishin injorantë, ua hapi sytë e ballit dhe të zemrës dhe ndriçoi toka nga drita e shpalljes, u bashkuan zemrat Pasi që ishin të shpërndara,



andaj me të drejtë ky njeri ishte mëshirë për mbarë botërat, sikurse e ka përshkruar All-llahu, tebareke ve teala: "E Ne të dërguam ty (Muhammed) vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat". (El-Enbija: 107).

All-llahu, subhanehu ve teala, ia ka zgjëruar gjoksin, ia ka ngritur emrin dhe ka bërë poshtërsinë dhe nënçmimin atij që e kundërshton urdhërin e tij, kurse lumturinë, shpëtimin dhe udhëzimin atij që kapet për sunnetin e tij.

Transmeton Imam Muslimi nga ljad ibën El-Muxhasheiu, radijall-llahu anhu, se një ditë Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, në hutbe mes tjerash tha: "Më ka urdhëruar Zoti im që t'ju mësoj atë që nuk dini, nga ajo që më ka mësuar mua në këtë ditë... Kam krijuar të gjithë robërit e Mij besimdrejtë- hunefa, u erdhën shejtanët dhe i larguan ata prej fesë së tyre dhe ua ndaluan gjërat që ua kisha lejuar, i kanë urdhëruar të Më bëjnë ortak gjëra për të cilat nuk kanë argument. All-llahu i ka shikuar banorët e tokës dhe është mllëfosur në të gjithë njerëzit, arab ose joarab, përpos një pakice nga ithtarët e Librit dhe ka thënë: të kam dërguar që të të sprovuj dhe që të sprovuj me ty dhe të kam zbritur Libër të cilin nuk e fshin uji, e lexon edhe i zgjuar edhe në gjum". (Muslimi).

All-llahu, xhel-le shanuhu, e ka dërguar që ta sprovon dhe të sprovon me te njerëzit, e sprovon duke ua kumtuar dhe shpallur fenë njerëzve dhe duke i udhëzuar ata në rrugën e drejtë, kurse që ti sprovon njerëzit, domethënë që të sheh kush do ti beson, kush sinqerisht do ta respekton dhe kush do të largohet prej tij dhe kush do ta armiqëson.

Dallimi është shumë i madh mes atij që është i lumtur duke e pasuar udhëzimin e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, dhe ai që është zhytur në devijim dhe ia ka kthyer shpinën mësimëve të Islamit.

All-llahu, azze ve xhel-le, thotë: "Ai (All-llahu) u tha: "Zbritni prej aty që të gjithë, do të jeni armiq të njëri-tjetrit. Nëse u vjen nga Unë udhëzim (libër e pejgamber) kush i përmbahet udhëzimit Tim, ai nuk ka për të humbur (në Dunja) e as nuk ka për të dështuar (në jetën tjetër)". E kush ia kthen shpinën udhëzimit Tim, do të ketë jetë të vështirë dhe në ditën e kijametit do ta ringjall të verbër. Ai (që nuk besoi) do të thotë: "Zoti im, përse më ngrite të verbër, kur unë isha me sy?". Ai (All-llahu) thotë: "Ashtu si i harrove ti argumentet Tona që t'i ofruam, ashtu je ti i harruar sot". Po kështu Ne e shpërblejmë edhe atë që zhytet në mëkate dhe nuk i beson argumentet e Zotit të vet, po dënimi në botën tjetër është edhe më i ashpër dhe i përjetshëm". (Taha: 123- 127).

#### **E mira dhe e keqeja**

Ibën Abasi, radijall-llahu anhu, ka thënë: "E mira jep shndërritje në fytyrë, dritë në zemër, gjërësi në rizk, fuqi në trup dhe dashuri në zemrën e njerëzve.

Kurse keqeja ta zymton fytyrën, erëson zemrën, ta dobëson trupin, ta pakëson rizkun dhe të bën të urrjetur te njerëzit". ("El-Fetava", 10/ 630).

Ibën Rexheb Hanbeliu, rahimehull-llah, ka thënë: "Ai që jeton me All-llahun jeton jetë të këndshme, kurse ai që jeton me nepsin dhe epshin e tij, jeton jetë të gjatë e të vështirë". ("Sherhu Hadithi Lebejke All-llahumme lebejke", fq. 60).

Imam Ibën Rxheb Hanbeliu, rahimehull-llah, thotë: "Disa gnostik, njohës të All-llahut, i kanë thënë disa njerëzve: Çka e konsideroni jetesë ju? Kanë thënë: ngrënie dhe pirje dhe gjërat e ngjajshme me te. Kurse ky ia ktheu: jetesë është që secila gjymtyrë të të tërhej kah respektimi i All-llahut". ("Sherhu Hadithi Lebejke All-llahumme lebejke", fq. 60).

Kur i erdhi vdekja Abdullah ibën Shedadit, e thirri djalin e tij Muhmedin e i tha: "Biri im! Po të jap një porosi, mbaje mend! Ji i devotshëm ndaj All-llahut të Madh dhe le të jetë gjëja më prioritare te ti falënderimi ndaj All-llahut, qëllimi i mirë në gjendjen sekrete tënde dhe në jetën publike dhe dije se falënderuesit i shtohen gjërat, kurse devotshmëria është nozulli më i mirë dhe bëhu biri im sikurse ka thënë Hatiu:

#### **Burimet e lumturisë**

Hulumtimi pas lumturisë është brenga e njeriut në çdo vend, mirëpo shumica e gabojnë rrugën dhe vrapojnë pas lumturisë iluzionare, kurse kjo u sjell vetëm vuajtje dhe fatzisi. Besimtari i vërtet është ai që e di rrugën e lumturisë dhe jetës së këndshme dhe qetësohet duke jetuar në prehërin e saj dhe nuk i dalin brengat dhe ngushticat përpara që ta pengojnë atë lumturi, sepse lumturia e tij i ngjan një burimi të vullshëm nga i cili del uji i sigurt nga shkëmbi, i pastër dhe i ëmbël.

Ali Tantavi, rahimehull-llah, thotë: "Dy njerëz të barabartë në fuqi e bartin të njejtën gjë, njëri ankohet dhe qahet, sikurse të kishte bartur dy pesha, kurse tjetri qeshet dhe këndon sikurse të mos kishte bartur asgjë. Dy njerëz të barabartë në trup sëmundur me të njejtën sëmundje, njëri tregohet pesimist, frikohet dhe e parafytyron vdekjen, kështu bëhet në krahun e sëmundjes dhe e mund vetveten dhe nuk shpëton, kurse tjetri duron, është optimist dhe e parafytyron shërimin dhe për shkurtë kohë shërohet...". ("Suver ve Havatir", fq. 14).

#### **Një tregim**

Një njeri në pleqëri i shtret se në zorët e tija ka gjarpër. Shkon në kontrollë te mjekët dhe konsultohet me njerëz të dijsëm për këtë gjë. Atyreve u qeshet për këtë gjë, por e fshehin nga nderimi që kanë për te, dhe tentojnë ti sqarojnë se në zorë mund të ketë

krimba, mirëpo të ketë aty brenda gjarpër, kjo është e pamundur. Mirëpo ai nuk u besonte. Derisa u takua me një mjek të mençur dhe që e njihte edhe mjekësinë edhe psikologjinë. E dëgjoi tregimin e tij, e pastaj i dha barëra që i shkaktajnë barkëqitje dhe nga barkëqitja e madhe plaku mendoi se i doli edhe gjarpëri nga barku. E ndiu veten të shëndoshë, kurse më herët ankohej për dhimbje dhe çrehatim!

Ali Tantaviu, rahimehull-llah, duke e komentuar këtë tregim thotë: "Plaku nuk u shëruar sepse e nxori gjarpërin nga barku, por u shërua sepse e nzori gjarpërin nga mendja, Pasi që i zgjoi fuqitë e tija që ishin në gjum. Njeriu ka aso fuqi nëse dini ti përdorni do të bënit mrekullira".

Ai në një vend tjetër thotë: "Ju jeni të pasur, mirëpo nuk ia dini vlerën pasurisë që posedoni dhe e hedhni nga moslakmimi i saj ose nga nënçmimi i saj.

Një njeri e kap kokëdhembja, ose i dhemb dhëmbi, ose ka ndonjë vështirësi dhe tërë botën e sheh të zezë dhe të erët, mirëpo pse kur ishte i shëndoshë nuk e shite tërë botën të bardhe dhe ndritshme?!

Pse nuk i njohim begatitë dhe dhuntitë përpos se kur i humbim ato?!

Pse nuk e njohim lumturinë përpos se kur largohet prej nesh, nuk e shohim përpos se të zhytur në erësirat e të kaluarës ose të përzier në mjegullat e tër adhmes?

Kush prej jush është dakord të jep shikimin e tij për një qind mijë dollar?

Pse kërkoni ari, kurse ju posedoni shumë ari?! Shikimi a nuk është prej arit, shëndeti a nuk është prej arit, koha a nuk është prej arit? Pse nuk e shfrytëzojmë kohën tonë? Pse nuk ia dimë vlerën jetës?

Intelekti njerëzor a nuk është thesar? Pse vuajmë nga çmenduria dhe nuk jemi të lumtur me mendje? Shëndeti, koha dhe mendja, tërë këto janë pasuri dhe të gjithë këto janë prej

shkaqeve të lumturisë, për atë që dëshiron të jetë i lumtur.

Koka e gjithë kësaj është besimi, besimi e ngop njeriun e uritur dhe e bën të pasur njeriun e varfër, e ngushëllon njeriun e mërziur, e forcon njeriun e dobët dhe i jep njeriut jetë të këndshme.

Ali Tantaviu duke iu drejtuar lexusve në një vend u thotë: "Ju jeni të lumtur, por nuk e dini, jeni të lumtur aq sa i njihni dhuntitë në të cilat kënaqeni, të lumtur nëse e njihni veten tuaj dhe përfiton nga fuqitë e deponuara në te, të lumtur nëse e kërkoni lumturinë prej vetes tuaj e jo prej tjerëve që janë përreth jush, të lumtur nëse mendimet e juaja vazhdimisht janë me All-llahun, e falënderoni për çdo begati, duroni në çdo fatkeqësi, do të jeni fitimtar në dyja rastet dhe të sukseshëm në dy jetët".

Kur flasim për peshojën e lumturisë duhet ta dimë se mjaftueshmëria, kënaqja, moskeqardhja ndaj asaj që nuk mund të arrihet, qetësia e shpirtit dhe pasuria e saj janë peshoja e lumturisë.

Duhet ta dimë se të jemi dakord me atë që na ka ndarë All-llahu na e sjell lumturinë, kurse ai që vrapon pas të mirave të kësaj dynjaje dhe pasurisë kurrë nuk do të ngopet edhe nëse tërë thesarin e dynjasë e grumbullon dhe do të mbetet në vuajtje.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e sqaron rezikun e dominimit të epshit të dashurisë për pasuri, duke thënë: "Po të kishte biri i Ademit një luginë ari do të dëshironte të ketë edhe një tjetër, kurse asgjë nuk ia mbush syrin birit të Ademit përpos dheut dhe All-llahu ia pranon pendimin atij që pendohet". (Buhariu dhe Muslimi).

"I mallkuar qoftë robi i dinarit, robi i dirhemit, robi i këmishës, nëse i jepet diçka kënaqet e nëse i refuzohet hidhërohet". (Buhariu).

Këto hadithe sqarojnë gjendjen e mjerueshme në të cilën jetojnë ata që janë lidhur

pas dashurisë ndaj kësaj dynjaje, ata që janë bërë skllëvër të lakmisë dhe epshit, saqë kanë ardhur në fatkeqësi të vazhdueshme, frikë që nuk pushon dhe shpirt të trazuar vazhdimisht.

Mos u çrehato

Mos u troshto edhe nëse ndonjë dite ke vështirësi

Sepse gjatë kohë ke patur lehtësi

Mos u demoralizo sepse demoralizimi është mosbesim

Ndoshta All-llahu për shpejt kohë të pasuron

Dije se çdo vështirësi e pason lehtësimi

Fjala e Allahut është më e vërteta se çdo fjali

### Rruga e shpëtimit

Imam Ibën Rexheb Hanbeliu, rahimehull-llahu, ka thënë: "Ai që e sundon vetveten dhe e mposht ate bëhet krenar, sepse ka ngadhnjyer ndaj armikut më të ashpër, e ka mposhtur, e ka robëruar dhe është mbrojtur nga sheri i tij. All-llahu, azze ve xhel-le, thotë: "...Kush është i ruajtur prej lakmisë së vet, të tillët janë të shpëtuar". (El-Hashr: 9).

Është kufizuar shpëtimi në rrugën e njeriut nga lakmia...

Atë që e ka ruajtur All-llahu dhe e ka mbrojtur: e ruan nga lakmia e shpirtit të tij dhe e keqeja e saj dhe e forcon në luftën kundër saj dhe armiqtësimin e saj.

Kurse atë që e le në duart e veta: e sundon, mposht, robëron dhe e shpien në atë vepra ku qëndron edhe shkatërrimi i tij". ("Sherhu Hadithi Lebejke All-llahumme lebejke", f. 130).

### Krahët e lumturisë

Dynjaja është vend i sprovave, kurse robi i sukseshëm është ai që për begatinë falënderon, për fatkeqësinë duron që të jetojë shpirtqetë. Nëse e nderon All-llahu, azze ve xhel-le, me shëndet në trup, siguri në vendbanim, kënaqësi me rizkun që i ndahet, sikurse të posedojë tërë dynjanë dhe le të fluturon me këto tre krahë në qiellin e lumturisë dhe uri-

me këto begati, të cilëve nuk ua dinë vlerën askush përpos atij që është i privuar nga ato.

Transmeton Tirmidhiu dhe Ibën Maxheja nga Ubejdullah ibën Muhsin, radijall-llahu anhu, se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Ai që gdhin i sigurt në vendbanimin e vet, me shëndet në trupin e tij dhe ka kafshatën e asaj dite është sikur të ketë tërë dynjanë". (Hasen).

Ta analizojmë së bashku këtë hadith pejgamberik të mrekullueshëm, i cili i ka përcaktuar shtyllat e lumturisë për besimtarin, sepse besimtari gëzon lumturinë me atë që e ka nderuar All-llahu, siç është besimi, bindja dhe kënaqësia, pastaj i shton shtyllat e lumturisë me begati dhe dhurata që ia ka dhënë All-llahu, mirëpo më të dukshmet janë këto tre komponente:

- 1-Siguria dhe qetësia shpirtërore;
- 2-Shëndeti dhe mbrojtja nga sëmundjet;
- 3-Ushqimi i mjaftueshëm nga hallalli.

"I sigurt në vendbanimin e tij". Domethënë i sigurtë në vetveten, fëmijët, familjen, shtëpinë dhe rrugën e tij. Nëse je i sigurtë edhe në qoftëse jeton në shtëpi të ngushtë qetësia shpirtërore e bën të gjërë dhe të madhe. Kurse stresi dhe frika ia ngushtojnë njeriut shtëpinë dhe jetën edhe nëse jeton në pallate dhe vila luksoze.

Kanati, mjaftueshmëria e mbjellur në shpirtin e besimtarit i mundëson të fluturon në qiejllin e lumturisë dhe të jeton jetë të këndshme me ato begati të All-llahut. kurse ai që vrapon si i çmendur pas të mirave të kësaj bote si grykës për të shtuar kënaqësitat e kësaj dynjaje, kjo nuk ia shton lumturinë e njeriut, sepse është manifestim i rrejshëm në të cilën mbështetet njeriu dhe gëzohet me te për një kohë të shkurtër, mirëpo shpejt mërzhitet dhe kërkon tjerat. I shtohet keqardhja dhe stresi nëse nuk fiton gjëra shtesë, sepse po të kishte një luginë ari, do të dëshironte të dytën?!

Mjaftueshmëria është një thesar që nuk harxhohet, të jep optimizmin dhe të largon nga stresi dhe brenga.

Prej mëshirës së All-llahut është se burimin e lumturisë e ka bërë brenda shpirtit të tyre, afër tij dhe pasurinë e vërtetë e ka bërë pasurinë e shpirtit e jo sasinë e pasurisë materiale.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Nuk është pasuri malli i shumtë që ofrohet, por pasuri është pasuria e shpirti". (Buhariu dhe Muslimi).

"Ka shpëtuar ai që bëhet musliman, rizkun e ka të mjaftueshëm dhe e bën të mjaftueshëm me atë që i ka dhënë". (Muslimi).

"Xhenneti qoftë për atë që udhëzohet në Islam, jetësën e ka modeste dhe ka kanatë, mjaftueshmëri". (Sahih, Tirmidhiu).

#### **Prurëdalja pas ngushticës**

Ti që bartë brengë, dije se brenga do të kalon Myzhde të mirë sepse zgjidhës i brengës është All-llahu

Demoralizimi e këputë ndonjë herë njeriun  
Mos u demoralizo sepse All-llahu të mjafton  
All-llahu pas vështirësisë sjell lehtësimin  
Mos u trishto sepse Krijues është All-llahu  
Nëse ke sprovë beso në All-llahun dhe je dakord me Te

Sepse Ai që i largon sprovat është All-llahu  
Pasha All-llahun ske askend përveç All-llahut

Të mjafton All-llahu sepse për çdo gjë e ke All-llahun.

#### **Peshorja e lumturisë**

Lumturia ka peshoren e vet, kurse ajo është në dorën tënde, mund të peshoshë drejt me te ose të vjedhish.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Shikoni ata që janë nën ju dhe mos shikoni ata që janë mbi ju, sepse kështu nuk do të nënçmoni dhuntitë e All-llahut". (Muslimi).

"Nëse shikon ndokush prej jush ata që kanë më shumë pasuri dhe robër, le të shikon ata që janë nën te". (Buhariu dhe Muslimi).

Ky hadith është ilaç i sëmundjes së hasedit dhe ankesës në caktimet e All-llahut, sepse njeriu që i shikon tjerët dhe dëshiron të arrije të tjerët asnjëherë nuk ngopet, sadoqë që arrinë pasuri dhe autoritet, sepse ai vazhdimisht kërkon shtim të tyre dhe vrapon pas tyre si i çmendur, pastaj i nënçmon begatitë dhe mohon Dhuntidhënësin. Kjo është në përputhje me hadithin e Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem: "Po të kishte biri i Adem-it një luginë ari do të dëshironte të ketë edhe një tjetër, kurse asgjë nuk ia mbush syrin birit të Adem-it përpos dheut dhe All-llahu ia pranon pendimin atij që pendohet". (Buhariu dhe Muslimi).

Nëse muslimani e zbaton këtë porosi profetike do të njeh vlerën e begatisë, do të jetë dakord me atë që ia ka caktuar All-llahu, e fiton kanatin, kënaqjen me atë që ka, fiton lumturinë edhe në qoftëse është i sprovuar me varfëri, sëmundje a fatkeqësi të ndryshme.

Njeriu që është i varfër dhe nuk posedon pasuri nëse i shikon ata që janë edhe më të varfër se ai dhe kanë uri të madhe, thotë el-hamdulillah që nuk e kam gjendjen e rëndë sa të atyreve.

Njeriu që është i sëmurë dhe ka dhimbje nëse i shikon ata që janë shumë rëndë të sëmurë dhe kanë sëmundje afatgjate, thotë el-hamdulillah që nuk jam keq sa ata.

Kështu jeton i kënaqur me atë që i ka caktuar All-llahu, falënderues e durimtar.

Poqëse muslimanët do të praktikonin këtë hadith të Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, do të jetonin të lumtur, do të rregullohej gjendja e tyre, do të njihnin frytet e vërteta të besimit në Caktimin e All-llahut, do të bënin gara në devotshmëri, vepra të mira

dhe afrim të All-llahu, në vend se të garojnë për të mirat e kësaj bote.

Imam Ibën Kajimi, rahimehull-llah, në librin e tij, "Udetus-Sabirin" thotë: "Secili njeri domosdo duhet të durojë në disa gjëra që i urren, ose me vetëdëshirë ose përdhunshëm. Njeriu fisnik duron me vetëdëshirë ngase e di fundin e mirë që ka durimi dhe lavdërohet për këtë vepër e qortohet për trishtimin dhe nëse nuk duron trishtimi nuk ia kthen atë që i ka kaluar. Trishtimi edhe pse nuk i ban dobi fatkeqësinë ia bën dy fatkeqësi. Kurse njeriu i poshtër duron përdhunshëm, sepse rotullohet përreth hapësirës së trishtimit dhe nuk sheh se i sjell ndonjë dobi e duron sikurse që duron njeriu i lidhur për ti dhënë qotek". ("Udetus-Sabirin", fq. 45).

#### **Shtatë porosi në rrugën e lumturisë**

Ebu Dherri, radijall-llahu anhu, ka thënë: "Më ka urdhëruar i Dashuri im, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, me shtatë gjëra:

- 1- Ti dua të varfërit dhe të jem afër tyre;
- 2- Ti shikoj ata që janë ndër mua e jo ata që janë mbi mua;
- 3- Të kujdesem për fafësin edhe nëse ma kthejnë shpinën;
- 4- Mos të kërkoj prej askujt asgjë;
- 5- Ta them të vërtetën edhe nëqoftëse është e hidhur;
- 6- Mos të frikohem për hirë të All-llahut prej prej qortimit të askujt;
- 7- Të them sa ma shumë: 'la haule ve la kuvvete il-la bil-lah' sepse këto fjalë janë thesar nën arshin e All-llahut". (Sahih, transmeton Ahmedi).

#### **Pesë porosi tjera**

Ebu Hurejre, radijall-llahu anhu, tregon se Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Kush merr prej meje këto fjalë dhe vepron me to ose ia mëson atyreve që veprojnë me to: Ebu Hurejre, radijall-llahu anhu, tha: unë o Resulull-llah.

Më kapi për dore dhe mi numëroi pesë gjëra:

1- Ruaju nga haramet që të behsh njeriu më adhurues në mesin e njerëzve;

2- Je i kënaqur me atë që të ka ndarë All-lahu që të jesh njeriu më i pasur;

3- Sjellu mirë me fqinun që të jesh besimtar;

4- Duaju njerëzve atë që ia do vetes që të jesh musliman;

5- Mos u qesh shumë, sepse qeshja e shumtë ta vdes zemrën". (Sahih, transmeton Tirmidhiu dhe Ahmed).

#### **Të dashurit e All-llahut**

Imam Ibën Rexhebi, rahimehull-llah, thotë: "Të dashurit e All-llahut janë ata që trashëgojnë jetën e këndshme, shijojnë begatinë e tyre, për shkak të gradës së lartë në lutje të Dashurit të tyre dhe për shkak të ëmbëlsisë së dashurisë ndaj Tij që kanë gjetur në zemrat e tyre. Dynjaja atyreve u bëhet mirë vetëm duke e përmendur Ate, kurse ahireti vetëm me Faljen e tij, kurse xhenneti me shikimin në Te". (F. 90)

#### **Disa urtësi të mrekullueshme**

- Humbja e durimit është fatëkeqësia më e madhe e kohës.

- Mëkatet e shumta e prishin zemrën.

- Takimi me të dashurit e largon brengën.

- Kopshti i dijes është më i bukur se sa kopshti i bozulokut.

#### **Shpëtimi qëndron në pastrimin e shpirtit**

Imam Ibën Tejmije, rahimehull-llah, ka thënë: "Bamirësia dhe devotshmëria të bëjnë zemërgjërë dhe të qetë, saqë njeriu e ndien vehten të gjërë dhe të lehtë.

Amoraliteti dhe kopracia e shtypin shpirtin, e ulin dhe nënçmojnë. Shpirti koprrac dhe amoral e ka përzier njëzën me tjetrën, andaj në momentin e vdekjes do të nxjeret shpirti me vështirësi sikurse që nxjeret therra nga leshi i lagur.

Shpirti bamirës, i devotshëm dhe i dliirë, të cilin e ka pastruar njeriu, ngritet, zgjërohet, fiton lavdi dhe fisnikëri, kurse në momentin e vdekjes del nga shpirti sikurse pika e ujit që del nga goja e ibrikut ose sikur qimeja nga tlyni". ("El-Fetava", 10/630).

#### **Pesë veçori**

Imam Shafiu, rahimehull-llah, ka thënë: "Mirësia e dynjasë dhe ahiretit qëndron në pesë gjëra:

- Pasuria e shpirti;

- Pengimi i të keqës;

- Fitimi hallall;

- Petku i devotshmërisë;

- Bindja në All-llahun në çdo rast". ("Bustanul-Arifin", fq. 130).

#### **Të parët**

Imam Ibën Xhevziu, rahimehull-llah, ka thënë: "All-llahu ka njerëz që nuk kënaqen pa i mbledhur të gjitha veprat e mira, ata mundohen maksimalisht të fitojnë çdo dije, përpiqen në çdo punë, durojnë në çdo vlerë, e nëse u dobësohet trupi dhe nuk mund ti bëjnë këto vepra, atëherë nijeti e zëvendëson, sepse ata çdo herë mundohen të jenë të parë". ("Sajdul-Hatir", fq. 245).

#### **Zemra përplot dashuri**

Imam Ibën Tejmije, rahimehull-llah, thotë: "Besimi nëse depërton në zemër dhe përzihet me te shkakton ëmbëlsi, kënaqësi, gëzim dhe galdim që nuk mund ta shprehë këtë ai që nuk e ka shijuar..."

Kënaqësia e pason dashurinë, ai që e do një gjë dhe e arrinë atë që do e gjen kënaqësinë me te..."

Krijesat nuk kanë dashuri më të madhe, më të plotë dhe më të saktë se sa dashuria e besimtarëve ndaj Zotit të tyre...dhe çdo gjë që duhet përpos Tij dashuria e tij është si rezultat i dashurisë ndaj All-llahut". ("El-Fetava", 10/648).

**Gjërat e humbura**

Imam Ibën Kajimi, rahimehull-llah, thotë: "Dhjetë gjëra janë të humbura dhe nuk ka dobi prej tyre:

- 1- Dija me të cilën nuk punohet.
- 2- Vepra në të cilën nuk ka sinqeritet dhe pasim.
- 3- Pasuria që nuk jepet prej saj sadaka, nuk kënaqet grumbulluesi i saj në dynja e as që e çon përpara në ahiret.
- 4- Zemër boshe nga dashuria ndaj Allahut, mallëngjimi për Te dhe shoqërimi me Te.
- 5- Trup i cili nuk angazhohet në adhurimin dhe shërbimin e All-llahut.
- 6- Dashuri e cila nuk kufizohet në kënaqjen e të Dashurit dhe zbatimin e urdhërave të Tij.
- 7- Koha e humbur dhe mospërmirësimi i të kaluarës ose shfrytëzimi i të tashmes.
- 8- Mendimi që bredhnë gjëra të padobishme.
- 9- Shërbimi i atij që nuk të afron te shërbimi i të cilit të afron te All-llahu dhe nuk të sjell të mira në dynja.
- 10- Frika dhe shpresa te ai që koka e tij është në Dorë të All-llahut, i cili është rob në Grushtin e All-llahut, vetes nuk mund ti siguron as dëm e as dobi, as vdekje, as jetë e as ringjallje.

Prej këtyre gjërave dy gjëra janë humbja më e madhe dhe janë origjina e çdo humbjeje:

- \* Humbja e zemrës
- \* Humbja e kohës.

Humbja e zemrës vjen nga dhënia përparësi dynjasë para ahiretit, kurse humbja e kohës vjen nga prishja e gjatë.

U grumbullua e tërë prishja në pasimin e epshit dhe shpresa e madhe, kurse e tërë e mira është grumbulluar në pasimin e udhëzimit dhe përgaditjen për Ditën e takimit me All-llahun". (El-Fevaid", fq. 111).

**Fitimi dhe humbja**

Imam Ebu Fet'h El-Busti, rahimehull-llah, thotë: O shërbëtor i trupit sa lodhesh duke e shërbyer ate

- Kërkon fitimin aty ku është humbja  
Kujdesu për shpirtin dhe plotëso vlerat e tij  
Sepse ti me shpirt e jo me trup je njeri  
Lërë përtesën në të mirat që i kërkon  
Sepse nuk gëzohet me të mirat përtaci

**Ilaçi i sukseshëm**

Shejh Abdurahman Es-Sadiu, rahimehull-llah, ka thënë: "Pasi që dynjaja asnjëherë nuk shpëton nga njollat, atëherë ilaçi i sukseshëm është që njeriu të angazhohet me vepra të dobishme, të cilat ia mbushin kohën dhe e largon vazhdimin e mendimit në këto njolla dhe kjo vepër duhet me qenë e afërt me shpirtin dhe të mallëngjohet për te". ("Vesailul-Mufide Lil-Hajatis-Seide", fq. 15).

**Shkaqet e lumturisë**

Pas këtyre sqarimeve që dham mbi lumturinë edhe pse jemi të vetëdijshëm se me këtë nuk i kemi dhënë fundin dhe normalisht se ka edhe shumë për tu thënë, do ti përmendim shkaqet që sjellin lumturinë në jetën e njeriut edhe ate shkurtimisht.

- 1- Besimi i vërtetë dhe veprat e mira;
- 2- Përmendja e madhe e All-llahut dhe leximi i Kur'anit;
- 3- Pendimi i madh te All-llahu dhe kërkimi i faljes prej Tij;
- 4- Lutja dhe kërkimi i të mirave të dynjasë dhe ahiretit;
- 5- Bamirësia ndaj njerëzve me fjalë, vepra dhe të gjitha llojet e bamirësisë, siç është sadakaj, kujdesi për lidhejt farefisnore, largimi i pengesave, përhapja e selamit, pajtimi i njerëzve, etj.
- 6- Ballafaqimi i të keqes me të mirë;
- 7- Kujdesi që të falet namazi me xhemat;
- 8- Ikja nga vetmimi dhe koha boshe;

9- Angazhimi me ndonjë vepër apo ndonjë shkencë të dobishme;  
10- Kujdesu për punën e ditës së sotme dhe mos u merr me punën e të nesërme derisa nuk i vjen koha;  
11- Manifestoi begatitë e All-llahut të brendshme dhe publike duke e falënderuar Ate e jo duke u mburrur dhe me mendjemadhësi;  
12- Vështirësitë krahasoi me begatitë;  
13- Kujtoi fatkeqësitë e tjerëve që të të lehtësohen ty fatkeqësitë e tuaja;  
14- Shiko ata që janë ndër ty në çeshtjet e dynjasë dhe ata që janë mbi ty në çeshtjet e fesë;  
15- Kënaqu dhe je dakord me atë që ke;  
16- Mos lakmo gjërat që kanë njerëzit në duart e tyre;  
17- Shpreso shpërblimin në çdo vepër, e vogël ose e madhe qoftë;  
18- Beso në Caktimin e All-llahut dhe dorëzoju Atij në të gjitha çështjet e tuaja;  
19- Mbështetju vetëm All-llahut dhe zbatoj shkaqet e ligjshme dhe të lejuara fetarisht;  
20- Mendo edhe mundësinë më të keqe, nëse dëshiron që mos të befasohesh me rezultatet të cilat nuk vijnë sikurse i dëshiron;  
21- Kupto se jeta në dynja është e shkurtër, andaj mos e shkurtro edhe më shumë me brenja dhe pikëllime;  
22- Largoju nga ushqimi, fjalët dhe gjumi i tepruar;  
23- Largoju nga hidhërimi dhe shkaqet e tija;  
24- Kërko strehim te Allahu nga djalli i mallkuar, largoju nga rënia nën ndikim të imajinatës, iluzioneve dhe cytjeve;  
25- Kujdesu që secilit tia japish hakun që e meriton;  
26- Detyrën që ke marrë mundohu ta kryesh në formë të përkryer dhe kryj detyrat një pas një;

27- Duhet ta dijë njeriu se fjala e njerëzve nuk i bën dëm përpos nëse ai vepron sipas asaj që thonë njerëzit;  
28- Duhet të kuptoj njeriu se fitimi i kënaqësisë së njerëzve është synim që nuk arrihet;  
29- Haroi vështirësitë e kaluara;  
30- Largoju nga zilia dhe duaja vëllaut tënd atë që ia do vetvetes;  
31- largoju urrejtjes dhe kujdesu që të kesh gjoksin e pastër kundrejt muslimanëve;  
32- Përzihu me të mirët dhe largoju prej të këqinjve;  
33- Kujto se çka u ka përgaditur All-llahu besimtarëve në xhennet;  
34- Prano kritikën konstruktive, këshillën dhe udhëzimet nga secili me zemërgjërësi.  
Këto janë disa shkaqe të cilat njeriut i sjellin lumturinë në jetë. Nuk na premtan koha e as vendi që të bëjmë sqarime detale të këtyre shkaqeve por mendoj se mjaftojnë pas sqarimeve të mëhershme që janë bërë në këtë drejtim.

#### **Pengesat e lumturisë**

Secili njeri e kërkon lumturinë, mirëpo jo secili e arrinë ate, sepse në rrugën e tij drejt lumturisë ka pengesa të cilat nuk arrinë ti tejkalojë. Andaj e shohim të arsyeshme që të përmendim disa prej këtyre pengesave që të kujdesen njerëzit prej tyre dhe të qëndrojnë në distancë.

1- Mosbesimi. Shikoni se si All-llahu, azze ve xhel-le, e përshkruan vuajtjen dhe fatzisinë: "Atë që All-llahu dëshiron ta udhëzojë, ia zgjeron zemrën për (të pranuar) Islamin. Atë që dëshiron ta lërë të humbur, zemrën e tij ia bën shumë të ngusht sikur të ngjitej në qiell. Kështu All-llahu lëshon dënimin mbi ata që nuk besojnë". (El-Enam: 125).

2- Mëkatet, gabimet dhe krimet. Ajetet dhe hadithet që e sqarojnë këtë gjë janë të shumta, andaj nuk do të ndalemi te ato.

3- Zilia dhe xhelozia. Zilia është shumë i rezikshëm, andaj na ka mësuar All-llahu që të



kërkojmë strehim te Ai nga zilia, kurse Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, na e ka ndaluar këtë ves sepse e prish jetën komode dhe të këndshme mes muslimanëve.

4- Mllef dhe urrejtja. All-llahu, azze ve xhel-le, i ka mësuar muslimanët që ti luten Allahut, tebareke ve teala, që mos të lë vend në zemrën e tyre për urrejtje e mllef duke thënë: "...dhe mos lejo në zemrat tona farë urrejtjeje ndaj atyre që besuan. Zoti ynë Ti je i butë, mëshirues!". (El-Hashr: 10).

Njeriu që ka mllef dhe urrejtje tërë kohën mendon se si të hakmiret ndaj atij që e urren, ndoshta e gënjen, e dëmton dhe nuk i frikohet asgjës në drejtim të arrijtes së qëllimit të vet.

5- Hidhërimi. Ska dyshim se hidhërimi është pengesë e lumturisë dhe zemërgjërësisë, andaj All-llahu, azze ve xhel-le, i ka lavdëruar besimtarët duke thënë: "...dhe kur hidhërohen, ata falin". (Esh-Shura: 37).

Kurse Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Nuk është i fuqishëm ai që ngadhnjen në mundje por ai që përmban veten kur hidhërohet". (Buhariu dhe Muslimi).

6- Zullumi. Zullumi ka fundin e keq dhe përfundimin e zyrtë. Shembuj për këtë gjë sa të duash si nga historia e hershme si nga historia moderne.

7- Frika prej tjetërkujt përpos All-llahut. Kjo frikë njeriut i sjell vuajtje dhe nënçmim.

8- Pesimizmi. Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e pëlqente optimizmin dhe e urrente pesimizmin, sepse shkakton vuajtje dhe lodhje.

Dr. Aziz Feridi thotë: Pesimisti për shkak të orientimit të tij pesimist përjeton lodhje të madhe dhe ndikojnë më shumë në nervat e

tija se sa katastrofat dhe fatkeqësitë e mëdha që e kaplojnë.

9- Mendimi i keq për All-llahun, subhanehu ve teala. All-llahu, azze ve xhel-le, thotë: "O ju që keni besuar, largohuni prej dyshimeve të shumta, meqë disa dyshime janë mëkat ...". (El-Huxhurat: 12).

Kurse Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Kujdes nga paragjykimet, sepse ato janë gënjeshtër më e madhe". (Buhariu dhe Muslimi).

10- Mendjemadhësia. Njeriu mendjemadh vazhdimisht jeton në vuajtje dhe fatzisi edhe në qoftëse i nënçmon tjerët dhe ngritet mbi njerëzit.

11- Lidhja e zemrës me krijesat tjera e jo me All-llahun, sikurse ndodh me njeriun e dashuruar me pasion të madh dhe të flakt ndaj ndonjë vajze. Mjafton të lexohen tregime të shumta që flasin dhe tregojnë gjendjen në të cilën kanë ardhur ata që janë dashuruar pa masë në ndonjë vajzë dhe ku i ka sjellur kjo dashuri. Shembulli më specifik në këtë drejtim është rasti i Mexhnunit dhe Lejlës.

12- Droga. Shumë njerëz mendojnë se lumturia sillet me drogë dhe alkool dhe jepen pas tyre duke ikur nga bregat e dynjasë dhe angazhimet e saja, mirëpo ata kanë efektin e kundërt, ato sjellin vuajtje, demoralizim, degjenerim dhe shkatërrim.

Këto janë disa prej pengesave kryesore në rrugën e lumturisë, ti njohim dhe të largohemi prej tyre.

All-llahun e lusim që të na jep jetesë të të lumturve, vdekje të shehidavë dhe të na ringjallë në shoqërinë e pejgamberëve. Amin.

Bekir Halimi

## Argumentimi me hadithe të dobëta

Dijetarët janë pajtuar se nuk lejohet bazimi në hadithet e dobëta për evidentimin dhe pohimin (konfirmimin) e rregullave, gjykimeve dhe vendimeve të shariatit, për gjërat që janë vaxhib, të pëlqyeshme (mustehab), të papëlqyeshme (mekruh), haram, kontrata të vlefshme, të pavlefshme etj. Për të argumentuar gjëra të tilla nuk vlejnë veçse hadithet e vërteta ose të mira. Ibën Tejmije ka thënë: “Për pohimin e çështjeve të shariatit, nuk lejohet të bazohesh në hadithe të dobëta, të cilat nuk janë as të sakta dhe as të mira, por Ahmed ibën Hanbel e të tjerë dijetarë, e lejuan të transmetohen, lidhur me mirësitë dhe epërsitë e punëve të mira, hadithe që nuk dihet se janë të sakta, përderisa nuk është faktuar që janë të rremë. Kjo, sepse kur mësohet që puna është e ligjshme me argument fetar të vlefshëm, dhe në lidhje me mirësinë (shpërblimin) e tij transmetohet një hadith që nuk është faktuar se është i rremë, atëherë shpërblimi i përmendur në të mund të jetë i vërtetë. Asnjëri prej dijetarëve nuk ka thënë që të bëhet diçka e detyrueshme ose e pëlqyeshme, bazuar në një hadith të dobët. Ai që e thotë këtë ka kundërshtuar ixhmain (pajtimin e të gjithë dijetarëve).” Pastaj ka shtuar e ka thënë: “Ahmed ibën Hanbel e të tjerë dijetarë si puna e tij, nuk bazoheshin në hadithe të tilla për t’u dhënë gjykim çështjeve fetare. Ai që ka përcjellë se Ahmed i bazohej në hadith të dobët që nuk është as i saktë dhe as i mirë, ka gabuar.”

Ndërsa përsa i përket përfitimit prej haditheve të dobëta, të cilët përmendin

mirësi e shpërblime që ngjallin interesin për veprimin e punëve të mira, dijetarët nuk janë pajtuar. Por, mendimi më i saktë është që të mos përfitohet asgjë prej haditheve të dobëta, qoftë edhe për mirësitë e shpërblimet, të cilat ngjallin interesin për veprimin e punëve të mira, apo për frikësimin e punuesit të punëve të këqija. Ky është mendimi i shumë dijetarëve si ibën Mu’ini, Buhariu, Muslimi e të tjerë.

Dijetarët që e kanë lejuar përfitimin prej haditheve të dobëta në mirësitë dhe shpërblimin e punëve të mira kanë vendosur tre kushte:

1-Të mos jetë dobësia e hadithit shumë e madhe. Me këtë kusht përjashtohen hadithet që përcillen nga gënjeshtarët, nga ata që akuzohen për gënjeshtëri dhe ata që bëjnë gabime fatale e të rënda në transmetimet e tyre.

2-Puna për të cilën tregon hadithi të përfshihet nën një bazë të përgjithshme. Kështu përjashtohen gjërat për të cilat nuk dëshmon asnjë bazë.

3-Të mos besohet se është i saktë, kur punon apo përfiton prej tij. Pra, duhet të besohet se është hadith i dobët. Kjo në mënyrë që të mos i mvishet Pejgamberit, alejhis-selam, ajo që ai nuk e ka thënë.

Në lidhje me këtë mendim të këtyre dijetarëve dhe kushtet që kanë vendosur duhet të bëjmë tre sqarime:

a) Kushti i parë tregon se çdonjëri e ka detyrë ta njohë gradën e hadithit me të cilin do të punojë, në mënyrë që t’i shmanget bazimit në të, në rastin kur është shumë i dobët. Njohja e gradës së çdo

hadithi dhe njohja e çdo hadithi të dobët me të cilin duan të punojnë, është e vështirë për shumicën dërrmuese të njerëzve, sepse dijetarët e hadithit, të cilët nuk u flasin njerëzve veçse me hadithe të sakta dhe i paralajmërojnë njerëzit nga hadithet e dobëta, janë të paktë, sidomos në këtë kohë. Prandaj ata që janë të dhënë pas punimit me hadithe të dobëta, e kundërshtojnë këtë kusht haptazi. Pothuajse sa herë që ndonjëri prej tyre, qoftë edhe dijetar në fusha të tjera veç hadithit, mëson një hadith të dobët, shpejton të punojë me të pa e ditur, dhe kur i tërheq vëmendjen ndonjëri rreth dobësisë së hadithit, menjëherë përmend si mbështetje rregullin e tij të pretenduar “punohet me një hadith të dobët në mirësitë dhe shpërblimin e punëve të mira”. Por nëse do t’i përmendet ky kusht hesht dhe nuk thotë asgjë. Për këtë po përmendim vetëm një shembull, i cili dëshmon për metodën e tyre në mosrespektimin e këtij kushti. Ebul Hasenat el Eknevi përcjell në librin e tij “El exhvibe” nga dijetari i nderuar ElKari se ai ka thënë për hadithin “Dita më e mirë është dita e arafatit, nëse përkon me ditën e xhuma. Ajo është më e mirë se 70 haxhe”: “Këtë hadith e transmeton Rruzejni. Ajo që e kanë përmendur disa dijetarë të hadithit lidhur me senedin e tij, pra që është i dobët, edhe sikur të merrej si e saktë, nuk e dëmton synimin e hadithit, sepse hadithi i dobët është i konsiderueshëm në mirësitë dhe shpërblimet e punëve të mira”. El Eknevi pasi e ka përmendur thënien e tij, e ka konfirmuar.

Lidhur me konkluzionin që kanë nxjerrë këta dy dijetarë shejh Albani thotë: “Lexues i nderuar! Vëre se si nuk e kanë respektuar këta dy dijetarë të nderuar rregullin e lartpërmendur. Medoemos që ata

nuk e kanë lexuar senedin e këtij hadithi dhe nuk kanë mësuar gjë për të, se ndryshe do ta sqaronin gradën e tij, dhe nuk do t’i kundërpërgjigjeshin pretendimit se është i dobët duke polemizuar me fjalët e tyre: ‘edhe sikur të merrrej si e saktë thënia që hadithi është i dobët!’ E si mund të jetë i saktë përfundimi i tyre, ndërkohë që dijetari i madh e i njohur për thëniet e tij të vërteta ibën Kajjim el Xhevzije në “Zadul mead”, për këtë hadith ka thënë: ‘I pavlefshëm e i pavërtetë. Nuk është përcjellë me sened as nga i Dërguari i Allahut, as nga sahabet dhe as nga tabiinët.’”

Pas kësaj shejh Albani ka dalë në përfundimin se respektimi i këtij kushti në praktikë, do të çojë në lënien e haditheve që nuk evidentohen si të sakta apo të mira, për arsye se njohja e dobësisë së theksuar të një hadithi është e vështirë për shumicën e njerëzve. Pra, rezultati i respektimit të këtij kushti, bën që ky mendim të përputhet (praktikisht) me mendimin që kemi zgjedhur (d.m.th. mospranimin në mënyrë absolute të hadithit të dobët.)

b) Kushti i dytë tregon se faktikisht, praktikimi i punës së mirë nuk është bazuar në hadith të dobët, por në bazën e përgjithshme (d.m.th. në ajet kuranor dhe hadith të vërtetë e të mirë), kështu që praktikimi i kësaj pune është i argumentuar, ekziston hadithi i dobët apo nuk ekziston. Ndërsa puna që është transmetuar vetëm në hadith të dobët, nuk mund të jetë e argumentuar dhe nuk lejohet të praktikohet nëse nuk është e mbështetur në bazë të përgjithshme. Me këtë kusht, punimi me hadith të dobët mbetet një gjë formale dhe jo reale. Këtu duhet bërë e qartë se si në kushtin e parë, po ashtu edhe këtë kusht, nuk e kanë respektuar sepse kanë vlerësuar shumë punë si të

pëlqyeshme e të mira, megjithëse janë transmetuar vetëm në hadithe të dobëta dhe nuk ka bazë që dëshmon për to. Madje ndonjëherë mendimi i tyre me pretekstin e bazimit në këtë rregull bie ndesh me të dy kushtet e sapopërmendura, ngaqë hadithi që mbështeten është shumë i dobët ose i trilluar dhe nuk ka argument të saktë që dëshmon për punën që përmban, si p.sh. hadithi që nxit për 'namazin regaib'.

c) Kushti i tretë pajtohet me kushtin e parë për domosdoshmërinë e njohjes së dobësisë së hadithit, në mënyrë që të mos besohet se është i saktë. Nga ajo që sqaruar mëson se shumica dërrmuese e atyre që punojnë në mirësitë e punëve të mira me hadithe dobëta, nuk e dinë që janë të dobëta.

Si përfundim i këshillojmë të gjithë vëllezërit muslimanë të mos punojnë me hadithe të dobëta absolutisht dhe t'i përkushtohen praktikimit të asaj që ka ardhur në hadithe të sakta nga i Dërguari i Allahut, sepse në to ka punë që janë të mjaftueshme dhe e bëjnë të panevojshme të merren me hadithe të dobëta. Nëse do të bazohemi vetëm në hadithe të sakta e të mira kjo do të na mbrojë nga gënjeshtria ndaj të Dërguarit të Allahut, sepse nga përvoja ne kemi mësuar se atë që na kundërshtojnë në këtë çështje kanë rënë në gënjeshtëri (qoftë edhe padashje), ngaqë punojnë me çfardolloj hadithi. I Dërguari i Allahut ka folur për këtë në thënien e tij: "I mjafton njeriut prej gënjeshtres që të flasë çdo gjë që e dëgjon". Trasmeton Muslimi në parathënien e sahihut të tij.

Ismail Bardhoshi

Marrë nga libri: "Besimi i Ehli Sunnetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut"

## Hadithi ishte argument edhe për ata

Ebu Jusufi, rahimehull-llah, i cili është prej shoqëruesve më fisnik të Ebu Hanifes dhe i pari që është emërtuar Kadi Kudat, kur është takuar me Imam Malikun dhe e ka pyetur për disa çështje, Imam Maliku i është përgjigjur me transmetime mutevatir nga Medinasit, andaj Ebu Jusufi, i morri mendimet e tija e tha: po ti shihte mësuesi im këto që i kam parë unë, do të kthehej ashtu si jam kthyer unë. Ebu Jusufi ka treguar se këto transmetime janë argument te mësuesi i tij, Ebu Hanifeja, ashtu siç janë edhe te të tjerët, mirëpo Ebu Hanifes nuk i kanë arritur këto transmetime, ashtu sikurse nuk i kanë arritur atij dhe shumë imameve tjerë shumë hadithe. Andaj ata nuk

qortohen për lërjen e veprimit me to, pasi që nuk u ka arritur dija e tyre te ata. Kthimi i Ebu Jusufit në këto transmetime ishte sikurse edhe kthimi i tij në shumë hadithe të cilat i ka pasuar ai dhe shoku i tij Muhamedi, duke e lënë mendimin e hoxhës së tyre, pasi që e kanë ditur se hoxha i tyre thoshte: "edhe këto hadithe janë argument, nëse janë të vërteta, mirëpo nuk i kanë arritur".

Ai që mendon për Ebu Hanifen, ose për ndonjërin imam të muslimanëve se me qëllim kanë kundërshtuar hadithin e vërtetë për shkak të analogjisë ose për diç tjetër, ka gabuar ndaj tyre dhe ka folur ose me paragjykim ose me epush.

Shejhul Islam Ibën Tejmije

Shih: "Mexhmuul-Fetava", 20/ 304. Përktheu: B.H.

## Supozimi i keq

Një nga veset më të përhapura në mesin e njerëzve është edhe supozimi i ligë apo i keq. Supozim gjuhësisht d.m.th. "E marr me mend diçka si të mundshme a të vërtetë, pa mundur të jap një gjykim të prerë për të; besoj; dyshoj se."

Në dëshirojmë të flasim vetëm për supozimin e ligë, të cilin rrallëherë mundohet ta shtjellon dikush tjetër pos myslimanëve. Kështu që, pikërisht ata kanë dhënë një definicion të mirëfilltë për këtë. Supozimin e keq, ata e kanë definuar kështu: "Besimi në anën negative dhe dhënia përparësi kësaj ane, edhe pse që të dyja janë të mundshme".

### Supozimi i keq është prej mëkateve të mëdha të brendshme

Imam Ibën Haxheri supozimin e ligë ndaj myslimanit e ka numëruar nga mëkatet e mëdha të brendshme dhe ka thënë: "Këto mëkate të mëdha është obligim që besimtari t'i njohë, për të mësuar shërimin nga ato, sepse ai që në zemër të tij, ka këso lloj sëmundje, nuk do të mundet ta takojë Allahun - Allahu na ruajt - me zemër të shëndoshë. Për llojin e këtyre mëkateve njeriu duhet të qortohet më shumë sesa qortohet për zinanë, vjedhjen, pirjen e alkoolit si dhe për mëkatet tjera trupore. E gjithë kjo për shkak të dëmit të madh që shkaktojnë këto lloj mëkate, sepse këto mëkate vazhdojnë të jenë prezent derisa të bëhet ves dhe sjellje e pandarë nga njeriu, dhe do të jetë e rrënjësor thellë në zemrën e tij. Gjë e cila, nuk ndodh edhe me mëkatet trupore, sepse ato shumë shpejt zhduken, ato zhduken menjëherë pas kërkimit

të faljes, pendimit dhe veprave të mira".

Pastaj solli fjalën e Ibën Nexhharit: "Kush ka supozime të këqija ndaj vëllait tij, ai njëherazi ka supozim të keq edhe për Zotin e tij", Allahu, subhanehu ue teala, ka thënë: "O ju që keni besuar, largohuni shumë nga supozimet". (Huxhurat 12).

Supozimi i keq mund të jetë në dy mënyra:

1. Supozim i keq për Allahun. Ajo ndodhë duke menduar se Allahu nuk i dëshiron të mirat për ty ashtu si i dëshiron ti për vete, se Allahu të tjerëve u ndihmon më shumë se besimtarëve, se Allahu nuk do të gëzojë me familje të mirë, se Allahu çdoherë të përcjellë ty me fatkeqësi, se Allahu i ka bërë padrejtësi ndonjëres gjini, se Allahu nuk dëshiron të të shpërblejë me xhenet etj. Ky mëkat është edhe më i madh se dëshpërimi dhe këputja e shpresave në Allahun. Sepse ky mëkat në vete ngërthen dëshpërimin, këputjen e shpresave dhe diçka më tepër, si dhe akuzohet Allahu me gjëra të cilat aspak nuk përshtaten me fisnikërinë dhe bujarinë e Tij.

2. Supozim i keq për myslimanët. Ajo ndodhë duke menduar se dikush ka hyrë në fe vetëm për dyfytyrësi, se dikush shoqërohet me ty për ndonjë interes, se dikush bën organizime kundër teje, se dikush me ndonjë fjalë ka pas qëllim diçka shumë të keqe, se ti mundesh me i kryer punët më mirë se të gjithë tjerët, se bashkëshorti/ bashkëshortja të tradhton kur ti mungon etj. Edhe kjo është nga mëkatet e mëdha, sepse ai që e gjykon tjetrin për të keq duke u mbështetur në supozim të thjeshtë, ai pastaj do të fillojë ta nënçmojë atë person, të mos i kryejë obligimet

ndaj tij që ka, të mos e nderojë si dhe të flasë më të keqen për të. Të gjitha këto janë shkatërruese.

Secilin që e dëgjon se ka supozime të këqija për tjetrin dhe kërkon zbulimin e të metave të tij, dije se ai vet është i fëlliqur në brendësi dhe i prishur në qëllimet e tij.

Besimtari kërkon arsyet për tjetrin sepse brendësinë e ka të pastër dhe të shëndoshë, ndërsa munafiku i kërkon të metat e të tjerëve, për shkak të brendësisë së fëlliqur.

Supozimi në Kur'an, më së shumti ka ardhur me dy kuptime:

a. Akuzim:

"Për besimin e tij në botën e fshehtë, as që mund të akuzohet". (Tekvir 24).

b. Gënjeshtëri:

"Ata nuk pasojnë gjë përveç supozimeve, por supozimet aspak nuk janë të vërteta". (Nexhëm 28).

Llojet e supozimeve për nga dispozita:

Sufjan Theuriu ka thënë: "Supozimi është dy lloj: që është mëkat dhe që nuk është mëkat. Mëkat është kur supozon dhe e shpreh atë, ndërsa nuk bie në mëkat kur supozon dhe nuk e shpreh atë".

Ibën Kudame el-Makdisi thotë: "Nuk e ke të lejuar të mendosh keq për myslimanin, përveç nëse shfaqet diçka nga ai dhe që nuk mund të komentohet ndryshe. Nëse për një të keqe të lajmëron dikush të cilit i beson, atëherë je i arsyetuar, ngase sikur ta përgënjeshtroje këtë, do të kesh supozim të keq për lajmëtarin, ndërsa nuk e ke të lejuar për dikë të kesh supozim të mirë e për dikë supozim të keq. Ajo që duhet të bësh, është të hulumtosh se midis tyre a ka armiqtësi, ajo do të ndihmojë të gjykosh drejtë. Kurdo që të paraqitet supozim i keq për ndonjë mysliman, duhet edhe më shumë ta respektosh dhe të lutesh mirë për të,

sepse kjo e përvëlon shejtanin dhe e largon nga ti. Do të ketë frikë shejtani të të nxisë në supozime, nga frika e lutjeve dhe uratave që do t'i bësh ti. Nëse je bindur se dikush ka bërë keq, këshilloje në vetmi. Dije se nga rezultatet e supozimit të ligë është spiunimi, sepse njeriu edhe pse supozon, sërish nuk është i qetë derisa të fillojë ta përcjellë dhe spiunon atë person. E kjo është e ndaluar, sepse dërgon deri në zbulimin e sekreteve të myslimanit. Sikur të mos hiqej ajo perde, zemra jote do të ishte më e shëndoshë ndaj besimtarëve".

Ibën Kajjimi, rahimehullahu, ka thënë: "Shumica e njerëzve kanë supozime të këqija për Allahun duke krahasuar se çka i ndodhë atij dhe çka u ndodhë të tjerëve. Pak janë ata që shpëtojnë nga kjo, përveç atyre që e njohin Allahun me emrat dhe cilësitë e Tij. Andaj, ai që ka mend le të kujdeset për këto gjëra më tepër, le të pendohet tek Allahu, subhanehu ue teala, dhe le të kërkon falje për supozimet e këqija që i ka pasur ndaj Allahut. Cilindo ta ngacmoje, do të shohësh se ka pakënaqësi dhe qortim ndaj kaderit, secili thotë: "Mirë do të ishte të jetë kështu e ashtu", dallimi është se kush e thotë këtë më pak e kush më shumë. Ngacmoje veten dhe shiko a ke shpëtuar? Nëse ke shpëtuar, atëherë dije se ke shpëtuar nga diçka shumë e madhe, por unë nuk mendoj se ke shpëtuar".

Shkurtimisht, dispozita e supozimit është:

1. Nëse njeriu ka supozime të këqija për Allahun, kjo është e ndaluar dhe mëkat i madh. Obligim është pendimi dhe mendimi i mirë për Allahun.

2. Nëse njeriu ka supozime të këqija për ndonjë besimtar, për të cilin nuk ka ndonjë argument të qartë, kjo është e ndaluar dhe mëkat i madh. Obligim e ka të pendohet dhe ta përmirëson mendimin për të.

3. Nëse njeriu ka supozime të këqija për ndonjë besimtar, por duke u mbështetur në argument të arsyeshëm, atëherë supozimi i tij është i lejuar.

Disa ajete rreth supozimeve të këqija:

1. Allahu, subhanehu ue teala, thotë:

"Edhe te populli Ad, dërguam vëllain e tyre Hudin, e ai tha: "O populli im, adhurojeni Allahun, ju nuk keni të adhuroar pos Tij, a nuk po frikësoheni?!" Paria që nuk besoi nga populli i tij tha: "Ne kemi mendimin se ti je mendjelahtë dhe kemi supozime se ti je rrenacak!" (A'raf 65-66).

Këtu shihet qartë se supozimi i keq që kishin për Hudin, alejhi selam, i pengoi që të pranojnë të vërtetën, me të cilën do të kishin shpëtuar.

2. Allahu, subhanehu ue teala, thotë: "Dhe ai hyri në kopshtin e vet, por duke qenë i padrejtë me vetveten, tha: "Unë supozoj se kjo nuk mund të zhduket asnjëherë!" Po ashtu supozoj se kiameti nuk do të ndodhë...". (Kehf 35-37).

Supozimi këtë person e shtyri të mashtrohet aq thellë me të mirat e kësaj dynjaje, saqë arriti të mohojë kiametin. Mu për këtë, Allahu e quajti se është i padrejtë me vetveten.

3. Allahu, subhanehu ue teala, thotë: "Ata edhe thanë: "Nuk ka tjetër, përveç jetës në këtë botë, ku vdesim dhe po jetojmë. Neve nuk na shkatërron asgjë përpos kalimit të kohës. Ata për këtë nuk dinë asgjë, ata vetëm supozojnë". (Xhathije 24).

Ky ajet i qorton filozofët, të cilët i jepnin vetvetes aq liri, saqë edhe për gjërat që nuk kishin kurrfarë dije, jepnin supozimet e tyre të kota.

4. Allahu, subhanehu ue teala, thotë: "Shumica e njerëzve merren me supozime, por në supozime nuk ka asgjë të vërtetë. Vërtetë Allahu është i Ditur për atë çka

punojnë". (Junus 36).

Ky ajet na tërheq vërejtjen nga supozimet e këqija, sepse në to nuk ka asgjë të vërtetë, ashtu që nuk kemi pse të lodhemi me ato.

5. Allahu, subhanehu ue teala, thotë: "O ju që keni besuar, përkujtojeni të mirën e Allahut ndaj jush, kur juve u erdhi një ushtri e Ne kundër tyre lëshuam një furtunë dhe ushtri që ju nuk e shihnit, e Allahu e shihte atë që ju vepronit. Kur ata (armiqtë) u erdhën juve prej lartë edhe prej poshtë, kur shikimet e juaja u shtangën, dhe zemrat arritën në fyt, dhe ju kishit supozime të llojllojshme për Allahun". (Ahzab 9-10).

Ky ajet na mëson se, sado që sprovat të jenë të mëdha, sado që problemet të na kaplojnë dhe sado që armiqtë të na rrethojnë, ne nuk guxojmë të kemi supozime të këqija për Allahun, përkundrazi duhet të bindemi se Ai çdoherë u ndihmon robërve të Tij të mirë.

Disa hadithe rreth supozimeve të këqija:

1. Ajsheja, radijallahu anha, ka thënë: "A t'ju tregoj për mua dhe për Resulullahun, salallahu alejhi ue selem? Thamë: Po. Tha: Një natë, në të cilën Resulullahu, salallahu alejhi ue selem, duhej të jetë tek unë, erdhi, pastaj hoqi ridanë dhe nallet e tij dhe i vendosi te këmbët. Njërin skaj të izarit të tij e shtroi mbi shtrat dhe u shtri. Qëndroi shtrirë derisa mendoi se kam fjetur, pastaj e mori ridanë ngadalë, i veshi nallet ngadalë, hapi derën dhe doli, dhe e mbylli derën ngadalë. Pastaj, unë u veshva dhe shkova pas tij. Ai arriti në Bekië dhe aty u ndal, qëndroi në këmbë kohë të gjatë, pastaj ngriti duart tri herë. Pastaj u kthye, edhe unë u ktheva, shpejtonte ai, shpejtoja edhe unë, nxitonte ai, nxitoja edhe unë, vrapoi ai, vrapova edhe unë, saqë ia kalova dhe hyra brenda. Menjëherë sa u shtriva, ai hyri dhe

tha: 'ke? Oj Aish, ç'je tërbuar? Thash: Asgjë. Tha: "Ose do të më thuash ti, ose do të më tregojë I Informuari për çdo hollësi". Thash: O i dërguar i Allahut - sakrifkofsha babën dhe nënën për ty - dhe i tregova. Tha: "Ti paske qenë personi që e pash para meje?" thash: Po. Atëherë më goditi në gjoks, saqë më shkaktoi dhimbje, e pastaj më tha: "A kishe supozime se Allahu dhe i dërguari i tij do të bëjë padrejtë ndaj teje? Thash: Nëse unë fsheh diç Allahu e di. Po (ashtu mendova). Tha: Në momentin kur më pe, më erdhi Xhibrili dhe më thirri. Unë iu përgjigja, por të fshehja ty nga ai, sepse ai nuk do të hynte brenda ndërsa ti je e zhveshur. Mendova se kishe fjetur dhe nuk kisha dëshirë të të zgjoj se ndoshta ishe frikësuar. Xhibrili më tha: Zoti yt, të urdhëron që të shkosh tek varrezat Bekië dhe të kërkosh falje për ata. Thash: Si të them kur të shkoj aty, o i dërguar i Allahut? Tha: thuaj: "Shpëtimi qoftë mbi banorët e këtyre shtëpive, që janë besimtar dhe myslimanë. Allahu i mëshiroftë të hershmit dhe të vonshmit tanë. Me dëshirën e Allahut, edhe ne jemi duke ardhur pas jush". (Muslimi 974).

E gjithë kjo situatë e pakëndshme që i ndodhi Ajshes, radijallahu anha, ishte për shkak të supozimeve të liga që iu paraqitën për Resulullahun, salallahu alejhi ue selem, sepse ajo mendoi se Resulullahu, salallahu alejhi ue selem, do të shkonte të ndonjë bashkëshorte tjetër...

2. Tregon Ebu Hurejre radijallahu anhu, se Resulullahu, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: "Keni kujdes nga supozimet, ngase supozimet janë gënjeshtër më e madhe. Mos hulumtoni gabimet e njëri-tjetrit, mos spiunoni njëri-tjetrin, mos xhelozoni njëri-tjetrin, mos ia ktheni shpinën njëri-

tjetrit dhe mos e urreni njëri-tjetrin, por bëhuni që të gjithë robër të Allahut, vëllezër midis vete". (Buhari (6066) dhe Muslim (2563))

Në këtë hadith Resulullahu, salallahu alejhi ue selem, pasi që na tregon se supozimet e këqija janë vetëm gënjeshtër, ai po ashtu na tregon se ky mëkat është i njëjtë edhe me mëkatet tjera, që u përmendën në hadith.

3. Ebu Umame tregon se Resulullahu, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: "Nëse udhëheqësi hulumton gjërat e dyshimta tek njerëzit, do t'i prishë". (Ebu Davudi (4889), Albani thotë se hadithi është sahih.)

Kur të fillosh ti si udhëheqës, si drejtor apo si babë, të hulumtosh gjërat e liga të njerëzve më të cilët bashkëpunon, apo me të cilët jeton, të supozosh gjëra të këqija për ata, padyshim se edhe ata, do të fillojnë të organizohen kundër teje, në çfarëdo mënyre qoftë. E kjo do të shkaktojë që të prishet respekti i ndërsjellë dhe morali në përgjithësi.

4. Ebu Hurejre radijallahu anhu, tregon: Një njeri nga Beni Fezarët erdhi te Resulullahu, salallahu alejhi ue selem, dhe tha: Gruaja më ka lindur djalë të zi. Resulullahu, salallahu alejhi ue selem, tha: A ke deve ti? Tha: Po. Tha: Çfarë ngjyre kanë? Tha: Të kuqe. Tha: Në mesin e tyre a ka ndonjë të përzier me ngjyrë të zezë? Tha: Po, ka. Tha: A thua vallë, si ka ndodhur ajo? Tha: Ka mundësi ta kapur ndonjë gjen. Tha: Me siguri edhe këtë e ka kapur ndonjë gjen. (Buhari (5305) dhe Muslim (1500))

Mund të ndodhin shumë gjëra, të cilat mund të të fusin në supozime mjaft të rrezikshme, por sërish mos shpejto, sepse ka mundësi të ketë shkaqe dhe arsye të pranuar, sikurse ky rast konkret.

5. Ka'b ibën Maliku na tregon: Nuk kam



munguar në asnjë betejë që bënte Resullahu, salallahu alejhi ue selem, përveç në betejën e Tebukut... Resullahu, salallahu alejhi ue selem, nuk kishte pyetur për mua përveç kur kishte arritur në Tebuk. Duke qenë ulur në mesin e shokëve kishte thënë: "Ç'u bë me Ka'b ibën Malikun? Njëri nga familja Seleme tha: O i dërguar i Allahut, atë e penguan të mirat e kësaj bote. Muadh ibën Xhebeli ishte ngritur dhe ka thënë: Sa keq që fole. Pasha Allahun, o i dërguar i Allahut, për atë dimë vetëm të mira. E Resullahu, salallahu alejhi ue selem, kishte heshtur.

Të jesh shok i mirë dhe besnik nuk është lehtë. Shiko në çfarë mënyre Muadhi filloi ta mbrojë Ka'bin, edhe pse nuk dinte arsyen e mos daljes së tij në betejë. Për fjalët e tij, Muadhi u mbështet në njohjen para-prake që kishte për Ka'bin, e nuk i lejoi supozimeve që të manipulojnë me të, siç ndodhi me personin tjetër.

Në historinë e myslimanëve të mirë, mund të hasësh raste të panumërta se si ata janë kujdesur nga supozimet e këqija. Këtë e kanë bërë, për shkak të bindjes së

madhe që kishin ndaj fjalëve të Allahut dhe të Resullullahut, salallahu alejhi ue selem. Po ashtu, e kanë ditur se supozimet e këqija sjellin vetëm dëme. Prej atyre dëmeve mund të veçojmë:

1. Shkakton hidhërimin e Allahut, subhanu ue teala.
2. Është argument se ai person është qëllimkeq dhe ka shpirt të prishur.
3. Është ves, nga veset e munafikëve.
4. Ngjallë koprracinë dhe urrejtjen në mesin e njerëzve.
5. Është çelës i punëve të këqija dhe përfundimeve fatkeqe.
6. Shkakton poshtërsinë para Allahut fillimisht, e pastaj edhe para njerëzve.
7. Është argument për imanin e dobët.
8. Është argument se ai person nuk ka vetëbesim.

O Zot, na pastro nga veset dhe traditat e këqija e na zbukuro me moral të mirë dhe besim të shëndoshë. O Zot na ringjallë në shoqëri me pejgamberët, me të sinqertit, me shehidat dhe me njerëzit e mirë, sepse ajo është shoqëria më e mirë.

Omer Berisha

**Udha nuk mbaron me pranimin e islamit, aty fillon...**

Jam pagëzuar si katolike. Kam qenë edhe në ceremoninë e parë të pranimit të shenjtë, megjithëse familja ime nuk shkonte në kishë. Sidoqoftë, jam edukuar në frymën e krishterë, me besimin në egzistencën e Zotit dhe në kërkim të së vërtetës. Në besimin katolik më pengonin shumë gjëra, si për shembull ideja e mëkatit të trashëguar. Qysh dhjetë vjeç ndiqja një kishë të sekti të krishterë tek e cila gjeja një pjesë të përgjigjeve për pyetjet e mia duke përfshirë dhe mëkatet e trashëguar, për të cilin në versionin origjinal të Biblës nuk thuhet asnjë fjalë, që do të thotë se fëmijët lindin gjithnjë të pastër nga mëkatet dhe se nuk egziston kurrfarë ndërmjetësi mes nesh dhe Zotit (p.sh. prifti të cilit i rrëfehen napr. katolikët për mëkatet e tyre). Në kishën e sipërpërmendur mësova shumë mbi respektin ndaj njerëzve, mbi lutjet ndaj Zotit dhe dorëzimi ndaj vullnetit të Tij për gjithçka, mbi përpjekjet për bërë mirë jo vetëm për veten por edhe për të tjerët, mbi ndihmën që duhet t'u jepet të tjerëve, mbi shpirtin e pastër e të singertë, si dhe plot gjëra të tjera pozitive.

Gjithçka filloi të ndryshojë gradualisht gjatë qëndrimit tim në Zvicërr tek një familje myslimane. Në Zvicërr shkova me synimin për të përmirësuar dijet e mia në gjuhën gjermane ndërsa atë vit më priste matura. Tek ajo familje vura re marrëdhëniet ndërmjet tyre, respektin e fëmijëve ndaj prindërve, etj. Kjo ishte shkëndia e parë që ndezi pasionin tim për islamin.

Kur u ktheva pas dy muajsh në Sllovakë, morra hua një përkthim të Kuranit në anglisht tek kisha ku shkoja atëherë. Rrallë herë lexoja ndonjë gjë por në të shumtën e rasteve

shumë gjëra s'l merrja vesh. Meqë mbas mësimet, ndiqja kursin e anglishtes, rastësisht u njoha me studentë nga Libia (natyrisht që ishin myslimanë). Gjatë kursit u hap biseda mbi temën "Islami dhe myslimanët" dhe më pas kjo temë u bë e përditshme. Unë merrja në këtë mënyrë informata mbi islamin kurse ata përmirësonin anglishten e tyre. Vetëm myslimanët filluan të më jepnin përgjigje llogjike për pyetjet e mia. Dhe erdhi dita kur në zemër ndjeva një ndjesi të veçantë e cila më shtynte përpara dhe më thoshte se kishte ardhur momenti i duhur për të pranuar besimin islam dhe të bëhesha një prej atyre njerëzve të mrekullueshëm të cilët me rrethonin. Doja të bërtisja me të madhe para gjithë botës ç'ndieja në atë çast (ndjenjë e cila s'më ka pushuar deri më sot).

E dija se duhet të mesoja shumë gjëra të reja por mua çdo gjë e re më entuziasmonte dhe interesonte pa masë. I falenderohem Zotit për gjithçka, për faktin që më ka udhëzuar gjatë gjithë jetës sime dhe që më dha mundësinë për t'u njohur dhe besime të tjera para se të pranoja islamin. Islami është kulmi i rrugës sime në kërkim të së vërtetës.

Dita ime (me "D" të madhe) erdhi në dhjetor të 1999-s. Me agjërimin, faljet dhe veshjen e përshtatshme nuk pata problem. Probleme nuk pata as me vendimin për të mbajtur apo jo shaminë myslimane (hixhabin). Thjeshtë e vura një herë për provë dhe qysh atëherë falë Zotit e mbaj gjithmonë. Sigurisht që i druhesha reagimit të njerëzve rreth meje, prindërve apo kolegëve në punë. Isha pothuajse e sigurtë se prindërit do të më nxirrin nga shtëpia dhe drejtori do më përjashtonte

nga puna. Megjithatë isha e vendosur që të bëhej, ç'të bëhej, le të bëhej vullneti i Zotit, Ai do të kujdesej për mua spese vetëm Ai e di ç'është më e mira për mua dhe se duhet t'i falenderohem Atij për gjithçka. Falë Zotit, familja dhe kolegët në punë më pranuan pa probleme. Është shumë e rëndësishme t'i besosh Zotit 100%, sepse Ai e di ç'është brenda nesh, çfarë mendojmë, si dhe sa sinqerisht i lutemi Atij dhe se tek Ai gjejmë mbështetje. Ai na ndihmon gjithmonë sepse e di ç'është për ne më e mira. Me pranimin e fesë islame, udha jonë nuk mbaron por veçse fillon. Duhet të përpiqemi të mbledhim sa më shumë informata dhe të jemi myslimanë sa më të devotshëm.

Një vit pasi pranova islamit u njoha me burrin tim, për të cilin i falenderohem Zotit edhe sot e kësaj dite. Ai është një person me të cilin merrem vesh jashtëzakonisht mirë, është i kuptueshëm, i durueshëm dhe prej tij kam mësuar shumë gjëra jo vetëm mbi islamit por edhe mbi mënyrën sesi të jetosh me islamit. Më mësoi të jem e durueshme, të njoh gabimet e mia, të jem e lumtur me pak dhe të mos shqetësohem për çështjet sipërfaqësore të kësaj bote dhe t'i jem mirënjohëse Zotit për gjithçka.

Kurrë nuk jam penduar që jam martuar me të edhe pse në fillim nuk njiheshim pothuajse fare. Më propozoi qysh ditën e tretë pas njohjes sonë. E dija se ai ishte personi i duhur për mua sepse në atë moment ndjeva atë ndjenjë që pata kur pranova islamit. Disa muaj pas dasmës, burri im mbrojti diplomën dhe së bashku morëm rrugën në vendin tim të ri, Kuvajtin. Disa javë para ceremonisë së dorëzimit të diplomës familja e burrit tim erdhi në Sllovaki, ku jetuam së bashku. Ata janë

njerëz të mrekullueshëm dhe mua më pritën, falë Zotit, krahëhapur.

Në Kuvajt mora pjesë në disa leksione të dijetarëve të njohur si p.sh. Jusuf Estesi nga SHBA, të organizuara nga IPC (Islam Presentation Committee - Komiteti i Prezantimit të Islamit) në Kuvajt. Tek IPC ndoqa dhe mësimet mbi fenë islame.

Në Kuvajt mësova shumë mbi islamit dhe për këtë më ndihmoi shumë familja e burrit, për të cilën islami është mënyra e jetesës. Me burrin ramë në ujdë që të krijojmë pak hapësirë kohore para se të lindim fëmijën e parë, pasi isha mjaft e re dhe se ishte e nevojshme që më parë të dija më tepër për islamit, për jetën në Kuvajt, gjuhën, etj. Mendoja se me fëmijë të vogël nuk do e përballloja dot. Tani e kuptoj se e kisha gabim. Do ia kisha dalë mbanë, vetëm me pak vonesë. Zoti na dhuroi një fëmijë të bukur, një vajzë që e quajmë Aisha, e cila mbush jetën tonë me gëzim, dashuri të ndërsjellë dhe mirënjohjen ndaj Zotit. Gjithmonë kam menduar se koha e përshtatsme për të patur fëmijë është atëherë kur ta ndiej brenda meje se jam e përgatitur për këtë moment. Zoti na „befaso!“ dhe më bëri të ditur se vetëm Ai e di kur është momenti i duhur për çdo gjë. Bashkë me burrin i jemi Atij jashtëzakonisht mirënjohës për këtë.

Po e mbyll historinë time me këto fjalë: le të na udhëheqë Zoti në të gjithë jetën tonë, t'i besojmë Atij, sepse vetëm Ai e di ç'është për ne më e mira, t'i jemi Atij gjithnjë mirënjohës, të përpiqemi të jemi myslimanë të devotshëm, t'i falemi Atij, ta kujtojmë Atë papushim dhe jo vetëm atëherë kur ndodhemi keq. Na dhëntë Zoti fuqi të mjaftueshme për të qëndruar në rrugën e drejtë. Amin!

Motra Aziza (Ummu Aisha) 2006  
© islamweb.sk Ummu Aisha

## Palltoja e virtytit

Veshja femërore islame e quajtur hixhab, sot kuptohet në disa mënyra. Për disa „misionare“ feministe në vendet myslimane kjo shihet si shenjë e një shoqërie patriarkale me qëllim nënshtrimin e gruas. Nga pikëpamja e femrave myslimane hixhabi shpreh identitetin. Gjithashtu shumë prej femrave laike të cilat demonstroi kundër shahut të Iranit në vitet 70-të mbanin shaminë në „shenjë protesti“. Franz Fanon e vëren këtë fenomen edhe tek femrat Algjeriane, të cilat në vitet 50-të protestonin kundër pushtimit kolonialist francez. Nga ana tjetër sipas disa personaliteteve femërore myslimane, si psh. mendimtarja egjiptiane Safinaz Kazim, duhet ta interpretojmë hixhabin si shprehje të kua-zi-feminizmit. Femra që paraqet në publik hijeshitë e saj, i nënshtrohet diçkaje që mund të quhet pa frikë „vjedhje virtuale“ sepse meshkujt përfitojnë kënaqësi pa lejen e saj. Me mbulimin e saj femra fiton të drejtën për t'u paraqitur si person fizik

vetëm në rrethin familjar apo mes motrave. Pikëpamja mbi hixhabin si pallto e virtytit, e cila është mjaft e dobishme nën dritëhijet e realitetit të botës së sotme, na mundëson ta vështrijmë femrën myslimane si individ të pavarur, beshike ndaj traditës islame dhe botëkuptimit të saj, të çliuar nga tundimi i paradave në publik dhe të siguruar ndaj „dhunimit vizual“ të kalimtarëve të rëndomtë. Kundërshtimet e feministëve ndaj veshjes „patriarkale“ dhe përkrahja që ata i japin zhveshjes së grave në bazë të pikëpamjeve të tyre, përkundër faktit se zbulimi e poshtëron femrën duke e degraduar në një pozitë të dobët e pa mbrojtje duke e transformuar atë në një objekt të rëndomtë në duart e meshkujve, bën që të humbasin argumentet ndaj hixhabin në momentin kur një individ i përgjegjshëm dhe i arsyeshëm fillon të bëjë edhe përpjekjen më të vogël për të kuptuar problematikën e hixhabin.

AbdulHakim Murad në: „Islam, Irigaray, and the Retrieval of Gender“  
© islamweb.sk

## Si i zgjedhim nuset dhe dhëndurët?

“U fejuar ajo, mori një djali që jeton në Itali. Ai djali ka shumë para dhe kështu nga paraqitja të merr në qafë” i tha grua-ja komshijes së saj për mbesën. Komshija e pyeti: “Po ky djali si është me sjellje dhe a është besimtarë apo fetarë?” Djalin nuk e njohim mirë por thone se është djalë i mirë. “Pastaj Valbonës i ka thënë se nëse dëshiron të falesh nuk të pengoj përkundraz i do t'i lehtësoi kushtet” kështu foli teza e vajzës të sapofejuar duke përcjellur fjalët e djalit me plot krenari.

### Pas një viti

Në edicionin e lajmeve u bë e ditur se një vajzë e fejuar është dhunuar për tu bërë prostitutë në ....” (kjo pjesë e tekstit nuk është reale por është e përdorur për ta sensibilizuar lexuesin me problemin e vërtetë duke sjellë edhe një rast tepër ekstrem.)

Ky është një shembull tipi i asaj kur personi nuk është i vëmendshëm por edhe neglizhon fenë (dhe gradën e besimit) të personit me të cilin dëshiron të

lidh jetën e tij/ të saj. Shembuj nga më të ndryshëm ndodhin sot në ambientet shqiptare duke përfshirë edhe shembulin e lartpërmendur. Është shumë e hidhur kur dëgjon lajme të tilla sidomos në një vend si Shqipëria ku besa dhe amaneti kanë qenë shtyllat e shoqërisë. Dikush para do kohësh më tregon për disa shembuj që janë duke ndodhur sot në shoqërinë tonë muslimane ku vajzat martohen pa kërkuar biografinë apo disa informata të personit me të cilin martohen. Si rezultat bëhen subjekt i rrahjeve dhe dhunës familjare dhe shembujt janë shumë të shpeshtë dhe shumë të freskët, mjaftohemi vetëm t'i hedhim një sy gazetave. Një rast tepër i hidhur është edhe një incident që ndodhi verën e kaluar kur një vajzë muslimane dëshironte të martohej me një djalë në Itali, personi në fjalë i thoshte vajzës që mund të falej në shtëpi sa herë të donte por kur u martua ai ia ndaloi asaj të falej. Një tjetër rast është rasti ku një motër muslimane u martua me një djalë, i cili e abuzonte tepër dhe pa u kursyer, pa përmendur se nuk e linte të falej dhe as që e linte të vinte hixhabin (mbulesën islame). Shumë motra muslimane të shtyra nga familjarët e pavëmendshëm bëjnë zgjedhje të gabuara në jetën e tyre për faktin se ata nuk shikojnë diçka kyçe tek personi me të cilin duan të martohen, e ajo është feja.

Një tjetër problem është edhe me ata të cilët informojnë personin i cili dëshiron të martohet. Pa i treguar atij të gjitha të metat apo mangësitë që ai person mund të ketë. Raste të tilla janë plotë. Duke dashur të mbrojnë njërin krah ata dëmtojnë krahun tjetër. Në një lidhje martesore ne duhet ta kemi të ditur se si vajza ashtu edhe djali janë të dashur për ne përderisa ata ndjekin fenë islame dhe kur japim një

informatë duhet të jemi tepër të saktë dhe të sinqertë pasi nëse nuk veprojmë kështu nuk përmbushim amanetin e të Dërguarit të Allahut, salallahu alejhi ve sellem. Resulullahi, salallahu alejhi ve sellem u pyet për disa sahabe në lidhje me një martesë, ai tha, mos merr filanin se ai i rreh gratë dhe mos u marto me filanin se ai është koprac. Pra siç e shohim sunneti na mëson të jemi të saktë në informatat që ne japim pa mbajtur krahun asnjërit prej atyre që pyesin në lidhje me martesën.

Një tjetër problem i cili është tepër shqetësues është me ata që pretendojnë se mund ta përmirësojnë personin me të cilin ata dëshirojnë të martohen. Këtu nuk po flas për persona të cilit janë besimtarë por për ata që nuk janë praktikant të fesë, sikurse ka plot në ambientet tona shqiptare. Një vëlla musliman dikur më thoshte unë do ta marr nusen jo praktikante dhe pastaj do ta përmirësoj vetë, ky person kishte kaq iniciativë të madhe sa që kishte harruar faktin se e kishte besimin e dobët (kjo shihej nga veprat e tij). E në vend që të merrte një muslimane të devotshme që t'ja plotësonte këtë boshllëk ai pretendonte të përmirësonte dikënd tjetër. Kur kujtoi këta individ më kujtohet një fabul me një peshkatarë i cili një ditë prej ditësh i thotë fshatit të tij që unë do t'ja mësoi peshkut gjuhën e njeriut dhe u nis. Në mbrëmje gjithë fshati u grumbullua për të dëgjuar lajmin e fundit. Peshkatarit doli para njerëzve dhe filloj të fliste, por pa zë, vetëm, sa hapte gojën dhe e mbyllte. Atëhere gjithë fshati filloi të qeshte sepse e kuptuan që peshku ja kishte mësuar gjuhën e tij peshkatarit. Siç shohim jo shumë kush mund të marrë iniciativë të tilla të cilat më vonë do të sjellin probleme si në familje por edhe në komunitet dhe

mund të ndjekin ndofta edhe fundin e peshkatarit.

Pra, në kërkimin e një bashkëshorteje/bashkëshorti personi duhet të ketë parasysh një thelb tërësisht të rëndësishëm që është feja dhe besimi i personit që kërkojnë të lidhin jetën.

Pejgamberi, salallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: “Një grua martohet për katër arsye, pasurinë e saj, prejardhjen e saj, bukurinë e saj dhe fenë e saj. Kështu bëhu i sukseshëm me fetaren...” [Hadithi i transmetuar nga Buhari dhe Muslimi]

Në një tjetër hadith thuhet: “Gruaja e mirë është ajo e cila kur e shikon, të kënaq, kur e urdhëron atë, të bindet, kur ju betoheni që ajo do ta bëjë një gjë ajo e përmbush premtimin dhe kur ju nuk jeni në shtëpi, ajo ruan çfarë është e juaja përta përket asaj (nderin) dhe pasurinë tuaj”. [Hadithi është i transmetuar nga Nesai]

Në një tjetër hadith thuhet: “Më e mira nga gratë e juaja është ajo që lind fëmijë, është e dashur, simpatike dhe nëse ajo i frikësohet Allahut”. [Hadithi i transmetuar nga Bejhaki]

Hadithi më i ashpër në aspektet për të cilat folëm më lart është ky: “Nëse dikush vjen tek ju feja dhe karakteri i të cilës ju e aproveni, atëhere martojeni me të. Nëse nuk veproni kështu atëhere do të ketë shturje në tokë”. [Hadithi është i transmetuar nga Tirmidhiu dhe Ibën Maxhe]

Ibën Tejmije ka qenë i mendimit se është e papëlqyeshme për një person të zgjedh një jobesimtare (nga Ehli Kitabi, çifutë dhe të krishterë) për martesë kur ka besimtare të pamartuara. Po ashtu, në lidhje me këtë shumica e ulemave janë të mendimit që martesë me jobesimtarët (nga Ehli Kitabi) është e ndaluar nëse personi

që kërkon të martohet me një jobesimtare jeton në vende ku nuk zbatohet ligji islam.

Ndërsa Ai, salallahu alejhi ve sel-lem ju drejtua një gruajë të cilës sapo i kishte vdekur burri: “Nëse gjen një person të devotshëm atëhere martohu”. [Hadithi është i transmetuar nga Ibën Maxhe]

Zgjedhja martesore është shumë e rëndësishme. Nëse duam të forcojmë ummetin e Muhammedit, salallahu alejhi ve sel-lem, duhet të bëjmë zgjedhje të mira. Kështu që nga këto familje të dalin gjenerata të pastra islame. Kjo është edhe një mënyrë për të ndryshuar ose për të bërë ndryshimin në shoqërinë tonë. Shpesh herë një zgjedhje kërkon durim pasi raset e mira vijnë kur personi bëhet i durueshëm, mbase edhe situata e një personi është vetëm një provë nga Allahu, i cili pas vështirësisë duhet të presë lehtësimin dhe shpërblimin.

Shpesh prindërit janë shkaktarët kryesorë për shumë zgjedhje që bëjnë në lidhje martesash. Ky është një fakt, ata vetëm e bëjnë sprovën edhe më të madhe sa që është duke i bërë lajka (fëmijëve të tyre në lidhje me personin që ata kanë zgjedhur) ose duke i bërë presione nga më të ndryshmet. Imam Gazaliu thotë diçka mbi këtë aspekt: “Kushdo që e marton vajzën me një të poshtër dhe keqbërës ose me atë që bën bidate ose që pi alkool me të vërtetë ka kryer një krim kundër fesë së tij duke ja ekspozuar vetes ndëshkimin e Allahut për përkeqësimin e lidhjeve përshkak të një zgjedhjeje të keqe të tij”. [Fikus Sunne, faqe 116]

Po ashtu nipi i të dërguarit të Allahut, Muhammedit, salallahu alejhi ve sel-lem, Hasan Ibën Ali, u pyet nga një person: “Unë kam një vajzë, kujt t’ja jap për martesë? Ai u përgjigj: “Martojë vajzën me atë

që i frikësohet Allahut, sepse nëse ai e do atë ai do ta nderojë dhe nëse nuk i pëlqen ai nuk do të bëhet i padrejtë ndaj saj”.

Shpresojmë që në të ardhmen të dëgjojmë lajme më të mira dhe jo këto që

po dëgjojmë dita ditës. Allahu na bëftë prej atyre që bëjnë zgjedhje të mira si në martesë ashtu edhe në jetë.

Ardit Kraja

## Lëshimet që duhen korrigjuar

Akoma jemi të ballafaquar me mungesë informacionesh dhe njohurish të mjaftueshme rreth edukimit të fëmijëve dhe të rinjëve (adoleshentëve), në fazën e ndryshimeve të pjekurisë fizike dhe biologjike. Kryesisht në këtë ngecje të mosedukimit dhe mostrajimit, kanë ndikuar faktorë të ndryshëm, duke filluar nga ai patriarkal, tradicional i trashëguar, gjë që ka bërë të jemi të rezervuar ndaj këtij procesi zhvillimor, nëpër të cilin kalojnë fëmijët.

Si rrjedhim, edhe intelektualët nga lëmi të ndryshme kanë hezituuar për të trajtuar dhe për t'u marë me tema të tilla. Hezitimi mund të sjellë ndonjëherë edhe fatalitet, në këto raste kur i neglizhojmë gjerat e kësaj natyre dhe nuk merremi drejtpërdrejt me edukimin e fëmijëve, në këtë periudhë kohore. Andaj edhe mungesa e guximit (në çdo aspekt), shpeshherë mund të sjellë pasoja të paparashikueshme.

Si popull po gjindemi në periudhë tranzicioni, kur te ne kanë vërshuar dhe po vërshojnë, krahas kulturave dhe përvojave pozitive, edhe degjenerimi bashkë me sëmundje të ndryshme infektuese. Pra ky është një problem shumë me rëndësi për t'u trajtuar edhe më shumë, për ta sensibilizuar opinionin.

Edukimi i fëmijëve në fushë të kësaj natyre duhet të fillojë nga mosha 7-8 vjeç, por edhe më herët nëse ka nevojë. Para se të shkojnë në shkollë, prindërit kanë detyrë dhe obligim për përkujdesje të tillë, kurse gjatë shkollimit (bashkë me mësimdhënësit) duhet të kenë përkujdesje të dyanshme prind-arsimtar, në mënyrë që këta fëmijë të bëhen njerëz të kulturuar dhe të njerëzishëm dhe bashkëshortë të denjë.

Ta dijmë se, për të qenë të suksesshëm, nuk i duhet falur fëmijës fjala më e vogël cinike a banale ose mungesa e mirësjelljes ndaj të tjerëve, duke filluar nga familja e ngushtë e deri të kalimtarit i rastit, kur i ndodhin ekcese rastësie me ndokend.

Të habit fakti se si disa prindërve nuk u bën përshtypje qëndrimi i djalit të tyre që komunikon ashpër me vajzat duke përdorur shpeshherë edhe fjalë banale, fatkeqësisht ka prej tyre që këtë e quajnë qëndrim “burrëror”.

Të kalosh lehtë dhe pa mbajtur qëndrim ndaj këtyre dukurive, do të thotë të rritësh një njeri arrogant, të pa kulturë dhe edukatë. Prindërit dhe mësimdhënësit në bashkpunim duhet të vëzhgojnë, të qortojnë dhe të edukojnë në raport të njejtë

edhe djemt dhe vajzat, në shtëpi, shkollë dhe gjetkë.

Është më se e njohur se fëmijët që nga moshën 8-9 vjeç fillojnë të njohin më shumë gjininë e tyre, si rrjedhojë krijohet njëfarë ftohjeje dhe ndasie në mes dy gjinive nën veprimin e disa ndjenjave dhe emocioneve të turbullta. Andaj prindërit në veçanti, dhe mësimdhënësit duhet të veprojnë në kohën e duhur më të gjitha masat për të kultivuar edukatë të shëndoshë dhe të mirëfilltë në ta, e jo të lihën në stihë që t'i edukojë rruga.

Për një afrim sa më stabil me ta, joparagjyqes, përveç bashkëpunimit mësimor dhe aktiviteteve të tjera shkollore, është me rëndësi edhe mësimi i besimit që i takojnë, sepse kjo është një provë e dukshme dhe shumë e suksesshme për të pasur fëmijë të sjellshëm dhe përparimtarë e të shëndoshë në moral dhe shëndet.

Në shtetet perendimore është shumë e hapur dhe transparente edukimi i fëmijëve edhe në frymën religjioze (fetare), proces ky i cili i bënë të zhvillohen edhe më shumë në aspektin mendor.

Në këto vende të civilizuara, krahas arsimimit edukohet fëmiju edhe në mësimbesimin që i takon, dhe është i lirë nga trysnitë dhe gjërat imponuese për jetën e tij, madje edhe është i aftë të bënë krahasime se cilat gjëra janë të dobishme për te e cilat jo, kurse tek ne ndodhë e kundërta. Një e kundërt që të rënqethë tërë trupin dhe qenien, sepse fëmijëve tanë iu ofrohet një planprogram (aktiv) me temë edukimi, duke filluar nga moshën 14-15, me mjete konkrete se si duhet të ruhen apo shmangën sëmundjeve të ndryshme infektuese, si dhe sëmundjes vdekjeprurëse AIDS-it.

Edhe pse, ligjëruesi i kësaj lënde, para se të jap shpjegimet konkrete rreth tyre, i këshillon, se ata janë të rinjë njëherë për të bërë akte të tilla, dhe se akoma nuk janë të pjekur fizikisht dhe psikikisht, si dhe se shkenca e mjeksisë nuk lejon nën moshën 18 vjeçare për të bërë akte të tilla, se nën këtë moshë mund të përjetojnë strese, trauma, ankthe etj., dhe se për probleme të tilla mund të humbasin shumë, si qetësinë shpirtërore, gëzimin, lumturinë, miqësinë, harmoninë familjare etj...

Mirëpo, me këtë po na japin të kuptojmë se, në njëfarë mënyre pas moshës 18 vjeç edhe mund ta bëjnë dhe se janë të edukuar se si të mbrohën duke përdorur preparate mbrojtëse!

Athua vallë, ku po mbetet morali, ku po mbetet nderi, kush duhet t'i definojë prindërit e fëmijëve të ardhshëm, ndoshta edhe të shumë fëmijëve edhe të sotshëm, vetëm AND-ja, asgjë tjetër, sepse po rrijmë dukryq para portës së hapur që dita ditës po e thithë moralin dhe nderin dhe xhelozinë tonë, të paktën as në shtëpi nuk po punohet me fëmijë se lenë më në shkollë!

Fëmijët duhet të motivohen për mësim, aktivitete të dobishme, kulturë etj, por edhe duhet shpjeguar në bashkëbisedim se cilat janë ndryshimet fizike, fiziologjike, ndryshimet mendore dhe si t'i kapërcejnë këto faza pa ekcese dhe trauma. T'i konsiderojnë si faza normale, të natyrshme të rritjes, zhvillimit dhe pjekurisë së njeriut.

Tek ne, të bisedosh me disa prindër mbi problematikën dhe pasojat në këtë lëmi, dalin shpeshherë gjëra të paqarta, të mjeçgulluara madje edhe shumë të ndërlikuara.

Fëmijët e moshës 4-5 vjeç, por edhe më të rritur, varësisht nga pjekuria fiziko-mendore, ndonjëherë i hasim duke sharë, duke përdorë termet më fyese dhe



banale e të ndyra. Prindërit (sidomos disa të cilët janë me ngritje më të ulët arsimore) arsyetojnë duke pohuar thjesht se akoma është fëmijë. Ka raste kur prindi bie në dilemë se si të veproj, se si ta përmirësoj gabimin e fëmijut të tij që gaboi.

Pa dyshim se duhet referuar dikund, por fatkeqësisht që ende nuk kemi zyra (institucione) këshillëdhënëse profesionale të kësaj lëmie, ku do të drejtoheshin për ndihmë pa hamendje, atëherë na bënë të kuptojmë që fëmijët e prindërve të tillë të cilët nuk i shqetëson sharja dhe fjalori i ndytë i fëmijës së tyre, dhe ata të cilët bien në konfuzion se si t'i ndihmojnë fëmijës së tyre për t'u përmirësuar në gabime përkatëse, duhet të lihën të anashkaluar, pasi që nuk ka institucione përkatëse!

Bëhet pyetja; çfarë i sjellin vetes, familjës dhe shoqërisë në të ardhmën këta fëmijë me një sjellje dhe edukatë të tillë? A mos vallë duhet të presin deri sa të hapet një institucion dikund?

A thua askund nuk ka një burim apo diçka që ju shërben të gjithëve, madje edhe rasteve të tilla, një diçka që nuk bënë dallim moshe e race apo klase dhe gjinie.

Nëse tamam dikund gjindet diçka apo ndonjë literaturë e cila na shërben të gjithëve, madje edhe atyre që ende preten-

dojnë të hapin zyra profesionale për edukim, pse të mos sherbëhemi në vend se të rrimë në gjumë si ari i viseve polare, pse mos t'i referohemi librit i cili është burim i pashtershëm dhe mostër për cdo gjë e më së shumeti për dukurinë bazë të njeriut, edukatën. Një burim i cili është me shekuj e shekuj i pandryshuar dhe me bazë dhe themele të forta. Pse të mos i referohemi Kur'anit fisnik i cili është ilaç për të gjithë dhe i pashtershëm përgjithmonë.

Andaj me futjen e mësim-besimit nëpër shkolla dhe me edukimin e fëmijëve tanë me edukatë fetaro-islame, nuk kemi nevojë asnjëherë për shqetësime të shprehjeve të ulta të fëmijët tanë e as nuk kemi nevojë për përdorim të preparative mbrojtëse kundër sëmundjeve vdekjeprurëse, sepse ky oqean i pafund, pra Kur'ani Fisnik me etikën që ka, këshillon dhe udhëzon për jetë të ekuilibruar drejtë dhe të realizuar brenda kurorës, dhe të dy gjinive u jep vendin meritë e prestigjioz dhe rehatinë shpirtërore.

Pra, gabimet dhe lëshimet që po i bëjmë pa i korrigjuar, janë bërë si pjesë e natyrshme e jetës tonë, nga të cilat askush s'është i veçuar. Ta dijim se familja dhe shoqëria e shëndoshë kërkojnë vendosmëri, angazhim, përgjegjësi dhe bashkupim.

Valbona Kelmendi

## Vani Mehmed Efendi

Ndonëse lëvizja e Kadizadlive në perandorinë osmane u shtyp në vitin 1656/1066 hixhri, ndikimi i saj vazhdoi me Vani Efendiun në periudha të më vonshme. Vani Mehmed Efendi ishte Shejh Sejjid Mehmed El-Vani b. Shejh Bistam. U lind në Hoshab që është në provincën Van (Turqia e sotme). Ai mori mësimet e para në familjen e tij nga gjyshi i tij. Më pastaj ai shkoi në qytetin Van dhe filloi arsimin e tij formal në medrese. Qëndroi aty deri në vdekjen e gjyshit të tij. Pastaj Vani efendi udhëtoi deri në Tebriz, Karabag dhe Gandja për të vazhduar studimet e tija. Në këto qytete të Azerbejxhanit ai studioi histori, tefsir dhe histori të pejgamberëve (kisasi enbija). Burimet nuk saktësojnë se pse Vani zgjodhi të shkon në Azerbejxhan por ne mund të spekulojmë se kjo ndodhi ngase ishte afër Van-it dhe ngase në te kishte dijetarë me renome. Pasi kompletoi studimet e tija Vani efendi shkoi në Erzurum. Atje ai mbante ligjërata dhe përcillte dijen ndëgjuesve. Reputacioni i tij u përhap në kohë të shkurtër. Në muajin Dhul Hixhe 1069/gusht 1659, vali (governator) i Erzurumit u caktua Fazil Ahmed Pasha, në kundërshtim me sjelljen jotolerante të babait të tij ndaj Kadizadlive, ai afektoi mirë ndaj Vanit.

Më pas Vani efendi nga Erzurumi shkoi në Brusë. Kur Fazil Ahmed Pasha u caktua kryevezir në vend të babait të tij (1072/1661) ai ftoi Vani Efendiun në Edrene. Mehmed IV prezantoi hutben e xhumasë që mbajti Vani në xhaminë e vjetër të Edrenesë (Xhami-i Atik). Vani Efendi shkoi

në Stamboll dhe në vitin 1074/1663 dhe u emërua vaiz në xhaminë e sulltan Selimit. Nga Mehmed IV Vani së pari u bë mësues i sulltanit dhe më pas i djalit të sulltanit Mustafa. Kur më pas mori titullin ligjërues i oborrit (hunkar vaizi) edukimin e princave ia la nipit të tij Fejzullah Efendiut, në vitin 1080/1669. Vani Efendi kishte përkrahjen e të dyve, edhe të sulltanit edhe të vezirit. Me ndikim të këtij të fundit ai u caktua të mban hutbet e xhumasë në Jeni Xhami (Valide Sultan Xhami 1074/1664). Sulltani i dha në posedim formal sarajet e Kestel-it në Brusë dhe të fshatit afër si dhe koncesionin të mbajë tokë në Paps bahçesi afër Bosforit. Vani efendi ndërtoi xhami, medrese dhe rezidencë për vete në këtë vend i cili më pas u emërtua sipas tij dhe njihet deri në ditët e sodit si Vanikoj (fshati i Vanit).

Kur ndodhi rrethimi i dytë i Vjenës në vitin 1094/1683, Vani Efendi ishte në ushtri në pozicionin e Ordu Shejhi (shejh i ushtrisë). Pas humbjes në Vjenë, që ishte një humbje e madhe për ushtritë osmane, kryeveziri ishte ekzekutuar kurse Vani Efendi me dekret zyrtar dërgohej në Edrene. Nga këtu ai shkoi në ekzil në fermën e tij në Kestel. U sëmur dhe ndërroi jetë më 1096/1685.

Dy biografë (Ushakizade dhe Shejhi) përshkruajnë kualitetet intelektuale të Vani Efendiut me fjalë miradie. Ata e përshkruajnë ate si diell të qiejve të shkencës dhe dijeve shpirtërore. Mendja e tij penetroi në finesat e dijes së konfirmuar. Vani efendi

nga këta burime përshkruhet si person me dije edhe në degët e edhe në metodat e shkencës. Në to përfshiheshin edhe shekncat racionale e edhe ato tradicionale.

Veprat e tij:

-Risalet e Vani Efendiut mbi praktikat sufite dhe bidatet. (Muhjis-sunne ve mumitul bidat)

-Munshelat, korespondenca me qeveritarët

Vani efendi jipte ligjërata dhe luftonte bidatet sidomos ishte kundër praktikave dhe bidateve të sufijve të atëhershëm për të cilët thotë se janë "të prishur dhe bidatçinjë". Ai poashtu fliste për disa libra të shkruara nga mistkë të cilat muslimanët duhet pushuar së lexuari. Ai influenoi që të nxirret dekret për ndalim të një praktike sufite e quajtur "sema" si dhe influenoi për shkatërrimin e një tyrbeje ku injorantë nga popullata kërkonin ndihmë nga të vdekur!

Ermi i Vani efendiut përmendet edhe në lidhje me Sabbatai Sevi (1626-1676), lider i një lëvizjeje mesianite të çifutëve në periudhën osmane. Pasi shpalli veten për Mesia ai u nxor para një gjyqi special dhe ku u ndodh para dy zgjidhjeve ose të pranonte islamin ose të dënohej me vdekje. Pranoi fenë islame dhe morri emrin Aziz Mehmed Efendi, gruaja dhe disa përkrahës të tij poashtu pranuan fenë. Vani Efendi përmendet si njeri i cili e mbronte Sabbatai Sevin, bashkë me sulltanin dhe ka indikacione që Vani Efendi ka pasë marrëdhënie të ngushta me Sevin pasi që ky i fundit të ketë pranuar fenë islame. Vani efendi ose besonte se konvertimi i këtyre ishte i sigurt ose se do mund që ti afroje më shumë me fenë islame nëse i mëson ato. Sidoqoftë Vani Efendi ka shfaqë mundin më të madh të mundshëm që të konvertojë sa më shumë çifutë në islam.

Semiramis Çavushoglu  
përktheu: R.R.

## Muhammed Hamid El Fekij

Shejh Muhammed Hamid El Fekij është themeluesi i lëvizjes reformiste Ensar Es Sunne El Muhammedije në Egjipt. Kjo lëvizje u themelua në qytetin e Kairos në vitin 1926 nën udhëheqësinë e Muhammed Hamid El Fekij në kohë kur në shumicën e vendeve islame dominonin risitë dhe bestytnitë.

Qëllimi kryesor i kësaj lëvizjeje ishte ripërtëritja e thirrjes Islame të pastër të mbështetur në shpalljen hyjnore, Kur'anin dhe Sunnetin.

Themeluesi i saj Muhammedi lindi në vitin 1310 H (1892 G) në shtëpi të njohur dhe të dalluar me dije dhe fe. Ati i tij ka qenë dijetar që mësonte së bashku me Muhammed Abduhu-në. Në vitin 1322 H (1904 G) filloi

mësimet në institucionet arsimore të universitetit të famshëm Al Az-har. Deri në moshën tetëmbëdhjetë vjeçare përvetësoi dije të gjerë dhe rreth tij u tubuan shumë kolegë, të cilët e respektonin si mësuesin e tyre.

Në vitin 1917 G diplomoi në universitetin e Al Az-harit dhe filloi thirrjen në Teuhid të pastër dhe në kthim në sunnetin e pastër. Xhamitë Çerkez dhe Heddare në të cilat punonte si imam, ishin qendra të thirrjes. Ky aktivitet rezultoi me tubimin e njerëzve rreth tij, gjë kjo e cila shkaktoi dhunë dhe presion kundër ithtarëve të kësaj lëvizjeje që i inicionin tarikatat e ndryshme, ekstreme sufite dhe pasuesit e lajthitjes moderniste.

Në dhjetor të viti 1926 G u themelua lëvizja reformiste e njohur me emrin Xhemati i Ndihmëtarëve të Sunnetit të Muhammedit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem:

Pas zyrtarizmit të lëvizjes filloi një aspekt i ri i thirrjes dhe numri i pasuesve u rrit akoma më shumë. Kjo përhapje e gjerë shkaktoi indignatën e disa strukturave të oborrit mbretëror të cilët filluan një fushatë kundër lëvizjes. Sulmet arritën kulmin kur disa vrasës të paguar u orvatën të mbysin shejhun Muhammedin.

Gjatë qëndrimit të themeluesit në Hixhaz, që zgjati tre vjet, lëvizjen e kaploi fazë e stagnimit. Pas kthimit të tij në vendlindje, sërish filloi aktiviteti i gjerë i organizatës e cila tani më kishte plan-programin e punës dhe organet e saj. U hapën degë të reja në Kajro, Giza dhe Aleksandri. Numri i pasuesve tash numërohej me mijëra.

Pas përforcimit struktural të organizatës ajo filloi të publikon revistën e saj Udhëzimi i të Dërguarit që ishte zëdhënëse e organizatës në të cilën ata shprehnin mendimet dhe qëndrimet e tyre.

Kryeredaktori ishte vetë Muhammed efendi në kohë që në këshillin redaktues anëtarë ishin edhe disa dijetarë të njohur të asaj kohe si Ahmed Shakiri (muhadithi i njohur), Muhibuddin El Hatib, Shejhu Muhjuddin Abdul Hamid, Shejhu Mahmud Sheltut (i cili në atë kohë ishte shejhul -Az-har- dhe të tjerë.

Më zgjerimin e punës u shfaq nevoja për hapjen e shtëpisë botuese e cila do të merr përsipër botimin e librave të Selefit, gjë kjo e cila u realizua me hapjen e shtypshkronjës: metbaatus-sunneti muhammedije.

Dashuria për Ibën Tejmijen dhe Ibën Kajjimit krahas El Fekij-ut, në këtë shtypshkronjë i bashkoi Mahmud Sheltut-in dhe Abdul Mexhid Selim-in.

El Fekij morri pjesë aktive në luftën kundër okupimit britanik pas luftës së dytë botërore. Shtypshkronja e lëvizjes publikonte edhe botime kundër pushtuesit britanik.

Në këtë periudhë lëvizja zhvillonte luftë në dy fronte: kundër risive dhe besëtytnive si dhe kundër lëvizjeve moderniste që kërkonin ndërrimin e sheriatit me ligje të shpikura njerëzore.

Zëri i shejhut ishte i ashpër kundër këtyre që vepronin për rrënimin e vetëdijes fetare tek populli.

Thoshte: "Ai që i merr për ligj fjalën e francezëve dhe me atë gjykon në çështjet e gjaqeve, nderit dhe pasurisë duke i dhënë përparësi asaj fjale para Kur'anit dhe Sunnetit, ai njeri pa dyshim është murted-reneгат dhe qafir i cili nëse nuk e braktis këtë qëndrim duke iu kthyer gjykimit të All-llahut, nuk do t'i bën dobi as emri i tij mysliman e as veprat e tij të jashtme si namazi, agjërimi, haxhi dhe të ngjashmet..."

Cilësi kryesore me të cilën dallohej ishte trimëria dhe "emërtimi i gjërave me emrin e tyre të vërtetë" duke mos aktruar...

Fjalët e buta me ithtarët e risive i konsideronte dyfytirësi, heshtjen dhe mosthënien e së vërtetës e quante frikë dhe poshtërim. Ky qëndrim i tij ishte shkak i presioneve të shumta që u shfaqën me ndërrimin e shpeshtë të posteve.

Ndërroi jetë në mëngjes ditën e xhumasë, më 7 Rexhep të vitit 1378 H (16 Janar 1959 G) pas një operacioni mjekësor. Ndërroi jetë në shtëpinë e organizatës, në të cilën erdhi duke dashtë që namazin e saba-hut ta falë me vëllezërit e tij. Lajmi i vdekjes së tij u përhap shpejt. Xhenazen e tij e përcollën shumë dijetarë në krye me rektorin e Al Az-harit Husenejn Mahluf. All-llahu e mëshiroftë me mëshirën e Tij të gjerë. Amin.

Përktheu: Talha Kurtishi

## Maria El Kibtijje

Maria El Kibtijje, All-lahu qoftë i kënaqur me të. Bashkëshortja e të Dërguarit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, dhe njëra prej grave që mbajnë titullin e nderit “Nëna e besimtarëve”.

Ka lindur në Egjiptin verior në familje Kopte, prej atit kopt dhe nënës greke dhe prej moshës fëmijërore shërbeu në oborrin mbretëror të Mukaukis-it (mbreti i atëherëshëm i Egjiptit). Si dhuratë e mbretit për Muhammedin, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, arrin në Medine fill pas nënshkrimit të marrëveshjes në Hudejbije. Në vitin e nëntë hixhrij (viti 630 G) lindi djalë të cilin i Dërguari i All-lahut e emërtoi Ibrahim i cili kur i mbushi tetëmbëdhjetë muaj u sëmur dhe ndërroi jetë. Gjatë varrimit të djalit lot u panë në sytë e të Dërguarit të All-lahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem. Kur njëri prej të pranishmëve e pyeti për lotët tha: Ato janë

mëshirë. Mu në atë ditë humbi drita e diellit dhe i Dërguari i All-lahut, i tuboi njerëzit duke u shpjeguar realitetin që ajo nuk ka ndodh për shkak të vdekjes së Ibrahimit dhe se ajo ndodhi është shenjë (argument) e madhërisë së All-lahut. Pas hutbes ata u falën deri sa përsëri u paraqit dielli.

Maria ka qenë e nderuar prej të Dërguarit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, prej familjes së tij dhe shokët e tij. Ishte bashkëshortë e të Dërguarit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, deri në fund të jetës së tij dhe pas vdekjes së tij jetoi pesë vjet dhe ndërroi jetë në vitin 16 hixhri (637 G). Pesë vitet e fundit jetoi e tërhequr prej jetës duke mos dalë prej shtëpisë përpos për të vizituar varrin e të Dërguarit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem. Xhenazen ia fali Omeri, radijall-lahu anhu, dhe u varros në varrezat El Beki’.

Përktheu: Talha Kurtishi

## Muaji Xhumadel Ula

Ky është muaji i pestë në vitin e Hixhretit.

Emri i këtij muaji rrjedh nga folja "xhemede" që d.m.th. ngriu, u bë akull. E mori këtë emër sepse emërtimi i tij u bë gjatë dimrit, kur uji ngrinte, edhe pse sivjet ka qëlluar mu në verë. Ndërsa pjesa e dytë e emrit: Ula d.m.th. e parë. Pra, kuptimi i emrit të këtij muaji është dimri i parë apo ngrija e parë.

Ky muaj është sikur çdo muaj tjetër gjatë vitit, i cili nuk ka ndonjë veçori të caktuar fetare, andaj, edhe duhet të mbetet i tillë.

Nga ngjarjet më të dobishme dhe interesante që kanë ndodhur në këtë muaj, kemi veçuar:

1. Në datën 2 të vitit 3 H (624 G), Resulullahu, salallahu alejhi ue selem, brigadën e Zejd ibën Harithit e dërgoi në pritë të karvanit të kurejshëve. Ata u takuan në vendin e quajtur Kirede, ku myslimanët arritën të mbisundojnë karvanin dhe kjo ishte plaçka e parë me vlerë që kishin fituar myslimanët.

2. Në datën 27 të vitit 13 H (634 G) ishte beteja e Exhnadinit midis myslimanëve, të cilët ishin nën udhëheqjen e Halid ibën Velidit dhe romakëve, të cilët ishin nën udhëheqjen Kabkalarit. Në këtë betejë triumfi ishte për myslimanët, triumf i cili, i hapi edhe më shumë dyert e çlirimit të vendeve në Sham.

3. Në datën 10 të vitit 36 H (656 G), ishte beteja e Xhemelit (devesë) midis Alijut radijallahu anhu, dhe grupit që u ngritën kundër tij, të cilët kërkonin hakmarjen për gjakun e Othmanit, radijallahu anhu. Në atë grup ishin Talha, Zubejri dhe Ajsheja, radijallahu anhum. Këta u takuan në një vend afër qytetit Basra, e Ajsheja radijallahu anha, ishte në heudexhin (samar në formë dhome) e saj mbi deve, e cila ishte e rrethuar

nga shumë luftëtarë. Aliju, radijallahu anhu, kur pa kufomat e shumta përreth deveve, urdhëroi që deveja të theret, ndërsa heudexhi së bashku me Ajshe, radijallahu anhu, të bartet larg betejës. Ky është shkaku pse kjo betejë është emërtuar: beteja e deveve (ma'reketul xhemel).

4. Në datën 14 të vitit 73 H (692 G), ndërroi jetë Abdullah ibën Zubejr ibën Avami. Ai ishte i pari nga myslimanët që kishin lindur në Medinë. Ka qenë trim dhe i mençur, ka marrë pjesë nëpër çlirimet Islame duke qenë edhe fëmijë. Mori pjesë në çlirimin e Afrikës veriore në kohën e Othmanit, radijallahu anhu. Pas vdekjes së Muavijut, nuk pranoi t'i japë besën e respektit djalit të Muavijut, Jezidit, dhe kështu u përqendrua në Mekë. E pas vdekjes së Jezidit, në vitin 64 H e shpalli veten halife. Hilafeti i tij nuk zgjati shumë, sepse atë e vrau Haxhaxhi, i cili kishte marrë urdhërin nga Abdulmelik ibën Mervani.

5. Në datën 11 të vitit 150 H (767 G), ndërroi jetë Nu'man ibën Thabiti, i mirënjohuri Ebu Hanife, njëri nga katër imamët e dalluar të Islamit dhe imami i medhhebit Hanefij. Ai kishte lindur në Kufe, ku u rritë dhe mësoi. Aty u bë i pari në shkencën e fikhut pas vdekjes së mesuesit të tij. Pas kësaj, ai pati nxënës shumë të dalluar, të cilët më vonë do të përmbledhin dhe themelojnë medhhebin hanefij, si dhe do të veprojnë në përhapjen e tij anekënd botës.

6. Në datën 11 të vitit 570 H (1174 G), Salahudin Ejubi arriti t'ia bashkëngjiti shtetit të tij edhe qytetin Humus. Kjo ndodhi në kuadër të projektit të tij "Unioni Islam" që synonte bashkimin e Egjiptit, Irakut dhe disa vendeve tjera, me qëllim për t'i bërë ballë prezencës së kryqëzatave. Qytetin Humus, Salahudini e mori pa luftë.

7. Në datën 20 të vitit 857 H (1453 G), osmanlinjtë, nën udhëheqjen e Mehmed (Muhammed) Fatihut arrijnë të çlirojnë Konstantinopolin. Kjo ndodhi pas shumë tendencave në këtë drejtim, të cilat kishin filluar që nga koha Muavijut, radijallahu anhu. Konstantinopoja ishte kryeqytet i perandorisë bizantine plot 1125 vjet. Rënia e saj nën osmanlinjtë shkaktoi humbje të madhe për jomuslimanët edhe në Evropë. Ky qytet pas çlirimit mori emrin Stamboll, të cilin e ka edhe sot.

8. Në datën 19 të vitit 911 H (1505 G), ndërroi jetë dijetari i njohur Xhelaludin es-Sujuti. Ishte ky, njëri nga kolosët islam në shkencën e fikut dhe të hadithit në shekullin e tij. Ai më së tepërmi është bërë i njohur me enciklopeditë e tij të shumta në shkencat e ndryshme. Thuhet se vetëm të botuara i ka 234 tituj. Disa libra të vogla i ka të përkthyer edhe në shqip.

9. Në datën 21 të vitit 950 H (1543 G), flota e osmanlinjve, që ishte nën udhëheqjen Hajrudin Barbarosës, e rrethoi qytetin Nice të Francës dhe e çliroi me forcë. Kjo u bë me kërkesë nga vetë Franca, për të përfituar ndihmë kundër spanjollëve, të cilët e kishin okupuar qytetin Nice.

10. Në datën 1 të vitit 954 H (1547 G) u bë një marrëveshje pajtimi midis shtetit osman dhe Austrisë. Dy palët nënshkruan armëpushim pesë vjeçar, me kusht që Austria t'i paguajë shtetit osman xhizje (tatim) vjetore prej 30 000 dukatëve.

11. Në datën 26 të vitit 998 H (1590 G), shteti Osman bën marrëveshjen e Stambollit me shtetin e safevijve në Iran. Me këtë marrëveshje përfundoi lufta 12 vjeçare mes këtyre shteteve. Në këtë marrëveshje Irani pranoi që të respektojë lirinë e medhhebit sunit, u pajtua që të mos i fyen sahabët dhe u morën vesh që t'i ndërrojnë robërit që kishin të dy palët. Por, Irani i sotëm, kësaj marrëveshje nuk i përmbahet.

12. Në datën 30 të vitit 1084 H (1673 G), shtetet e Evropës i shpallin luftë shtetit osman. Kjo luftë zgjati 13 vite. Këto vite në historinë osmane njihen si vite të fatkeqësisë. Ky komplot evropian u bë me qëllim të nxjerrjes së myslimanëve turq nga Evropa në Azi. Papa i atëhershëm këtë luftë e quajti "Kryqëzata e 14-të kundër turqve".

13. Në datën 13 të vitit 1150 H (1737 G), komandanti turk, lved Muhamed Pasha, gëzon triumfin mbi ushtrinë gjermane në betejën "Vidan", në frontin e Sërbisë. Në këtë betejë u vranë 6000 ushtarë gjermanë.

14. Në datën 19 të vitit 1347 H (1928 G), qeveria turke, në kohën e Kemal Atatürkut, sjell vendimin për t'u përdorur shkronjat latine në vend të atyre arabe. Zbatimi i kësaj duhej të fillonte me gazetatat e pastaj edhe me librat. Ky vendim thoshte edhe atë se, fjalët arabe dhe persiane gradualisht duhet hequr nga turqishtja. Ky vendim solli vetëm një "dobi", të gjithë popullin e Turqisë e bëri analfabet.

15. Në datën 4 të vitit 1350 H (1931 G), shpresojmë që Omer Muhtari ta ketë fituar shehidllëkun. Ai udhëhiqte lëvizjen "Xhihad Islamik" në Libi, kundër okupimit italian.

16. Në datën 17 të vitit 1351 H (1932 G), mbreti AbdulAziz ibën Ali Suudi korre sukses që shumicën e vendeve të Gadishullit Arabik, t'ia bashkangjiti shtetit të vet, sikurse Hixhazi, Nexhdi, Ahsaja etj. Me këtë iu dha fund edhe rebelimeve dhe u shpallë Mbretëria e Arabisë Saudite.

17. Në datën 2 të vitit 1399 H (1979 G), Liga Arabe në një mbledhje që e mbajti në Bagdad vendosë t'i tërheqë të gjithë ambasadorët nga Egjipti, t'i ndërpret lidhjet diplomatike me Kajron, vendosin mundësinë e përjashtimit të Egjiptit nga Liga Arabe dhe vendosin që selia Ligës Arabe të transferohet nga Kajroja në Tunis. E gjithë kjo, për shkak të marrëveshjes për paqe, të cilën e bëri Egjipti me Izraelin.

Omer Berisha

## Besimi në melekët

Të besosh në melekët do të thotë të kesh besim të prerë se Allahu, subhanehu ve teala, krijoi ata prej dritës, natyra e të cilëve gjithmonë e respekton Allahun. Ata asnjëherë nuk kundërshtojnë urdhrat e Zotit porse zbatojnë ato me përpikëri. Ata natë e ditë madhërojnë Allahun dhe nuk mërzhiten. Numrin e tyre nuk e di askush pos Allahut. Allahu, subhanehu ve teala, i ngarkoi me detyra dhe obligime të ndryshme. Ai thotë në Kur'an: "por mirësi e vërtetë është ajo e atij që i beson All-llahut, ditës së gjykimit, engjëjve." (Bekare - 177), po ashtu Allahu, subhanehu ve teala, thotë: "Secili i besoi All-llahut, engjëjve të Tij, shpalljeve të Tij, të dërguarve të Tij." (Bekare – 285).

Në hadithin e njohur të Xhibrilit kur e pyeti Pejgamberin sal për imanin, ai u përgjigj: "të besosh Allahun, melekët e Tij, librat e Tij, pejgamberët e tij, Ditën e Ahiretit dhe të besosh në caktimin, të mirën dhe të keqen."

### Rrëndësia e besimit në melekët:

Besimi në melekët është shtylla e dytë prej gjashtë shtyllave të besimit, pa të cilat nuk mund të ekzistojë ai besim. Muslimanët, që të gjithë janë të një mendimi për obligushmërinë e besimit në melekët fisnik. Ai që mohon ekzistimin e tyre apo ekzistimin e ndonjë melekut i cili është përmendur nga Allahu ka ra në mosbesim dhe ka kundërshtuar Kur'anin, Sunnetin dhe konsenzusin (ixhmanë). Allahu, subhanehu ve teala, thotë: "Kush nuk i beson All-llahut, engjëjve të Tij, librave të Tij, të dërguarve të Tij dhe botës tjetër, ai ka humbur tepër larg." (Nisa - 136)

### Mënyra e besimit në melekët:

Besimi në melekët duhet të jetë i përgjithshëm dhe i detajizuar. Mënyra e përgjithshme e besimit përfshinë:

1. Pranimin i ekzistimit të tyre dhe se ato janë një nga krijesat e Allahut. Allahu i krijoi për ta adhuruar Atë. Ekzistimi i tyre është real dhe fakti se ne nuk i shohim nuk do të thotë se ata s'ekzistojnë. Sa shumë krijesa të imta ka në gjithësi e ne nuk i shohim edhe pse ato realisht ekzistojnë!? Pejgamberi, salallahu alejhi selem, e ka parë Xhibrilin as dy herë në formën e tij të vërtetë kurse disa shokë të tij kanë parë disa melek të personifikuar në njerëz.

Imam Ahmedî, rahimehullah, transmeton në "Musned" nga Abdullah ibën Mes'udi, radijallahu anhu, i cili ka thënë: "Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, e ka parë Xhibrilin në formën e tij i cili kishte gjashtëqind mijë krahë dhe çdonjëri krah kishte zënë horizontin." Po ashtu në hadithin e njohur si hadithi i Xhibrilit që e transmeton Muslimi ceket se në mesin e sahabëve vjen një njeri me robra shumë të bardha e flokë shumë të zeza, ai ishte Xhibrili, alejhi selam.

2. T'ua japim atë pozitë të cilën ua dha Allahu, subhanehu ve teala. Ata janë robër të Allahut që urdhërohen. Allahu i nderoi, e ngriti pozitën e tyre dhe i afroi afër Tij. Prej tyre ka të ngarkuar me zbritjen e shpalljes. Ata nuk kanë fuqi veç asaj që Allahu u ka mundësuar. Ata megjithëkëtë nuk kanë në dorë që dikujt t'i bëjnë dëm ose dobi pa lejen e Allahut. Për këtë arsye nuk lejohet që t'ua drejtojmë adhurimet tona e të mos flasim për ndalesën e cilësimit



tyre me cilësi të Zotit siç pretenduan krishterët për Shpirtin e Shenjtë, alejhi selam. Allahu, subhanehu ve teala, thotë: "ata thanë: "I Gjithëmëshirshmi ka fëmijë!" Larg saj qoftë madhëria e Tij! Ja, ata janë robër të ndershëm! Që nuk flasin para Tij, ata veprojnë me urdhrin e Tij." (Enbija - 27,28) po ashtu Allahu, subhanehu ve teala, thotë: "nuk e kundërshtojnë All-llahun për asgjë që Ai i urdhëron dhe punojnë atë që janë të urdhëruar." (Tahrim - 6)

Këto janë gjëra esenciale që çdo musliman dhe çdo muslimane duhet t'i mësojë dhe ti besojë.

### **Besimi në mënyrë të detajuar përfshinë:**

#### **1. Prej çka i krijoi Allahu melekët?**

Allahu, subhanehu ve teala, melekët i krijoi prej dritës ashtu siç i krijoi xhinët prej zjarri kurse njerëzit prej balte. Ata u krijuan para Ademit, alejhi selam. Në një hadith që e transmeton Muslimi thuhet: "melekët u krijuan prej dritës, xhinët prej flakës së zjarrit kurse Ademi u krijua ashtu siç u sqarua për ju (në Kur'an).

#### **2. Numri i melekëve:**

Melekët janë krijesa numrin e të cilëve nuk e di askush pos Allahut, për shkak se janë shumë. Nuk ka në qiell vend sa katër gishta e aty të mos ketë ndonjë melek në sexhde, në ruku apo në këmbë. Në "Bejtul m'amur", në qiellin e shtatë, çdo ditë hynë shtatëdhjetë mijë melek, pastaj më nuk kthehen (sepse s'ju vjen radha). Ditën e Kijametit do të sillet Zjarri me shtatëdhjetë mijë litarë, me çdo litarë ka shtatëdhjetë mijë melek që e tërheqin. Allahu, subhanehu ve teala, thotë: "e ushtrinë e Zotit tënd nuk e di kush pos Atij." (Muddethir - 31). Në një hadith Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: "rënkon qielli, po edhe ka të drejtë pse rënkon. Nuk ka vend sa një këmbë e të mos jetë i zënur më ndonjë melek që është në sexhde apo në ruku."

Nga kjo kuptojmë numrin e madh të melekëve. I madhëruar qoftë Ai që i krijoi, i rregulloi dhe e di numrin e tyre.

#### **3. Emrat e melekëve:**

Obligohemi të besojmë melekët që i njohim me emra prej Kur'anit apo sunnetit. Më madhështorët janë tre:

Një: Xhibrili apo Xhebraili. Ai është shpirti i Shenjtë i cili zbriste shpalljen pejgamberëve për gjallërimin e zemrave.

Dy: Mikaili ose Mikali. Ky melek ka për detyrë mbikqyrjen e shiut me të cilin gjallëron toka.

Tre: Israfili i cili është i obliguar t'i bie surit (burisë) si lajmërim për përfundimin e jetës së kësaj bote dhe fillimit të Ahiretit. Me këtë gjallërojnë trupat.

(vijon në numrin e ardhshëm, inshaAllah)

Përgatiti: Agim Bekiri

## Pyetje dhe përgjigje

### Votimet

Numri: 1324      Data: 29.05.2006

**Pyetje:** Disa myslimanë që jetojnë në vende joislame, dëshirojnë të dinë se a lejohet të marrin pjesë në votime, gjegjësisht të votojnë për parti joislame. Thonë se, disa parti të caktuara, do të mund t'i shërbenin myslimanëve po të fitonin?

**Përgjigje:** Falënderimi i takon vetëm Allahut, subhanehu ue teala. Kjo mesele, është nga çështjet ku fetvaja ndryshon, varësisht prej kohës, vendit dhe situatës. Në këtë mesele nuk kemi të drejtë të japim një fetva e cila do të vlente për çdo situatë.

Në disa situata nuk është e udhës që myslimanët të marrin pjesë në votime, siç ndodhë që myslimanët të mos fitojnë asgjë nga ajo apo të mos ketë ndonjë ndikim vota e myslimanëve në ato parti. Votuan apo nuk votuan, çështja nuk ndërron.

Kjo vlen edhe për raste të ngjashme, siç ndodhë që i votuari të ketë të njëjtin qëndrim negativ ndaj myslimanëve, sikur ai që ka qenë para tij...

Mirëpo, ndonjëherë dobia fetare nga votimi është i dukshëm, në aspekt të pakësimit të sherrit dhe dëmit. P.sh. nëse njëri prej kandidatëve jomysliman ka më pak armiqësi ndaj myslimanëve sesa tjetri, dhe në anën tjetër myslimanët me votën e tyre kanë ndikim në zgjedhje, në këtë rast themi se nuk ka asgjë të keqe nëse votohet.

Sidoqoftë, këto mesele bazohen në rregullin e sheriatit "dëmet dhe dobitë - el-mesalih uel mefasid". Për këtë duhet të pyeten dijetarët që i njohin mirë përkufizimet e këtij rregulli. Duhet, çështja t'u parashtrohet në detaje rreth situatës së atij vendi ku jetojnë ata myslimanë, rreth ligjeve të atij shteti, rreth kandidatëve, rreth rëndësisë për të votuar, rreth rezultateve etj.

Askush nuk ka të drejtë të mendojë se kush i lejon votimet, ai pajtohet dhe e ndihmon kufrin, sepse kjo bëhet për dobinë e myslimanëve e jo për dashuri ndaj kufrit dhe kafirave. E dimë fare mirë se, myslimanët u gëzuan me triumfin e romakëve ndaj persianëve. Po ashtu u gëzuan me fitoren e Nexhashiut kundër atyre që donin t'ia merrnin mbretërinë. Kjo është e ditur mirë në librat e historisë, por ai që mendon të mos përzihet në votime, është i lirë.

Fetvanë që e dhash vlen për votimet, ku mund të zgjedhen persona që do të ndikojnë për të mirën e myslimanëve. Allahu e di më së miri.

Dr. Muhamed Salih el-Munexhid

Përktheu: Omer Berisha

29.05.2006

Numri: 1323    Data: 29.05.2006

**Pyetje:** O hoxhë i nderuar, Abdur-Rahman ibën Nasir el-Berrak, cili është vendimi i fesë për votimet dhe pjesmarja në to? Cili është vendimi për hyrjen në parlament?

**Përgjigje:** All-llahun e falënderojmë, paqa dhe bekimi qofshin mbi Muhammedin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

Votimet që mbahen në vendet islame, pa marë parasysh a kanë të bëjnë me zgjedhjen e kryetarit të shtetit, ose deputëve të parlamentit, është gjë e futur në mesin e muslimanëve, ka ardhur tek ata nga popujt jobesimtar, për shkak të zotërimit të tokave muslimane prej tyre dhe për shkak se shumë muslimanëve u përlejnë metodat e jobesimtarëve, edhe pse janë metoda që vijnë ndesh me logjikën dhe fenë. Sepse përcaktimi i delegatëve bëhet në baza materiale, burojnë nga epshet dhe inetereset njerëzore. Pastaj me defektin e këtyre kriterëve, nuk zgjedh në realitet populli, sepse jo ata e përcaktojnë kandidatin e propozuar për kryetar shteti, por ata zgjedhin kandidatin e propozuar. Zgjedhja bahet në bazë të propagandës, andaj ai që ka propagandë më të madhe dhe pretendime më të mëdhaja, ai fiton.

Ata gjatë këtyre votimeve mbështeten në shumicën e votës, e cila vjen nga shtresat e ndryshme të popullit, duke shkaktuar barazim mes të mençurve dhe mendjehetëve, dijetarëve dhe injorantëve, burrave dhe grave.

Pastaj numrimi i votave nuk është fer dhe i pastër, por kanë ndikojnë në to edhe ryshfetet edhe premtimet dhe mashtrimet. Kjo ndodh në vendet e cilësuar si vende të civilizuara, të zhvilluara dhe demokratike, sipas tyre, të cilët janë baza në këto shoqëri. Kurse vendet që ecin pas tyre, siç janë shtetet arabe dhe islamike, në zgjedhjet e tyre nuk ka as realitet e as alegori. Kryetari mbetet kryetar dhe ai zakonisht votohet me 99% të votave, ose edhe ma shumë.

Edhe përskej tërë kësaj, ai që ka të drejtë zgjedhjeje nga ummeti, si intelegjëntët, dijetarët, të mirët e umetit dhe ata që këshillojnë, ata që e dinë interesin e umetit në fenë dhe dynjanë e tyre, e në të gjitha çështjet sociale, ekonomike dhe politike, ata nuk kanë gjurmë në këto votime, këta janë mes të larguarit, i cili nuk zgjidhet dhe nuk ka votë sipas tyre, ose i rrethuar me një shumëicë dërmuese që ka të drejtë të votimit dhe zgjedhjes, nga shtresat dhe grupacionet e ndryshme të shoqërisë. Me këtë e kemi të qartë se këto votime janë shumë larg nga cilësia e zgjedhjes së Imamit (Halifes), siç është përcaktuar në "rregullat e imamit" tek muslimanët. Poashtu edhe kushtet e të propozuarve në këto zgjedhje janë në kundërshtim me shumicën e kushteve të pranuar te Imami, legjitimiteti i të cilit konfirmohet me zgjedhje, siç është përcaktuar kjo në librat e fikhut islam.

Nga kjo që tham bëhet e qartë se këto votime janë të futura në mesin e muslimanëve dhe janë të kota, organizimi i tyre është harama, për shkak se është përgjajësime me jobesimtarët, mbështetet në propagandë, blerje të votave, pretendime të rrejshme dhe në shumicën mendjelhetë e cila i shet votat e veta, madje ia jep votat atyreve që ua realizojnë epshet e tyre, duke mos llogaritur aspak moralin dhe fenë.

Kurse sa i përket pjesmarjes në votime dhe hyrjes në parlament, kjo është hapësirë e ixhtihadit, nëse mundet të realizon dobi të sigurtë fetare, ta ndihmon të vërtetën dhe ta pakëson të keqen dhe zullumin, duke mos përdorur mëkat ose duke mos u mbështetur në ndonjë rregull të kufrit, ose të pajtohet me ndonjë vendim prej vendimeve të tagutit, që është në kundërshtim me sherijatin, pjesmarja në këtë formë është e ligjshme, duke e zbatuar ajetin Kur'anor: "Andaj, sa të keni mundësi ruajuni prej dënimit të All-llahut, dëgjoni, respektoni dhe jepni për të mirën tuaj, e kush i ruhet lakmisë së vetvetes, të tillët janë të shpëtuarit". (Et-Tegabun: 16).

Ai që mendon se me pjesmarje realizohen këto dobi dhe largohen të këqijat, nëse kjo shoqërohet me nijet të mirë, atëherë nuk ka mëkat, e nëse mendon se me pjesmarjen e tij nuk arrihet kjo dobi dhe nuk mund të garanton se nuk bjer në vepra të kota, atëherë për të nuk është gabim nëse izohet prej tërë këtyre grupacioneve dhe i këshillon për hirë të All-llahut, këshillon për Pejgamberin dhe mbarë muslimanët, ashtu siç ka thënë All-llahu, subhanehu ve teala: "Nuk është ndonjë mëkat për të dobëtit, as për të sëmurët, e as për ata që nuk kanë me çka të përgatiten, kur janë të sinqertë ndaj All-llahut dhe të dërguarit të Tij, pra për të mirët nuk ka rrugë qortimi. All-llahu falë shumë, është mëshirues". (Et-Teube: 91).

Kjo është ajo që mu lehtësua ta përmbledhi, All-llahu e di më së miri.

Shejh Abdur-Rahman ibën Nasir el-Berrak  
29.05.2006

## Ndalimi i mendjemadhësisë

35. Abdullah ibën Mes'udi, radijall-llahu anhu, transmeton se Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Nuk hyn në Xhennet ai që në zemrën e tij ka sa një grimcë mendjemadhësie. Një njeri tha: Ndonjëri dëshiron që rrobet e tij dhe këpucët e tij të jenë të bukura. Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, tha: Allahu është i bukur dhe e don bukurinë kurse mendjedhamësia është mospranimi i të vërtetës dhe nënçmimi i njerëzve." (Muslimi)

Allahu, subhanehu ve teala, thotë: "Atë vend të përjetshëm (xhenentini) ua kemi përcaktuar atyre që nuk duan mendjemadhësi e as ngatërresë në tokë, e përfundimi i mirë u takon atyre që i frikësohen Allahut." (Kasas, 83), poashtu thotë: "Mos ec nëpër tokë kryelartë, se Allahu nuk e do asnjë mendjemadh e që shumë lavdërohet" (Llukman, 18) "A nuk është në xhehennem vendi i mendjemëdhenjëve?" (Zumer, 60)

Mendjemadhësia në gjuhën arabe vjen me shprehjet: kibër, tekebbur dhe istikbar që janë me kuptim të përafërt. Kibri (mendjemadhësia) është ndjenjë që ka të bëjë me njeriun i cili është narcisoid (Njeriu që dashurohet ne vetete), sepse e sheh veten më të mirë se tjerët. Grada më e lartë është që të paraqitet mendjemadh ndaj Zotit të tij, duke mos pranuar të vërtetën dhe duke mos iu nënshtruar Atij me besim dhe respekt.

Tekebburi (lartëmadhëria) është dy llojesh:

1. të jenë veprat e mira më shumë se sa cilësitë e mira të tjerëve, që këndeje Allahu, subhanehu ve teala, cilësohet me këtë kuptim.
2. ta teproj duke u lavdëruar më gjëra që nuk i posedon, kjo është cilësi e shumicës së njerëzve, Allahu, subhanehu ve teala, thotë: "Po kështu Allahu vulos çdo zemër të mendjemadhit, të arrogantit." (Gafir, 35)

Nga hadithi i lartëpërmendur kuptojmë kërcënimin e ashpër ndaj mendjemadhit dhe se ai nuk hyn në xhennet pa e shijuar dënimin e Allahut nëse e dënon ose hadithi mund të kuptohet se ky është dënimi i tij nëse Allahu e dënon.

Ka shumë transmetime që qortojnë dhe ndalojnë mendjemadhësinë, si dhe kërcënime të ashpra ndaj mendjemadhit, prej tyre hadithi që u përmend në fillim të këtij kapitulli, pra mendjemadhësia është prej cilësive të banorëve të xhehenemit, Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, thotë: "A doni t'ju tregoj se kush janë banorët e xhehenemit? Çdonjëri që është arrogant, i ashpër dhe mendjemadh." (Buhariu) Ai cili ka këtë cilësi Allahu, subhanehu ve teala, nuk do t'i flet Ditën e Kijametit e as që do ta shikon, Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, thotë: "Tre lloje të njerëzve Allahu nuk do t'ju flet, nuk do t'i lavdëron e as që do t'i shikon por do t'i dënon dhembshëm: plakun që bën kurvëri, mbretin që gënjen dhe të varfërin mendjemadh." (Muslimi)

Mendjemadhi do të takon Allahun, subhanehu ve teala, të hidhëruar me të, Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, thotë: "Ai që paraqitet mendjemadh apo ec me mendjemadhësi e takon Allahun të hidhëruar." (Imam Ahmedim kurse Hakimi dhe Dhehebiu vërtetojnë hadithin). Prandaj përfundimi i tij do të jetë gjuajtja në zjarr me fytirë e tij, thotë Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem: "Ai që në zemrën e tij ka sa një grimcë mendjemadhësi, atë Allahu e gjuan me fytirë në zjarr." (Ibën Ebi Dunja)

Lartmadhëria është prej cilësive të Allahut, subhanehu ve teala, dhe nuk i takon askujt përveç Tij, sepse vetëm Ai ka emra të bukur dhe cilësi të përkryera, Atij i takojnë të gjitha lavdërimet dhe falenderimet, në një hadith kudsij qëndron: “Krenaria është ridaja ime, Lartmadhëria është izari Im, ai që don të më shoqëron në to, e dënoj.” (Muslimi)

Është për t'u habitur me njeriun i cili bëhet mendjemadh, edhe pse dy herë ka kaluar nëpër kanalën urinar, një herë pikë uji e ndytur, së dyti trupth i ndytur, e mes kësaj ai bartë në vete ndytësinë!

Pse pra mendjemadhësia, për shkak pasurisë? Pasuria harxhohet. Për shkak fuqisë? Fuqia dobësohet. Për shkak pushtetit? Nesër mund të humbet. Habi, habi me atë i cili bëhet mendjemadh dhe e di se kah vdekja ec dhe fundin e ka në varr!!

Me'muni ka thënë: Asnjëri nuk bëhet mendjemadh vetëm se për shkak të metave që i gjenë në vetvete, as që bëhet kryelartë vetëm për shkak dobësisë që e ndien në vetvete.

Haseni, radijall-llahu anhu, pa një njeri pranë xhamisë i cili paraqitej mendjemadh dhe tha: Shikoni këtë njeri, nuk ka pjesë të trupit e Allahu të mos e kishte begatuar, dhe nuk ka pjesë të trupit e djalli të mos e kishte nëpërkëmb.

Është thënë: Nuk bëhet kryelartë vetëm i poshtëri e as modest vetëm i larti.

Dije vëlla musliman se përfundimi i mendjemadhësisë është i afërt, shembujt për këtë janë të shumtë, Karuni ishte prej popullit të Musait alejhis-selam, Allahu e pat begatuar mirëpo ai u bë kryelartë dhe i padrejtë. Si ishte përfundimi i tij? Allahu, subhanehu ve teala, thotë: “Karuni ishte nga populli i Musait dhe ai shtypte atë popull ngase ne i patëm dhënë aq shumë pasuri sa që një grup i fuqishëm mezi bartinin çelsat e (pasurisë së) tij, e kur populli i vet tha: mos u kreno aq shumë sepse Allahu nuk i do të shfrenuarit. Dhe me atë që të ka dhënë Allahu, kërkoni (ta fitosh) botën tjetër, e mos le mangu atë që të takon nga kjo botë, dhe bën mirë ashtu siç të ka bërë Allahu ty, e mos bën të këqija në tokë, se Allahu nuk i do çregulluesit. Ai (Karuni) tha: Më është dhënë vetëm në sajë të dijes time! Po a nuk e di se Allahu shkatërroi para tij nga popujt e lashtë asish që ishin edhe më të fuqishëm e më të pasur se ai, por mëkatarët kriminel as që do të pyetën për fjalët e tyre (meqë Allahu i di). E ai (Karuni) doli përpara popullit të vet me stolinë e vet, e ata që kishin synim jetën e kësaj bote thanë: Ah, të kishim patur edhe ne ashtu si i është dhënë Karunit, vërtetë ai është fatbardhë! E ata që ishin të zotët e diturisë thanë: Të mjerët ju, shpërblimi i Allahut është shumë më i mirë për atë që besoi dhe bëri vepra të mira, po atë nuk mund ta arrijë përveç durimtarëve. Po ne atë dhe pallatin e tij i shafuam në tokë dhe, përveç Allahut nuk pati ndonjë që ta mbrojë e as vetë nuk pati mundësi të mbrohet.” (Kasas, 76-81)

Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, thotë: “Derisa një njeri ecte dhe zvaritëte izarin e tij për toke nga mendjemadhësia, shembet toka dhe ai fundoset në të deri në Ditën e Kijametit.” (Buhariu)

Seleme ibën Ekv'a, radijall-llahu anhu, transmeton se një njeri u ushqye në prezencë të Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, me dorën e tij të majtë, dhe i tha: “Ushqehu me dorën e djathtë! Ai ia ktheu: Nuk mundem. Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, tha: “Mos paç mundësi”. Atë nuk e pengoi të ushqehet me dorën e djathtë vetëm se mendjemadhësia dhe nuk mundi më asnjëherë të afroje dorën e tij te goja e vet.” (Muslimi)

Kujdes, kujdes vëlla musliman nga mendjemadhësia sepse përfundimin e ka të dhembshëm, e shembujt për këtë janë të shumtë. Imran ibën Musa thotë: Lexova në disa libra: nuk kam parë askend që është bërë mendjemadh ndaj atyre që ishin nën të, vetëm se në të njëjtën masë ka shijuar nënçmim prej atyre që ishin mbi të.

**Ahmed Muadh Hakkij**

Përktheu: Agim Bekiri

(libri: Katërdhjet hadithe mbi moralin, NuN, Shkup, 2005)